



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE  
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА  
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë

Cikli i tretë i studimeve

**“ANALIZA E HAPËSIRËS FISKALE NË VENDET E BALLKANIT  
PERËNDIMOR ME THEKS TË VEÇANTË NË RASTIN E  
REPUBLIKËS SË KOSOVËS”**

Mentori:  
Akademik. Prof. Dr.

Kandidatja:

Abdylmenaf Bexheti

Kaltrina Bunjaku Pasuli

Nëntor, 2022

## DEKLARATË

Unë, Kaltrina Bunjaku Pasuli, deklaroj se ky disertacion i titullar *“Analiza e Hapësirës Fiskale në vendet e Ballkanit Perëndimor me theks të veçantë në rastin e Republikës së Kosovës”* është punë e imja origjinale, nën mentorimin e Akademik Prof. Dr. Abdylmenaf Bexheti, nga Fakulteti i Biznesit, Universiteti i Evropës Juglindore në Maqedoninë e Veriut, me qëllim të marrjes së titullit Doktor i shkencave ekonomike.

Deklaroj se punimi në fjalë nuk është botuar më parë për ndonjë vlerësim apo kualifikim tjetër dhe as nga ndonjë institucion tjetër arsimor. Nuk ka tekst apo argument të përdorur në punim që është shkruar nga dikush tjetër, përpos rasteve të cilat janë cituar/referuar sipas standardeve metodologjike.

## DEDIKIM

Këtë disertacion ia dedikoj

Prindërve të mi Fatmirit dhe Besires,

Vajzave të mia Endës dhe Ermës,

Bashkëshortit tim Meritonit,

Motrës sime Vjollcës dhe vëllait tim Mirlindit

Të cilët i japin kuptim çdo gjëje që unë bëj!

## **FALENDERIM**

Punimi i disertacionit kërkon mund dhe përkushtim të madh i cili nuk mund të realizohej pa përkrahjen e njerëzve më të dashur, prandaj ju jam mirënjohëse dhe i falenderoj pafund të gjithë ata që më kanë mbështetur në realizimin e disertacionit tim.

Dëshiroj të shpreh falenderimet më të thella për mentorin tim të doktoratës Akad.Prof.Dr. Abdylmenaf BEXHETI, i cili me qetësinë, durimin, mbështetjen, eksperiencën dhe njohuritë e tij shkencore e profesionale dhe me motivimin e tij të vazhdueshëm më ka ndihmuar shumë në realizimin e këtij disertacioni. Jam dhe do të jenë me fat të gjithë studentët që do të kenë një profesor si ju! Gjithashtu do të doja të shprehja mirënjohjen time për Prof. Dr. Besnik FETAI për këshillat e tij të çmuara, gatishmërinë dhe mbështetjen e pakushtëzuar për të më ndihmuar në pjesën e metodologjisë së punimit. I falendertoj edhe të gjithë profesorët dhe anëtarët e komisionit që me komentet, vlerësimet dhe sugjerimet e tyre konstruktive më ndihmuan në ngritjen e nivelit të hulumtimit.

Familja gjithmonë luan një rol vendimtar në çdo sukses, prandaj asgjë nuk është e mundur pa mbështetjen e tyre. Fillimisht dua të shpreh mirënjohjen time më të thellë për njerëzit që mua më bënë personin që jam sot. Për babain tim Fatmirin, i cili gjithmonë besoi tek unë dhe më inkurajoi; dhe nënën time Besiren, që fatkeqësisht më la në mes të këtij rrugëtimi, por që deri në frymën e fundit nuk pushoi kurrë së më mbështeturi. Shumicën e gjërave që kam në jetë ua kam borxh të dyve.

Dëshiroj të falenderoj bashkëshortin tim Meritonin për dashurinë, mirëkuptimin dhe mbështetjen e tij gjatë gjithë këtyre viteve. Jam shumë me fat që të kam. Vajzat e mia të mrekullueshme, Enda dhe Erma, të cilat me dashurinë e çiltër dhe të qeshurat gazmore e bënë këtë rrugë më pak të pakëndshme për mua.

Në fund do të doja të shpreh falenderimet e singerta për mbështetjen dhe përkrahjen për shoqërinë time dhe kolegët.

Ju jam mirënjohës të gjithëve!

Kaltrina BUNJAKU PASULI

Nëntor, 2022

## ABSTRAKT

Qëllimi i këtij studimi është analiza e hapësirës fiskale në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe të eksplorojë në mënyrë empirike marrëdhënien midis treguesve të funksionit të reagimit fiskal dhe bilancit primar sipas qasjes së Ostry et al. (2010) dhe hapësirën fiskale de facto sipas qasjes së Aizenman dhe Jinjark (2010) për periudhën 2000 - 2020.

Për vërtetimin dhe validimin e hipotezave të ngritura janë përdorur modele dhe teknika të ndryshme statistikore si regresioni i katrorëve më të vegjël (OLS), regresioni me efekte fikse dhe të rastit dhe modeli Hausman – Taylor me variabla instrumentale.

Rezultatet tregojnë se Maqedonia e Veriut, Shqipëria dhe Mali i Zi nuk kanë hapësirë fiskale, Serbia ka një hapësirë fiskale shumë të kufizuar, ndërsa Bosnja dhe Hercegovina dhe Kosova kanë pak hapësirë fiskale. Rezultatet e regresionit tregojnë një ndërlidhje pozitive në mes të borxhit publik të vonuar dhe bilancit primar, ndërkohë që borxhi i vonuar në katror ka një ndikim negativ në bilancin primar, gjë që tregon se marrëdhënia e tyre është jolineare dhe në formë U-je. Gjithashtu, hendeku i shpenzimeve qeveritare ka një lidhje negative me bilancin primar, ndërsa hendeku i prodhimit ka një lidhje pozitive. Ndërsa, rezultatet e hapësirës fiskale de facto tregojnë që ka variacion të gjerë të viteve tatimore të nevojshme për shlyerjen e borxhit publik, nga më pak se 1 vit në Kosovë (duke treguar një hapësirë të lartë fiskale), deri në rreth 4.3 vite në Shqipëri (duke treguar një hapësirë të ulët fiskale).

Të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor janë ballafaquar me një rritje të ndjeshme të raportit të borxhit publik ndaj PBB-së gjatë vitit të fundit, gjë që ka shkaktuar një ulje të hapësirës fiskale të këtyre vendeve. Prandaj, bazuar në rezultatet e studimit, politikëbërësit sugjerohen të ulin nivelin e borxhit publik në mënyrë që vendet të kenë hapësirë më të madhe fiskale pa rrezikuar stabilitetin ekonomik dhe qëndrueshmërinë fiskale.

Ky punim është origjinal për nga natyra dhe është punimi i parë që analizon në mënyrë empirike hapësirën fiskale të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Prandaj, priret të jetë ndër të

parat në llojin e tij në këtë fushë. Gjetjet e këtij studimi do të kontribuojnë në këtë zbrajëti në literaturë dhe do të jenë me vlerë për qeveritë e vendeve dhe politikëbërësit e tjerë.

**Fjalët kyçe:** Hapësira fiskale, Funkcioni i reagimit fiskal, Bilanci primar, Borxhi publik, Hendeku i prodhimit, Hendeku i shpenzimeve qeveritare, të dhënat e panelit, Ballkani Perëndimor

## **ABSTRACT**

The aim of this study is to assess the fiscal space of Western Balkan countries and to empirically explore the relationship between fiscal reaction function indicators and primary balance following the approach of Ostry et al. (2010) and de facto fiscal space according to the approach of Aizenman and Jinjark (2010) for the period 2000 - 2020.

Various statistical models and techniques were used for the verification and validation of the presented hypotheses, such as Ordinary Least Squares regression (OLS), fixed and random effects regression and the Hausman – Taylor model with instrumental variables.

The results show that North Macedonia, Albania and Montenegro have no fiscal space, Serbia has a very limited fiscal space, while Bosnia and Herzegovina and Kosovo have some fiscal space. The regression results show a positive relationship between lagged public debt and primary balance, while lagged square debt has a negative impact on primary balance, which reveals that their relationship is nonlinear and U-shaped. Furthermore, government expenditure gap has a negative connection with primary balance, while output gap has a positive connection. Whereas, the results of the de facto fiscal space show that there is a wide variation in the tax years needed to repay the public debt, from less than 1 year in Kosovo (indicating a high fiscal space), up to about 4.3 years in Albania (indicating a low fiscal space).

All Western Balkan countries have seen a significant increase in the debt-to-GDP ratio in the last year, which has caused a decrease in the fiscal space of the countries. Therefore, based on the results of the study, country policymakers are suggested to reduce the level of public debt so that countries have greater fiscal space without jeopardizing economic stability and fiscal sustainability.

This paper is original in nature and is the first paper that empirically analyzes the fiscal space of the Western Balkan countries. Therefore, it tends to be among the first of its kind in this field. The findings of this study will contribute to this gap in the literature and will be of value to countries governments and other policymakers.

**Keywords:** Fiscal space, Fiscal reaction function, Primary balance, Public debt, Output gap, Government expenditure gap, Panel data, Western Balkans

# Përmbajtja

|                                                                  |    |
|------------------------------------------------------------------|----|
| ABSTRAKT.....                                                    | 6  |
| ABSTRACT.....                                                    | 8  |
| LISTA E FIGURAVE .....                                           | 13 |
| LISTA E TABELAVE .....                                           | 16 |
| LISTA E SHKURTESAVE.....                                         | 17 |
| I. HYRJE DHE QËLLIMET E STUDIMIT.....                            | 19 |
| 1.1 Lënda e hulumtimit.....                                      | 19 |
| 1.2 Qëllimet dhe objektivat e hulumtimit .....                   | 22 |
| 1.3 Hipotezat.....                                               | 23 |
| 1.4 Pyetjet kërkimore.....                                       | 23 |
| 1.5 Metodologjia e hulumtimit.....                               | 24 |
| 1.6 Rëndësia e punimit .....                                     | 25 |
| 1.7 Strukturimi i punimit.....                                   | 26 |
| 1.8 Përmbledhje.....                                             | 27 |
| II. SHQYRTIMI I LITERATURËS.....                                 | 29 |
| 2.1 Koncepti teorik i hapësirës fiskale.....                     | 29 |
| 2.2 Fushëveprimi i hapësirës fiskale .....                       | 32 |
| 2.3 Marrëdhënia e hapësirës fiskale me fusha të tjera .....      | 34 |
| 2.4 Kriteret e hapësirës fiskale .....                           | 36 |
| 2.5 Sfidat që e vështirësojnë krijimin e hapësirës fiskale ..... | 40 |
| 2.5.1 Vështirësitë në politikën e shpenzimeve .....              | 41 |
| 2.5.2 Vështirësitë në politikën tatimore .....                   | 42 |
| 2.5.3 Vështirësitë në politikën e huamarrjes.....                | 43 |
| 2.6 Përdorimi i hapësirës fiskale .....                          | 44 |
| 2.7 Ballkani Perëndimor dhe pandemia Covid-19.....               | 50 |
| 2.7.1 Kosova .....                                               | 62 |
| 2.7.2 Maqedonia e Veriut .....                                   | 73 |

|       |                                                                                 |     |
|-------|---------------------------------------------------------------------------------|-----|
| 2.7.3 | Shqipëria .....                                                                 | 74  |
| 2.7.4 | Serbia .....                                                                    | 75  |
| 2.7.5 | Mali i Zi.....                                                                  | 76  |
| 2.7.6 | Bosnja dhe Hercegovina .....                                                    | 78  |
| III.  | QASJET E NDRYSHME RRETH MATJES SË HAPËSIRËS FISKALE.....                        | 80  |
| 3.1   | Qasja e FMN-së .....                                                            | 80  |
| 3.2   | Qasja "Diamanti i hapësirës fiskale" .....                                      | 81  |
| 3.3   | Qasja e Aizenman - Jinjark (2010) .....                                         | 83  |
| 3.4   | Qasja Ostry et al. (2010).....                                                  | 84  |
| 3.5   | Qasja Park (2012) .....                                                         | 85  |
| 3.6   | Shqyrtimi empirik .....                                                         | 86  |
| IV.   | METODOLOGJIA E HULUMTIMIT .....                                                 | 93  |
| 4.1   | Metodat e kërkimit .....                                                        | 93  |
| 4.2   | Variablat e përdorura në studim.....                                            | 94  |
| 4.3   | Burimi i të dhënave .....                                                       | 97  |
| 4.4   | Metodat e analizës së të dhënave .....                                          | 98  |
| 4.4.1 | Modeli i regresionit të katrorëve të vegjël (OLS).....                          | 98  |
| 4.4.2 | Modeli i regresioni me efekte fikse (Fixed-effects) .....                       | 99  |
| 4.4.3 | Modeli i regresionit me efekte të rastit (Random-effects).....                  | 100 |
| 4.4.4 | Hausman testi .....                                                             | 100 |
| 4.4.5 | Modeli Hausman-Taylor me variabla instrumental (IV) .....                       | 100 |
| 4.5   | Modeli empirik .....                                                            | 101 |
| 4.6   | Statistikat deskriptive.....                                                    | 102 |
| V.    | REZULTATET EMPIRIKE.....                                                        | 104 |
| 5.1   | Llogaritja e hapësirës fiskale sipas qasjes së Ostry et al. (2010).....         | 116 |
| 5.2   | Llogaritja e hapësirës fiskale sipas qasjes së Aizenman dhe Jinjark (2010)..... | 118 |
| 5.3   | Testimi i hipotezave .....                                                      | 122 |
| 5.4   | Vlerësimet dhe alternativat lidhur me hapësirën fiskale të Kosovës .....        | 130 |
| VI    | KONKLuzionet dhe Rekomandimet .....                                             | 143 |

|                   |                            |     |
|-------------------|----------------------------|-----|
| 6.1               | Konkluzionet.....          | 143 |
| 6.2               | Limitimet e studimit ..... | 148 |
| 6.3               | Rekomandimet .....         | 149 |
| BIBLIOGRAFIA..... |                            | 153 |
| SHTOJCAT .....    |                            | 161 |

## LISTA E FIGURAVE

|                                                                                               |     |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| Figura 1. Diamanti i Hapësirës Fiskale .....                                                  | 21  |
| Figura 2. Treguesit e hapësirës fiskale .....                                                 | 39  |
| Figura 3. Prezantimi skematik i Hapësirës Fiskale .....                                       | 48  |
| Figura 4. Rritja ekonomike e vendeve të Ballkanit Perëndimor .....                            | 51  |
| Figura 5. Borxhi publik në Ballkanin Perëndimor (% të PBB-së) .....                           | 52  |
| Figura 6. Të ardhurat publike në Ballkanin Perëndimor (% të PBB-së) .....                     | 54  |
| Figura 7. Shpenzimet publike në Ballkanin Perëndimor (% të PBB-së) .....                      | 55  |
| Figura 8. Ndihmat e huaja në Ballkanin Perëndimor (% të GNI) .....                            | 56  |
| Figura 9. Inflacioni (% ndryshimi) në Ballkanin Perëndimor .....                              | 57  |
| Figura 10. Bilanci primar në Ballkanin Perëndimor .....                                       | 58  |
| Figura 11. Stabilitet politik në Ballkanin Perëndimor .....                                   | 59  |
| Figura 12. Ekonomia informale në Ballkanin Perëndimor .....                                   | 60  |
| Figura 13. Kontrolli i korrupsionit në Ballkanin Perëndimor .....                             | 61  |
| Figura 14. Të ardhurat publike në Kosovë (% të PBB-së) .....                                  | 63  |
| Figura 15. Shpenzimet publike në Kosovë (% të PBB-së) .....                                   | 64  |
| Figura 16. Borxhi publik në Kosovës (% të PBB-së) .....                                       | 65  |
| Figura 17. Ndihmat e huaja në Kosovë (% të GNI-së) .....                                      | 66  |
| Figura 18. Rritja ekonomike e Kosovës .....                                                   | 67  |
| Figura 19. Inflacioni (% ndryshimi) në Kosovë .....                                           | 68  |
| Figura 20. Bilanci primar në Kosovë .....                                                     | 69  |
| Figura 21. Stabilitet politik dhe mungesa e dhunës ose terrorizmit në Kosovë .....            | 70  |
| Figura 22. Ekonomia informale në Kosovë .....                                                 | 71  |
| Figura 23. Kontrolli i korrupsionit në Kosovë .....                                           | 72  |
| Figura 24. Diamanti i Hapësirës Fiskale .....                                                 | 82  |
| Figura 25. Përcaktimi i kufirit të borxhit .....                                              | 110 |
| Figura 26. Rritja ekonomike, borxhi publik dhe trendet lineare - Kosova .....                 | 112 |
| Figura 27. Rritja ekonomike, borxhi publik dhe trendet lineare – Maqedonia e Veriut .....     | 113 |
| Figura 28. Rritja ekonomike, borxhi publik dhe trendet lineare – Shqipëria .....              | 113 |
| Figura 29. Rritja ekonomike, borxhi publik dhe trendet lineare – Serbia .....                 | 114 |
| Figura 30. Rritja ekonomike, borxhi publik dhe trendet lineare – Mali i Zi .....              | 114 |
| Figura 31. Rritja ekonomike, borxhi publik dhe trendet lineare – Bosnja dhe Hercegovina ..... | 115 |
| Figura 32. Hapësira fiskale de facto në vendet e Ballkanit Perëndimor .....                   | 121 |
| Figura 33. Të ardhurat publike në Maqedoninë e Veriut (% të PBB-së) .....                     | 173 |
| Figura 34. Shpenzimet publike në Maqedoninë e Veriut (% të PBB-së) .....                      | 173 |
| Figura 35. Borxhi publik në Maqedoninë e Veriut (% të PBB-së) .....                           | 174 |

|                                                                                             |     |
|---------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| Figura 36. Ndihamat e huaja në Maqedoninë e Veriut (%GNI) .....                             | 174 |
| Figura 37. Rritja ekonomike në Maqedoninë e Veriut .....                                    | 175 |
| Figura 38. Inflacioni në Maqedoninë e Veriut (%ndryshimi) .....                             | 175 |
| Figura 39. Bilanci primar në Maqedoninë e Veriut.....                                       | 176 |
| Figura 40. Stabilitetit politik dhe mungesa e dhunës ose terrorizmit në Maqedoninë e Veriut | 176 |
| Figura 41. Ekonomia informale në Maqedoninë e Veriut .....                                  | 177 |
| Figura 42. Kontrolli i korrupsionit në Maqedoninë e Veriut.....                             | 177 |
| Figura 43. Të ardhurat publike në Shqipëri (% të PBB-së).....                               | 178 |
| Figura 44. Shpenzimet publike në Shqipëri (% të PBB-së).....                                | 178 |
| Figura 45. Borxhi publik në Shqipëri (% të PBB-së).....                                     | 179 |
| Figura 46. Ndihamat e huaja në Shqipëri (%GNI) .....                                        | 179 |
| Figura 47. Rritja ekonomike në Shqipëri.....                                                | 180 |
| Figura 48. Inflacioni në Shqipëri (% ndryshimi) .....                                       | 180 |
| Figura 49. Bilanci primar në Shqipëri .....                                                 | 181 |
| Figura 50. Stabilitetit politik dhe mungesa e dhunës ose terrorizmit në Shqipëri.....       | 181 |
| Figura 51. Ekonomia informale në Shqipëri.....                                              | 182 |
| Figura 52. Kontrolli i korrupsionit në Shqipëri.....                                        | 182 |
| Figura 53. Të ardhurat publike në Serbi (% të PBB-së).....                                  | 183 |
| Figura 54. Shpenzimet publike në Serbi (% të PBB-së) .....                                  | 183 |
| Figura 55. Borxhi publik në Serbi (% të PBB-së).....                                        | 184 |
| Figura 56. Ndihamat e huaja në Serbi (%GNI) .....                                           | 184 |
| Figura 57. Rritja ekonomike në Serbi.....                                                   | 185 |
| Figura 58. Inflacioni në Serbi (% ndryshimi) .....                                          | 185 |
| Figura 59. Bilanci primar në Serbi .....                                                    | 186 |
| Figura 60. Stabilitetit politik dhe mungesa e dhunës ose terrorizmit në Serbi .....         | 186 |
| Figura 61. Ekonomia informale në Serbi.....                                                 | 187 |
| Figura 62. Kontrolli i korrupsionit në Serbi .....                                          | 187 |
| Figura 63. Të ardhurat publike në Malin e Zi (% të PBB-së) .....                            | 188 |
| Figura 64. Shpenzimet publike në Malin e Zi (% të PBB-së) .....                             | 188 |
| Figura 65. Borxhi publik në Malin e Zi (% të PBB-së) .....                                  | 189 |
| Figura 66. Ndihamat e huaja në Malin e Zi (%GNI).....                                       | 189 |
| Figura 67. Rritja ekonomike në Malin e Zi .....                                             | 190 |
| Figura 68. Inflacioni në Malin e Zi (% ndryshimi).....                                      | 190 |
| Figura 69. Bilanci primar në Malin e Zi .....                                               | 191 |
| Figura 70. Stabiliteti politik dhe mungesa e dhunës ose terrorizmit në Malin e Zi.....      | 191 |
| Figura 71. Ekonomia informale në Malin e Zi .....                                           | 192 |
| Figura 72. Kontrolli i korrupsionit në Malin e Zi .....                                     | 192 |
| Figura 73. Të ardhurat publike në Bosnje dhe Hercegovinë (% të PBB-së) .....                | 193 |

|                                                                                                     |     |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| Figura 74. Shpenzimet publike në Bosnje dhe Hercegovinë (% të PBB-së) .....                         | 193 |
| Figura 75. Borxhi publik në Bosnje dhe Hercegovinë (% të PBB-së).....                               | 194 |
| Figura 76. Ndhmat e huaja në Bosnje dhe Hercegovinë (%GNI) .....                                    | 194 |
| Figura 77. Rritja ekonomike në Bosnje dhe Hercegovinë .....                                         | 195 |
| Figura 78. Inflacioni në Bosnje and Hercegovinë (% ndryshimi) .....                                 | 195 |
| Figura 79. Bilanci primar në Bosnje dhe Hercegovinë .....                                           | 196 |
| Figura 80. Stabiliteti politik dhe mungesa e dhunës ose terrorizmit në Bosnje dhe Hercegovinë ..... | 196 |
| Figura 81. Ekonomia informale në Bosnje dhe Hercegovinë.....                                        | 197 |
| Figura 82. Kontrolli i korrupsionit në Bosnje dhe Hercegovinë .....                                 | 197 |

## LISTA E TABELAVE

|                                                                                                  |     |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| Tabela 1: Treguesit kryesor të hapësirës fiskale .....                                           | 37  |
| Tabela 2. Krijimi, qëndrueshmëria dhe përdorimi i hapësirës fiskale – Një kornizë treguese ..... | 45  |
| Tabela 3. Variablat e përdorura në studim .....                                                  | 94  |
| Tabela 4. Statistikat deskriptive .....                                                          | 103 |
| Tabela 5. Hausman test .....                                                                     | 105 |
| Tabela 6. Rezultatet e regresionit të funksionit të reaksionit fiskal .....                      | 105 |
| Tabela 7. Borxhi publik dhe kufiri i borxhit .....                                               | 116 |
| Tabela 8. Hapësira fiskale dhe reduktimet e borxhit të kaluar .....                              | 117 |
| Tabela 9. Hapësira fiskale de facto .....                                                        | 119 |
| Tabela 10. Statistikat deskriptive .....                                                         | 122 |
| Tabela 11. Vlerësimi i Auto-korrelacionit (Testi i Durbin-Watson) .....                          | 123 |
| Tabela 12. Rezultatet e regresionit Prais-Winsten: .....                                         | 123 |
| Tabela 13. Statistikat deskriptive .....                                                         | 127 |
| Tabela 14. Hausman test .....                                                                    | 128 |
| Tabela 15. Rezultatet e regresionit .....                                                        | 129 |

## **LISTA E SHKURTESAVE**

AKP - Agjencia Kosovare e Privatizimit

BERZH - Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

BQK - Banka Qendrore e Kosovës

FMN – Fondi Monetar Ndërkombëtar

FSSH - Fondi i Sigurimeve Shëndetësore

GNI - Të Ardhurat Kombëtare Bruto (Gross National Income)

IFN - Institucionet Financiare Ndërkombëtare

IÇK – Indeksi i Çmimeve të Konsumit

ILO - Organizata Ndërkombëtare e Punës (International Labour Organization)

IBRD - Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (International Bank for Reconstruction and Development)

KASH - Korniza Afatmesme e Shpenzimeve

KB - Kombet e Bashkuara

NVM – Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme

OECD - Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (Organisation for Economic Co-operation and Development)

OZHM - Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit

PBB – Produkti i Brendshëm Bruto

SELDI - Vlerësimi i Korrupsionit dhe Ekonomisë së Fshehur në Evropën Juglindore (Southeast European Leadership for Development and Integrity).

TVSH – Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

UN - Kombet e Bashkuara (United Nations)

UNICEF - Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (United Nations Children's Fund)

WB - Banka Botërore (World Bank)

WEO - World Economic Outlook

# **I. HYRJE DHE QËLLIMET E STUDIMIT**

## **1.1 Lënda e hulumtimit**

Sot, një nga problemet kryesore me të cilat ballafaqohen vendet është sigurimi i alokimit efikas të burimeve. Në këtë pikë, në rastet kur vendi nuk mund të plotësojë plotësisht nevojat me burimet e tij ekzistuese, mund të kërkohen burime shtesë. Në këtë kontekst, vendet brenda kornizës së kufijve ekzistues të buxhetit, bëjnë përpjekje që të krijojnë mundësi të reja financimi për financimin e nevojave publike, apo transferimin e tyre në fushat e përcaktuara më parë. Kjo çështje ka rëndësi të madhe sidomos për vendet në zhvillim që kanë mungesë të burimeve për t'u përdorur në fushat e shëndetësisë, infrastrukturës dhe arsimit. Në mënyrë që vendet të gjejnë një zgjidhje për këtë problem, ka dalë në pah koncepti i hapësirës fiskale dhe ka filluar të diskutohet nga shkencëtarët dhe politikëbërësit.

Hapësira fiskale në thelb përqendrohet në efikasitetin e vendeve në alokimin e burimeve dhe përdorimin e tyre për qëllime specifike duke krijuar burime shtesë. Qëllimi kryesor i këtij punimi është analiza teorike e hapësirës fiskale dhe llogaritja e hapësirës fiskale të vendeve të Ballkanit Perëndimor, me theks të veçantë atë të Kosovës. Prandaj, së pari do të përcaktohet koncepti i hapësirës fiskale dhe rëndësia e saj. Pastaj do të elaborohen çasjet e ndryshme lidhur me matjen e hapësirës fiskale dhe do të përzgjedhet çasja më e përshatatshme për matjen e hapësirës fiskale për vendet e lartëcekura.

Koncepti i hapësirës fiskale u shfaq në fund të viteve 1990 si pjesë e një diskutimi të gjerë në mes të vendeve dhe institucioneve financiare ndërkombëtare në lidhje me rritjen e kapaciteteve të shpenzimeve publike (Heller, 2005; Barroy et al., 2018). Në këtë kontekst, qëllimi kryesor është realizimi i rritjes së shpenzimeve publike në një mënyrë të qëndrueshme financiare pa kërcënuar aftësinë paguese të shtetit (Barroy et al., 2018). Koncepti i hapësirës fiskale është një koncept i përdorur shpesh në literaturën ekonomike në vitet e fundit (World Bank, 2015; World Bank, 2017a; IMF, 2016a; IMF, 2017; IMF, 2018; Botev et al., 2016; Kose et al., 2017; Lee and Hur, 2017; Baum et al., 2017; Aizenman et al., 2018; Barroy et al., 2018; Cheng and Pitterle, 2018; Ortiz et al., 2019; Romer and Romer, 2019).

Hapësira fiskale është e rëndësishme si për përdorshmërinë, ashtu edhe për efikasitetin e politikës fiskale. Prandaj, të paturit e një zone të gjerë fiskale gjithashtu rrit efektivitetin e politikës fiskale (WB, 2015). Për më tepër, ekzistenca e hapësirës fiskale zë një vend qendror në diskutimet mbi praktikën e politikave sociale për të përshpejtuar rritjen ekonomike si të vendeve të zhvilluara, po ashtu dhe ato në zhvillim (Kose et al., 2017).

Hapësira fiskale është një terminologji relativisht e re dhe që definohet në mënyra të ndryshme në literaturë. Heller (2005) e definon hapësirën fiskale si një "hapësirë" në buxhetin e një qeverie që e lejon atë të sigurojë burime për një qëllim të caktuar, veçanërisht për investime që ndikojnë në rritje (Ley, 2009), pa e rrezikuar qëndrueshmërinë financiare ose stabilitetin makroekonomik. Aizenman dhe Jinjark (2010) e definojnë hapësirë fiskale si anasjellta e viteve të taksave që do të duheshin për të shlyer borxhin publik. Sipas Ostry et al. (2010) hapësira fiskale është ndryshimi në mes të nivelit aktual të borxhit publik dhe kufirit të borxhit. Ndërsa Park (2012) e përcakton hapësirën fiskale si distancën ndërmjet të ardhurave aktuale të taksave dhe kulmit të kurbës Laffer. Megjithatë nuk ka një përkufizim të vetëm, një aspekt thelbësor i hapësirës fiskale është "aftësia e një qeverie për të shërbyer borxhin e saj". Në qoftë se nuk mirëmbahet kapaciteti i shërbimit të borxhit, një qeveri nuk mund të financojë në mënyrë të pacaktuar operacionet e saj në një mënyrë të shëndoshë. Vetë kapaciteti i shërbimit të borxhit ka dimensione të shumëfishta, përfshirë nevojat e financimit që lidhen me pozicionet buxhetore, hyrjen në tregjet likuide, qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve të vlerësimit dhe detyrimet e kushtëzuara (Kose et al., 2017).

Hapësira fiskale ekziston edhe në vendet më të varfra. Nga tetë opsionet, gjashtë rritin madhësinë e përgjithshme të buxhetit të një vendi: (i) rritja e të ardhurave nga taksat; (ii) zgjerimi i mbulimit të sigurimeve shoqërore dhe të ardhurave kontribuese; (iii) lobimi për rritjen e ndihmës dhe transferimeve; (iv) eliminimi i flukseve të paligjshme financiare; (v) huazimi ose ristrukturimi i borxhit, dhe (vi) miratimi i një kornize makroekonomike më akomoduese. Dy opsionet e tjera kanë të bëjnë me ridrejtimin e burimeve ekzistuese nga një zonë në tjetrën: (vii) alokimi i shpenzimeve publike dhe; (viii) përgjimi në rezervat fiskale dhe valutore (Ortiz et al., 2019).


Ekzistojnë qasje të ndryshme se si duhet të bëhet matja e hapësirës fiskale, si për shtetet e zhvilluara, ashtu edhe ato në zhvillim. Secila prej këtyre qasjeve ofron mundësi të ndryshme, por edhe disa kufizime.

- *Qasja e FMN-së* - FMN e matë hapësirën fiskale si një përpjekje për të krijuar hapësirë shtesë fiskale, përmes të ardhurave publike, shpenzimeve publike, ndihmave të huaja dhe politikave të huazimit.
- *Qasja “Diamanti i Hapësirës Fiskale”* bën matjen e hapësirës fiskale përmes diamantit fiskal, ku sipërfaqja totale e diamantit paraqet hapësirën totale fiskale që posedon një vend. Në çdo cep të diamantit gjenden mjete të ndryshme të politikës fiskale për krijimin e hapësirës fiskale (Roy et al., 2007).

Në figurën 1, është paraqitur një shembull i diamantit të hapësirës fiskale. Në anën e djathtë të diamantit gjenden të ardhurave publike (% e PBB-së), në anën e majtë shpenzimet publike (% e PBB-së), në pjesën e sipërme ndihmat e huaja (% e PBB-së) dhe në anën e poshtme financimi i deficitit (% e PBB-së). Çdo mundësi e hapësirës fiskale që mund të merret veç e veç përmes këtyre mjete nxjerr në pah formën e diamantit në total. (Roy et al., 2007).

Figura 1. Diamanti i

Hapësirës Fiskale



Burimi: Roy, R., Heuty, A., & Letouzé, E. (2007). Fiscal space for what? Analytical issues from a human development perspective. UNDP, fq.6.

- *Qasja e Aizenman - Jinjark (2010)* – bën matjen e "de facto" hapësirës fiskale përmes burimeve të përdorura në pagimin e borxhit publik në kohë kur taksat nuk mund të mbledhen (në periudhat e mbledhjes së ulët të taksave, përmes formulës:

$$\text{Hapësira fiskale de facto} = \frac{\text{Borxhi publik}}{\text{Mbledhja e taksave}} \quad (1)$$

- *Qasja Ostry et al. (2010)* – bën matjen e hapësirës fiskale si diferencën në mes të nivelit aktual të borxhit të vendeve dhe kufirit të borxhit të përcaktuar në mënyrë analitike dhe duke zbuluar karakteristikat ekonomike të secilit vend.
- *Qasja Park (2012)* - përdor lakoren Laffer për të matur hapësirën fiskale, e cila përshkruan se si të ardhurat nga taksat mund të maksimizohen.

## 1.2 Qëllimet dhe objektivat e hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi është vlerësimi teorik i konceptit të hapësirës fiskale dhe analiza e hapësirës fiskale në vendet e Ballkanit Perëndimor, me theks të veçantë në Republikën e Kosovës.

Objektivat që punimi hulumtues synon t'i realizojë janë:

- Hulumtimi i aspekteve teorike të hapësirës fiskale
- Definimi dhe përcaktimi i hapësirës fiskale;
- Përshkrimi i marrëdhënies së hapësirës fiskale me fusha të tjera;
- Përcaktimi i faktorëve që ndikojnë në krijimin e hapësirës fiskale;
- Kuptimi i sfidave që e vështirësojnë krijimin e hapësirës fiskale;
- Elaborimi i qasjeve të ndryshme rreth hapësirës fiskale;
- Përzgjedhja e qasjes më të përshtatshme si model për të aplikuar në shtetet e Ballkanit Perëndimor;

- Përcaktimi i hapësirës fiskale për të krijuar hapësirë më të gjerë manovruese për politikëbërësit në dizajnimin e politikave ekonomike;
- Analiza e hapësirës fiskale për shtetet e përzgjedhura;
- Nxjerrja e rekomandimeve nga rezultatet e fituara;
- Rezultatet e këtij punimi t'i shërbejnë institucioneve qeveritare të Kosovës.

### 1.3 Hipotezat

Duke u bazuar në shqyrtimin e literaturës dhe objektivat e punimit hulumtues, do të parashtrohen hipotezat e më poshtme:

H<sub>1</sub>: Hapësira fiskale ka ndikim në stabilitetin makroekonomik të vendeve.

H<sub>2</sub>: Korpusi i faktorëve politik sfidon krijimin e hapësirës fiskale.

H<sub>3</sub>: Hapësira fiskale në ciklet rënës ekonomike krijon hapësirë ndikuese për politika fiskale ekspansive.

### 1.4 Pyetjet kërkimore

Pyetjet kërkimore të cilat pritet të shtjellohen në këtë hulumtim janë:

- Cili është definimi dhe përcaktimi i hapësirës fiskale?
- Cila është marrëdhënia ndërmjet hapësirës fiskale me fusha të tjera?
- Cilat janë faktorët që ndikojnë në krijimin e hapësirës fiskale?
- Cilët janë faktorët që e ruajnë (kursejnë) hapësirën fiskale për ciklet rënës të ekonomisë?
- Cila është lidhja (korrelacioni) e hapësirës fiskale dhe ekonomisë informale, ndërsa kjo e fundit edhe me korrupsionin?
- Cilat janë metodat e krijimit të hapësirës fiskale?
- Si bëhet matja e hapësirës fiskale?
- Cilat janë sfidat që e vështirësojnë krijimin e hapësirës fiskale?

- Cilat janë efektet e implementimit të politikave buxhetore në hapësirën fiskale?

## 1.5 Metodologjia e hulumtimit

Për të realizuar qëllimin dhe objektivat e studimit, për t'i dhënë përgjigje pyetjeve kërkimore dhe për të verifikuar hipotezat e ngritura, studimi do të bazohet në përdorimin e metodave të ndryshme kualitative dhe kuantitative.

Hulumtimi rreth hapësirës fiskale të vendeve do të përpunohet me analizë tre dimensionale – të ardhurat publike, shpenzimet publike, si dhe borxhi publik. Pra, përmes këtyre tre parametrave do të përcaktohet hapësira fiskale e vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Për studimin e problemeve do të shfrytëzohen metodat e njohura të tilla si:

- Metoda e analizës dhe sintezës – në bazë të këtyre metodave do të bëhen analiza të hollësishme për të arritur në përfundime të përgjithshme duke bërë sinteza në funksion të arritjes së qëllimit përmes dhënies së përgjigjeve të pyetjeve të kërkimit shkencor dhe vërtetimit të hipotezave.
- Metoda e deduksionit - nëpërmjet metodës së deduksionit nga rastet e përgjithshme do të arrihet në përfundime të veçanta.
- Metoda krahasuese – në bazë të kësaj metode do të bëhet krahasimin në mes të vendeve të Ballkanit Perëndimor për sa i përket hapësirës fiskale.
- Metoda historike – përmes të dhënave të siguruara nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK), Banka Botërore (WB), Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Organizata ndërkombëtare e punës (ILO), Agjencitë Statistikore të vendeve do të arrihet tek përgjigjet e pyetjeve kërkimore.
- Analiza empirike - përmes analizës empirike duke ndërtuar dhe paraqitur një model ekonometrik, synohet që të bëhet analiza e hapësirës fiskale të Kosovës dhe shteteve të Ballkanit Perëndimor, si dhe të bëhet interpretimi ekonomik i të dhënave që do të rezultojnë nga modeli. Analizat do të bëhen përmes programit STATA.

## 1.6 Rëndësia e punimit

Koncepti i hapësirës fiskale është një koncept mjaft i ri, prandaj ka një numër shumë të kufizuar të studimeve empirike në këtë fushë. Përveç kësaj, pothuajse asgjë nuk dihet për matjen e hapësirës fiskale të Kosovës. Prandaj, ky punim tenton të jetë ndër të parat e këtij lloji në këtë fushë.

Rezultati i pritur i këtij studimi është të japë një kontribut në këtë zbraçeti në literaturë duke siguruar një studim të parë empirik për Kosovën dhe krahasimin me shtetet tjera të Ballkanit Perëndimor. Do të nxjerren konkluzionet dhe do të ofrohen rekomandimet për të gjeturat e këtij studimi.

Rezultatet e këtij punimi mund të përdoren edhe nga politikbërësit në institucionet qeveritare të vendit për të marrë vendime lidhur me politikat fiskale, konkretisht hapësirën fiskale. Për më tepër, ky studim mund të rrisë interesin e studiuesve dhe hulumtuesve të tjerë për zhvillimin e mëtejshëm të kësaj fushe kërkimore relativisht të re dhe tërheqëse.

Duke marrë në konsideratë se ky studim do të bazohet në të dhëna sekondare, të dhënat e kufizuara, e sidomos mungesa e serive kohore mund të paraqet vështirësi në përpunimin e të dhënave.

## 1.7 Strukturimi i punimit

Ky punim i doktoraturës përbëhet nga gjashtë kapituj:

*Kapitulli i parë – Hyrja:* Ky kapitull përfshinë lëndën e hulumtimit, qëllimet dhe objektivat e punimit, hipotezat e hulumtimit, pyetjet kërkimore, metodologjinë e hulumtimit, rëndësinë e punimit, si dhe kufizimet e studimit.

*Kapitulli i dytë – Shqyrtimi i literaturës:* Ky kapitull përshkruan rishikimin e detajuar të literaturës lidhur me hapësirën fiskale ku fokusi kryesor është Republika e Kosovës dhe po ashtu edhe vendet e Ballkanit Perëndimor. Kapitulli përmban një vështrim të përgjithshëm mbi mënyrën, përmbajtjet dhe modelet e përdorura për matjen e hapësirës fiskale në vende të ndryshme. Duke përfshirë shqyrtimin teorik dhe shqyrtimin empirik të literaturës.

*Kapitulli i tretë – Matja e hapësirës fiskale:* Ky kapitull përfshin qasje të ndryshme në drejtim të matjes së hapësirës fiskale (Qasjet në lidhje me qëndrueshmërinë financiare; Qasja e FMN-së; Qasja e "diamantit të hapësirës fiskale"; Qasja Aizenman - Jinjark (2010); Qasja Park (2012) dhe Qasja Ostry et al. (2010).

*Kapitulli i katërt – Metodologjia:* Ky kapitull paraqet informatat lidhur me metodat e aplikuara për kërkim, variablat e përdorura, si dhe dizajnin e hulumtimit me specifikat e modeleve ekonometrike.

*Kapitulli i pestë – Rezultatet empirike:* Ky kapitull përfshinë analizën e të dhënave, diskutimet, paraqitjen e rezultateve të hulumtimit, përgjigjet e pyetjeve kërkimore, si dhe testimin dhe vërtetimit të hipotezave të ngritura.

*Kapitulli i gjatë – Konkluzionet dhe Rekomandimet:* ky kapitull përshkruan konkluzionet e dala nga hulumtimi, rekomandimet që ofrohen në këtë drejtim, kufizimet e studimit, si dhe udhëzimet për hulumtim të më tutjeshëm.

## 1.8 Përmbledhje

Koncepti i hapësirës fiskale filloi të zinte vend në ekonominë dhe literaturën e financave publike që nga 2005. Në këtë drejtim hapësira fiskale mund të përkufizohet si një burim i krijimi të financimit që mund të përdoret për një qëllim specifik pa rrezikuar qëndrueshmërinë fiskale.

Karakteristikat e hapësirës fiskale mund të renditen si në vijim (UNICEF, 2009):

- Hapësira fiskale është një koncept dinamik i orientuar drejt së ardhmes dhe për buxhetet e ardhshme parashikon alokimin e burimeve të disponueshme duke bërë prioritizimin.
- Hapësira fiskale përdoret për të realizuar përparësitë e politikave kombëtare siç janë shpenzimet sociale, shpenzimet e lidhura me rritjen ekonomike ose uljen e taksave.
- Në varësi të natyrës së shpenzimeve publike, hapësira ekzistuese fiskale mund të ndikohet përmes efekteve të saj në qëndrueshmërinë fiskale në një periudhë afatmesme dhe afatgjatë.
- Përcaktimi i zonave ku hapësira fiskale mund të krijohet nga shteti dhe shpërndarja e hapësirës fiskale që do të krijohet sipas përparësive të shpenzimeve varet nga cilësia e institucioneve buxhetore, kredibiliteti i buxheteve vjetore dhe procesi i buxhetimit në një perspektivë afat-mesme.
- Llojet e ndryshme të shpenzimeve (ndryshimet në përbërjen e shpenzimeve publike) mund të kenë ndikime të ndryshme në hapësirën ekzistuese fiskale në periudhën afatmesme dhe afatgjatë përmes ndikimit të tyre në qëndrueshmërinë fiskale.

Hapësira fiskale duhet të vlerësohet veçmas për secilin vend në varësi të kushteve aktuale makroekonomike, politike dhe kulturore të secilit vend (Roy et al., 2008). Treguesit makroekonomikë, struktura financiare dhe struktura administrative e vendeve janë faktorë mjaft përcaktues në formimin e hapësirës fiskale. Sidomos kur dëshirohet të krijohet një hapësirë fiskale në vendet në zhvillim, përdoren metodat e diamantit të hapësirës fiskale. Megjithatë, vështirësitë e hasura në realitet gjatë zbatimit të metodave parandalojnë krijimin e

hapësirës fiskale. Vendet e zhvilluara ose në zhvillim do të jenë në gjendje të arrijnë qëllimet e tyre ekonomike dhe fiskale kur identifikojnë dhe përpiqen të zgjidhin arsyet që vështirësojnë krijimin e hapësirës fiskale përmes shpenzimeve, taksave dhe borxheve (World Bank, 2013).

Matjet e pasakta të hapësirës fiskale mund të kenë efekte negative në shumë faktorë të rëndësishëm, nga fazat e zhvillimit të vendeve e deri tek treguesit makroekonomik.

Posedimi i burimeve të nevojshme për inovacionet e politikave të përshtatshme për qëndrueshmërinë fiskale në periudhën afatmesme dhe afatgjatë është përparësia kryesore e të gjitha vendeve. Për këtë arsye, secili vend duhet të krijojë një hapësirë fiskale në përputhje me strukturën e vet. Shtrirja e hapësirës fiskale që do të krijohet ndryshon për grupet e vendeve. Prandaj, formimi dhe përdorimi i hapësirës fiskale duhet të bëhet sipas karakteristikave të vendeve të pazhvilluara, vendeve në zhvillim dhe vendeve të zhvilluara (Schick, 2009).

## II. SHQYRTIMI I LITERATURËS

### 2.1 Koncepti teorik i hapësirës fiskale

Megjithëse baza e saj faktike është shumë e vjetër, termi "hapësirë fiskale" është relativisht i ri dhe që kuptohet në mënyra të ndryshme. Koncepti i hapësirë fiskale ka hyrë në literaturën e ekonomisë në vitet e fundit si një koncept i përdorur shpesh për krijimin e një burimi financimi për një qëllim të caktuar në ekonomitë e vendit. Në veçanti, është propozuar si një mjet që mund të përdoret për të arritur Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM) të miratuara nga Kombet e Bashkuara (KB).

Koncepti i hapësirës fiskale u shfaq në fund të viteve 1990 si pjesë e një debati të gjerë në mes të vendeve dhe institucioneve financiare ndërkombëtare se si të krijohen politika efektive pa ndikuar negativisht në qëndrueshmërinë financiare të vendeve, për përshpejtimin e rritjes dhe zvogëlimin e varfërisë. Në këtë kontekst, qëllimi kryesor është rritja e shpenzimeve publike në një mënyrë të qëndrueshme financiare pa kërcënuar aftësinë e shtetit për të shlyer borxhin (Barroy et al, 2018). Hapësira fiskale është e rëndësishme si për vlefshmërinë ashtu edhe për efikasitetin e politikës fiskale (World Bank, 2015). Po ashtu, ekzistenca e hapësirës fiskale ka qenë në qendër të diskutimeve të fundit mbi vendosjen e politikës fiskale për shpejtimin e rritjes në ekonomitë e zhvilluara dhe ato në zhvillim (Kose et al, 2017). Interesi në rritje i treguar me kalimin e kohës bëri që koncepti i hapësirë fiskale të përdoret në shumë fusha.

Ekonomistë të shumtë sjellin qasje të ndryshme ndaj konceptit të hapësirës fiskale, në përputhje me fushën e tyre të specializimit, po ashtu edhe organizatat ndërkombëtare si Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Banka Botërore (BB) dhe Kombet e Bashkuara (KB) vlerësojnë gjithashtu konceptin nga perspektiva ekonomike dhe shoqërore.

Termi hapësirë fiskale u përdor për herë të parë në literaturë në mars të vitit 2005 nga Peter S. Heller, në një nga artikujt e diskutimit të politikave të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN-së) lidhur me kuptimin e hapësirës fiskale, dhe në maj 2005 në artikullin e Bankës Botërore lidhur me marrëdhënien në mes të zbutjes së varfërisë dhe përpjekjes për krijimin e hapësirës fiskale

në rastin e Ekuadorit. Heller (2005) definoi hapësirën fiskale si një "hapësirë" në buxhetin e një qeverie që e lejon atë të sigurojë burime për një qëllim të dëshiruar pa rrezikuar qëndrueshmërinë e pozicionit të saj financiar ose stabilitetin e ekonomisë. Sipas këtij përkufizimi, hapësira fiskale do t'u siguronte qeverive aftësinë për të financuar, në planin afatshkurtër dhe afatgjatë, programet e tyre të dëshiruara të shpenzimeve si dhe për të shërbyer borxhin e tyre pa cenuar stabilitetin makroekonomik dhe qëndrueshmërinë fiskale. Ndërsa Banka Botërore (2005) përcakton hapësirën fiskale si shuma e burimeve në dispozicion për të financuar shpenzimet bazë (përveç pagave dhe pensioneve aktuale) të kërkuara nga programet individuale dhe projektet e investimeve që shoqërohen me qëllime të caktuara (për shembull, zbutja e varfërisë siç përfshihet në studim).

Koncepti i hapësirës fiskale është definuar si financimi që mund të përdoret nga qeveria për një grup të specifikuar të objektivave për zhvillim, si rezultat i politikave konkrete që synojnë rritjen e mobilizimit të burimeve dhe për të siguruar praktika të mira qeverisjeje për të siguruar efektivitetin e këtyre politikave konkrete, si rezultat i reformave të nevojshme për të siguruar qeverisjen e mundshme, mjedisin institucional dhe ekonomik (Roy et al, 2007).

Hapësira fiskale i referohet përdorimit të burimeve buxhetore për një qëllim specifik, veçanërisht për investime që ndikojnë në rritje, pa rrezikuar qëndrueshmërinë ose stabilitetin ekonomik të situatës financiare të shtetit (Ley, 2009). Pika që theksohet këtu është se ajo ka për qëllim krijimin e burimeve për një qëllim të caktuar në hapësirën fiskale dhe buxhetin e shtetit.

Hapësira fiskale i referohet burimeve financiare në dispozicion të një qeverie për iniciativa politike përmes buxhetit dhe vendimeve të ndërlidhura. Ky term përfshin fonde që bëhen të disponueshme përmes rialokimit, burimeve në rritje të gjeneruara nga rritja ekonomike, fondeve të huazuara më shumë se të ardhurat korente dhe të ardhurave shtesë nga rritja e taksave (Schick, 2009).

Aizenman dhe Jinjark (2010) definojnë nocionin hapësirë fiskale të një vendi si anasjellta e viteve të taksave që do të duheshin për të shlyer borxhin publik. Konkretisht, matet borxhi i pashlyer publik në raport me baza de facto të taksave, ku kjo e fundit mat mbledhjen e realizuar të taksave, mesatarisht në disa vite për t'u zbutur nga luhatjet e ciklit të biznesit.

Sipas Ostry et al. (2010) hapësira fiskale është ndryshimi në mes të nivelit aktual të borxhit publik dhe kufirit të borxhit të nënkuptuar nga të dhënat historike të rregullimit fiskal të vendit. Edhe Moody's Analytics bën një definim të ngjashëm të hapësirës fiskale si ndryshimi në mes të borxhit aktual të një qeverie dhe kufirit teorik të borxhit të nënkuptuar nga sjellja historike e politikëbërësve të saj (Zandi et al, 2011).

Park (2012) ndërton modelin standard neoklasik për të nxjerrë një kurbë Laffer për të ardhurat publike dhe përcakton hapësirën fiskale si distancën midis të ardhurave aktuale të taksave dhe kulmit të kurbës Laffer. Pra, të ardhurat tatimore të siguruara nga shkalla më e lartë e mundshme e taksave.

Sipas një përkufizimi tjetër, hapësira fiskale nënkupton rritjen maksimale të borxhit qeveritar që mund të financohet nga taksat. Nga ana tjetër, nëse emetimi i obligacionit tejkalon madhësinë e hapësirës fiskale, ajo mund të bëhet e paaftë për të paguar borxhin qeveritar. Prandaj, hapësira fiskale shfaqet si një koncept teorik që ndihmon në vlerësimin e rreziqeve të tilla si krizat financiare (Lee & Hur, 2017).

Hapësira fiskale përcaktohet si burimet të disponueshme si rezultat i kërkimit aktiv dhe shfrytëzimit të të gjitha burimeve të mundshme të të ardhurave nga një qeveri, sipas ILO, UNICEF dhe UNWOMEN (Ortiz et al., 2019).

Ndërsa referimi në hapësirën fiskale është i përsëritur në diskutimet në vazhdim të politikës makroekonomike, në literaturë mund të shihet që nuk ka ende një konsensus të qartë për përcaktimin dhe matjen e hapësirës fiskale (Cheng & Pitterle, 2018). Por në përgjithësi mund të përkufizohet si kapacitet shtesë shpenzues i qeverive pa kërcënuar qëndrueshmërinë fiskale në periudhë afatmesme dhe afatgjatë. Me fjalë të tjera, mund të mendohet si një hapësirë buxhetore që u jep qeverive mundësinë për të siguruar burime për qëllime të caktuara.

Reflektimet politike të konceptit të hapësirës fiskale mund të ndryshojnë ndjeshëm për shumë vende varësisht nga karakteristikat e tyre, e veçanërisht nivelit të të ardhurave të tyre. Derisa në vendet e zhvilluara diskutohet se si të bëhet alokimi efikas i hapësirës fiskale në dispozicion, vendet në zhvillim marrin iniciativa se si të nxjerrin në pah potencialin e tyre të hapësirës

fiskale. Në anën tjetër, vendet me të ardhura të ulëta bëjnë përpjekje për të rritur hapësirën fiskale posaçërisht përmes ndihmave të huaja.

Në fund të fundit, çdo vend me të ardhura të larta ose të ulëta ka nevojë për një sasi të caktuar të hapësirës fiskale në mënyrë që të arrijë qëllimet e përcaktuara. Edhe vendet që e ndiejnë këtë nevojë në nivelin më të ulët duhet të marrin parasysh shpenzimet e mundshme që mund të ballafaqohen në të ardhmen (për shembull barrat financiare për shkak të arsyeve demografike) dhe politikat qeveritare duhet të zhvillohen me një perspektivë që do të mbrojë ose kontribuojë në hapësirën aktuale fiskale. Në këtë aspekt, politikat dhe praktikatat të tilla si të ardhurat publike, shpenzimet publike, ndihmat e huaja, borxhi publik, rritja ekonomike, privatizimi, partneriteti publik-privat dhe fondet e pasurisë janë mjete të rëndësishme që mund të përdoren për të krijuar hapësirë fiskale.

Qeveria mund të krijojë hapësirë fiskale duke i rritur taksat, sigurimin e granteve të jashtme, zvogëlimin e shpenzimeve me prioritet të ulët, mjete nga huaja (nga institucionet bankare ose qytetarët), por këtë ajo duhet ta bëjë pa e rrezikuar stabilitetin makroekonomik dhe qëndrueshmërinë fiskale (Bexheti, 2017).

## 2.2 Fushëveprimi i hapësirës fiskale

Hapësira fiskale, sipas fushëveprimit shpjegohet nga një strukturë katër dimensionale, që përfshinë mundësitë për të rritur taksat; ripriorizimi dhe ngritja e efikasitetit të shpenzimeve; financimi i deficitit përmes huamarrjes së brendshme dhe të jashtme; si dhe mundësitë për të siguruar ndihma të huaja (Roy et al, 2007).

Për të krijuar një hapësirë të re fiskale, rritja e të ardhurave nga taksat është një kanal shumë i rëndësishëm, i cili mund të arrihet duke ndryshuar lloje të ndryshme të normave të taksave - mbi konsumin, fitimet e korporatave, aktivitetet financiare, të ardhurat personale, pronën, importet ose eksportet, etj. - ose duke forcuar efikasitetin e metodave të mbledhjes së taksave dhe pajtueshmërinë e përgjithshme (Ortiz et al, 2011). Për shembull, në vendet ku normat e taksave janë relativisht të ulëta, nivelet e taksave mund të rriten, baza e taksave mund të

zgjerohet, avantazhet e taksave mund të zvogëlohen dhe menaxhimi i taksave mund të mundësohet (Heller, 2005).

Po ashtu është e mundur të krijohet hapësirë fiskale përmes rialokimit të shpenzimeve publike. Këtu, kontributi i shpenzimeve publike në rritjen ekonomike dhe efektet e tyre në shpërndarjen e të ardhurave duhet gjithashtu të merren parasysh (Herrera, 2007). Mund të thuhet se eliminimi i praktikave joefikase të subvencionimit duke rishikuar politikat e subvencionimit mund të kontribuojë pozitivisht në formimin e hapësirës fiskale. Në anën tjetër, zbatimet e buxhetit të performancës që rrisin efikasitetin e shpenzimeve publike mund të kontribuojnë gjithashtu në efikasitetin e shpenzimeve, duke zgjeruar kështu hapësirën fiskale. Në këtë drejtim, mendohet se përhapja e disiplinës fiskale, transparencës fiskale, llogaridhënies dhe zbatimit të auditimit të performancës do të lehtësojnë formimin e hapësirës fiskale. Rialokimi i shpenzimeve aktuale publike është opsioni më i zakonshëm, duke bërë vlerësimin e alokimeve të vazhdueshme të buxhetit përmes rishikimeve të shpenzimeve publike dhe buxheteve tematike, duke zëvendësuar investimet me kosto të lartë dhe me ndikim të ulët, në ato me ndikime më të mëdha socio-ekonomike, duke eliminuar shpenzimet joefikase dhe luftimin e korrupsionit (Ortiz et al, 2011).

Borxhi i brendshëm dhe i jashtëm përbëjnë gjithashtu burime alternative në krijimin e hapësirës fiskale. Huamarrja ose ristrukturimi i borxhit ekzistues përfshin hulumtimin aktiv të opsioneve të huazimit vendas dhe të huaj që janë me kosto të ulët, nëse jo koncesionare, pas një vlerësimi të kujdesshëm të qëndrueshmërisë së borxhit (Ortiz et al, 2011). Ulja e stokut të borxhit të brendshëm është një nga kushtet thelbësore për formimin e hapësirës fiskale. Për shkak se borxhi i brendshëm ndikon drejtpërdrejt në variabla të tilla si normat e interesit, normat e inflacionit dhe suficiti primar, të cilat janë përcaktuesit e hapësirës fiskale. Sa më e ulët të jenë inflacioni dhe normat e interesit dhe sa më i lartë të jetë suficiti primar, aq më e gjerë do të jetë hapësira fiskale. Sepse, një rritje e normave të tregut ose një rritje e normave të obligacioneve qeveritare mund të rrisë vlerën e stokut të borxhit dhe të çojë në një ngushtim të hapësirës fiskale (Ghosh et al, 2011).

Një mënyrë tjetër për të gjetur burime për të krijuar hapësirë fiskale është përmes ndihmës së huaj, e cila kërkon për më tepër bashkëpunim me qeveri të ndryshme donatore (Ortiz et al, 2011). Ndihma e huaj është një mundësi për të krijuar një hapësirë fiskale e cila preferohet sidomos nga vendet më pak të zhvilluara. Një nga alternativat kryesore në të cilat vendet më pak të zhvilluara kërkojnë burime për ndihmë të huaj janë ndihma e Bankës Botërore dhe ndihma nga organizata të tjera ndërkombëtare. Sidoqoftë, kushtet shumë të rrepta të ndihmës së huaj dhe detyrimet shtesë që ajo sjell e bëjnë të vështirë gjetjen e hapësirës fiskale në këtë mënyrë.

Identifikimi i avantazheve dhe disavantazheve të krijimit të një hapësire fiskale është e mundur duke vlerësuar në mënyrë të detajuar në bazë të vendit pozicionin fillestar financiar të qeverive, strukturat e tyre të të ardhurave dhe shpenzimeve, karakteristikat e detyrimeve të jashtëzakonshme të borxhit, strukturat themelore të ekonomive të tyre, pritjet e rritjes së burimeve të huaja dhe kushtet themelore të jashtme me të cilat përballen (specifik për vendin) (Heller, 2005). Siç është theksuar në shumë studime, në fakt, hapësira fiskale duhet të vlerësohet veçmas për secilin vend dhe mund të ndërtohet në varësi të kushteve aktuale makroekonomike, politike dhe kulturore të secilit vend.

### 2.3 Marrëdhënia e hapësirës fiskale me fusha të tjera

Koncepti i hapësirës fiskale ndërlidhet me çështje të ndryshme financiare nga shumë studiues (UNICEF, 2009). Me fjalë të tjera, hapësira fiskale është një koncept shumë dimensional që trajtohet në një gamë të gjerë të sferave duke filluar nga qëndrueshmëria fiskale, pastaj zhvillimi, ekonomia politike, të ardhurat publike e deri tek qeveritë lokale (FMN, 2016). Për shembull, koncepti u përdor përgjithësisht në sektorin e shëndetësisë në vitet e para të prezantimit të tij, i cili doli në pah me sugjerimet e bëra për qeveritë për të përballuar shpenzimet në rritje të shëndetësisë. Banka Botërore hapësirën fiskale për shërbimin shëndetësor e përshkruan si alokimin e më shumë burimeve për sektorin shëndetësor pa kërcënuar qëndrueshmërinë në pozicionin financiar të qeverive. Në një aspekt tjetër, Heller (2006) deklaroi se vendet e pazhvilluara kanë nevojë për financim të jashtëm, veçanërisht

ndihmë të huaj, në krijimin e hapësirës fiskale për sektorin e shëndetësisë, veçanërisht në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme. Në veçanti, u theksua se ndihma e parashikueshme dhe afatgjatë do të kishte efekte më të mëdha. Koncepti i hapësirës fiskale ka treguar interes të madh nga ekonomistët e zhvillimit, ku ka qenë gjithashtu i ndërlidhur ngushtë me Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM), i cili u miratua në vitin 2000 dhe synonte të arrihej në periudhën deri në 2015 (dhe disa nga qëllimet u arritën) (Roy et al, 2005; Brun et al. Al., 2006; Jansen & Khannabha, 2009). UNDP ka vendosur tetë qëllime specifike me OZHM, e cila u krijua për të minimizuar pabarazinë në të ardhura dhe problemet humanitare që vijnë nga kjo pabarazi, dhe u përpoq të prodhonte politika për të arritur këto qëllime (Ortiz et al., 2019). Në këtë drejtim, koncepti i hapësirës fiskale shihet si një mjet që mund të përdoret në realizimin e OZHM-së, i cili përcakton disa qëllime përmirësimi në fusha të tilla si ulja e varfërisë, arsimi, shëndetësia dhe mjedisi (Jansen & Khannabha, 2009).

Përveç këtyre, koncepti i hapësirës fiskale është i lidhur me "rregullin fiskal". Duke marrë parasysh që pika fillestare e diskutimeve në lidhje me rregullin fiskal është ekuilibri në mes të elasticitetit dhe qëndrueshmërisë së buxhetit, koncepti i hapësirës fiskale është gjithashtu një koncept shumë i rëndësishëm për rregullin fiskal për shkak të elasticitetit që ai ofron për buxhetet. Me fjalë të tjera, derisa qëndrueshmëria ka të bëjë me sigurimin e vazhdimësisë së buxhetit brenda kornizës në bazë të disa parimeve dhe rregullave; elasticiteti lidhet drejtpërdrejt me hapësirën fiskale për sa i përket zbatimit të preferencave politike dhe përparësive të shpenzimeve. Pra, nevojitet një hapësirë fiskale që siguron elasticitet në buxhet në mënyrë që të zbatohet këto politika. Sipas një këndvështrimi tjetër, megjithë përparësitë e tyre të shumta, rregullat fiskale kanë një efekt ngushtues në fushën fiskale. Pavarësisht nëse është një kufizim fiks ose shikohet nga një kornizë e përgjegjësisë fiskale, rregullat fiskale tërheqin vëmendjen për një mjedis buxhetor më të kufizuar dhe një qeveri më vigjilente. Për shkak se efektet e rregullave fiskale varen nga vullneti politik, vullneti më i vogël i udhëheqësve qeveritarë për të shpenzuar mbi të ardhurat zvogëlon sasinë e hapësirës në dispozicion (Schick, 2009). Ndërsa, FMN (2016) përmend që rregullat fiskale luajnë një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e besueshmërisë fiskale, hyrjen në tregun e borxhit dhe për këtë arsye hapësirën fiskale.

Korrelacioni më i rëndësishëm midis të gjitha këtyre qasjeve duket të jetë marrëdhënia e krijuar me qëndrueshmërinë financiare. Siç mund të shihet qartë nga disa përkufizime të hapësirës fiskale, marrëdhënia midis dy fenomeneve lidhet me aftësinë e qeverisë për të financuar programet e shpenzimeve të planifikuara për t'u realizuar në të ardhmen dhe aftësinë për të përmbushur detyrimet e saj të borxhit. Nga kjo ndërlidhje mund të nxirren disa konkluzione. Së pari, nëse një program shpenzimesh financohet nga huamarrja, ai program shpenzues duhet të ketë efekt në rritjen ekonomike ose në rritjes e të ardhurave qeveritare në mënyrë që të shlyejë borxhin së bashku me interesin. Së dyti, nuk ka asnjë përfitim nga krijimi i hapësirës fiskale në vitin aktual nëse nuk mund të krijohet hapësira fiskale në të ardhmen për të përmbushur disa nga kërkesat (veçanërisht në sektorin e shëndetësisë). Për shkak se plotësimi i këtyre nevojave kërkon vazhdimësi. Së treti, dhe së fundmi, mungesa e hapësirës fiskale në të ardhmen që sot lejon shpenzimet shtesë, do të ndikojë që qeveritë të pushojnë së investuari në investime të reja në të ardhmen dhe do të kërkojë ulja e detyrueshme e disa shpenzimeve. Prandaj, hapësira fiskale nuk duhet të shihet kurrë si një çështje që lidhet vetëm me një sektor të caktuar. Për shkak se iniciativat në një sektor mund të ndikojnë në shumë fusha. Qeveritë gjithashtu duhet të zbatojnë politikat e tyre bazuar në këtë fakt (Heller, 2006).

## 2.4 Kriteret e hapësirës fiskale

Sot, hapësira fiskale është bërë shumë e rëndësishme në aspektin e qëndrueshmërisë së politikave fiskale sidomos në vendet në zhvillim për financimin e shërbimeve të planeve zhvillimore të tilla si investimet në infrastrukturë, shpenzimet sociale dhe në rastet kur vendet përballen me kriza të borxhit. Politika efektive fiskale varet nga sasia e burimeve buxhetore në dispozicion për të rritur shpenzimet ose për të ulur taksat pa rrezikuar qëndrueshmërinë fiskale. Që nga kriza financiare globale, hapësira fiskale ekonomitë në zhvillim është ngushtuar. Kjo i bën këto ekonomi më të prekshme ndaj rritjeve të papritura të kostove të financimit dhe kufizon aftësinë e tyre për të luftuar goditjet e pafavorshme (Kose et al, 2018). Nevoja për zgjerimin e hapësirës fiskale ka lindur jo vetëm në vendet në zhvillim, por edhe në vendet e

zhvilluara. Sidomos kostot e globalizimit dhe integritimeve ekonomike i kanë detyruar vendet e zhvilluara të zgjerojnë hapësirën e tyre fiskale.

Ekzistojnë mënyra të ndryshme se si mund të krijohet hapësira fiskale, si në shtetet e shtetet e zhvilluara, po ashtu edhe tek ato në zhvillim. Secila nga këto ofrojnë mundësi të ndryshme, por gjithashtu kanë edhe disa kufizime. Përzgjedhja e saktë mund të bëhet përmes vlerësimit të kostove dhe përfitimeve që sjellin politikat fiskale të secilës, si dhe të implikimeve politike. Ekzistojnë gjashtë kritere kryesore për krijimin e hapësirës fiskale sipas (Williams & Hay, 2005):

1. Shkurtimi i shpenzimeve jo thelbësore (prioritizimi i shpenzimeve)
2. Sigurimi i rialokimit të burimeve ndërmjet sektorëve,
3. Mbledhja e të ardhurave publike në mënyrë efektive
4. Sigurimi i qëndrueshmërisë së borxhit
5. Rritja e ndihmave të jashtme
6. Sigurimi i të ardhurave seignorage (printimi i parave nga Banka Qendrore për të financuar shpenzimet shtesë).

Pamundësia e qeverive për të rritur të ardhurat e tyre nga taksat për shkak të shqetësimeve politike i bën qeveritë të krijojnë dhe zgjerojnë hapësirat e tyre fiskale në përputhje me faktorët e renditur më sipër (UNICEF, 2009). Po ashtu edhe përmes krijimit dhe zbatimit të rregullave fiskale (fiscal rules), apo edhe përmes menaxhimit efektiv dhe efikas të financave publike – nëpërmjet mekanizmave matës siç është menaxhimi i shpenzimeve kapitale (capital efficiency management).

Realizimet e treguesve makroekonomikë janë shumë të rëndësishëm në realizimin e politikave të synuara për të krijuar një hapësirë fiskale dhe për ta zgjeruar atë. Treguesit e lartpërmendur dhe marrëdhënia midis hapësirës fiskale janë paraqitur në Tabelën 1.

Tabela 1: Treguesit kryesor të hapësirës fiskale

| Sektori | Treguesit | Ndikimi negativ në hapësirën, nëse | Ndikimi pozitiv në hapësirën, nëse |
|---------|-----------|------------------------------------|------------------------------------|
|---------|-----------|------------------------------------|------------------------------------|


|                    |                                                                |         |         |
|--------------------|----------------------------------------------------------------|---------|---------|
| <b>I brendshëm</b> | Kreditë e sektorit privat (% PBB-së, % e ndryshimit ndër vite) | I lartë | I ulët  |
|                    | Inflacioni në IÇK (ndryshimi në %)                             | I lartë | I ulët  |
| <b>I jashtëm</b>   | Llogaria korente (% PBB-së)                                    | Deficit | Suficit |
|                    | Borxhi i jashtëm (% PBB-së)                                    | I lartë | I ulët  |
|                    | Log Rezervave të parave të huaja- në huazim afatshkurtër       | I ulët  | I lartë |
| <b>Fiskal</b>      | Bilanci fiskal (% PBB-së)                                      | Deficit | Suficit |
|                    | Borxhi publik bruto (% PBB-së)                                 | I lartë | I ulët  |

Burimi: Van Doorn, R., Suri, V., & Gooptu, S. (2010). *Do middle-income countries continue to have the ability to deal with the global financial crisis?*. The World Bank. 5381: 1-19, fq. 7.

Nga tabela 1 mund të shohin që treguesit e formuar nga kushtet e brendshme dhe të jashtme të vendeve, ndonjëherë mund të jenë aq pengues për arritjen e qëllimit të synuar të hapësirës fiskale. Për shembull, kur inflacioni, i cili është një nga treguesit e kushteve të brendshme, është i lartë, borxhi i jashtëm, i cili është një nga treguesit e kushteve të jashtme, është i lartë, dhe në rast të një deficiti që mund të ndodhë në bilancin fiskal, do të kenë efekt negativ në hapësirën fiskale. Ndërsa, kur llogaria korente si një tregues i jashtëm është në përmirësim, apo kur arrihet një rezultat në të cilin bilanci fiskal është i qëndrueshëm, do të kenë efekt pozitiv në hapësirën fiskale.

Ndërsa në figurën 2 janë paraqitur treguesit kryesor të hapësirës fiskale sipas Botev et al. (2016).

Figura 2. Treguesit e hapësirës fiskale



Burimi: Jarmila Botev et al, (2016). A re-Assessment of Fiscal Space in OECD Countries.

*Economics Department Working Papers* Nr: 1352, fq. 10.

Është e rëndësishme të bëhet dallimi në mes të qëllimeve për të cilat krijohet hapësira fiskale në situata të ndryshme socio-ekonomike. Roy et al. (2007) kanë paraqitur indikatorët socioekonomik duke marrë për bazë vendet sipas grupit të të ardhurave, duke përfshirë shtatë variabla: norma e rritjes së PBB-së (%), luhatshmëria e rritjes, shkalla e vdekshmërisë së

foshnjave (për 1000 lindje), arsimimi i të rriturve (%), qasja e popullsisë në ujë të pastër të pijes (%), koeficienti Gini dhe incidenca e varfërisë (1 dollar në ditë).

Hapësira fiskale mund të thuhet që është *e kufizuar* kur nuk mund të parashikohet asnjë (ose më së shumti vetëm marginale) lehtësim fiskal krahasuar me vijën fillestare. *Ekziston* një hapësirë fiskale kur ka disa shqetësime në lidhje me financimin, qëndrueshmërinë fiskale ose besueshmërinë, por masa të konsiderueshme të përkohshme fiskale janë të mundshme brenda kufijve të caktuar, nëse ekziston një rast ekonomik për masa të tilla. Ndërsa hapësira fiskale është *e konsiderueshme* kur financimi, qëndrueshmëria fiskale dhe besueshmëria nuk sugjerojnë asnjë kufizim të rëndësishëm për ndërmarrjen e masave të përkohshme fiskale, nëse ekziston një rast ekonomik për to. Derisa shkalla e relaksimit dhe lloji i masave ende kërkojnë kalibrim, politika fiskale zakonisht mund të jetë më e lirë për një periudhë më të gjatë kur hapësira është e konsiderueshme (IMF, 2018).

## 2.5 Sfidat që e vështirësojnë krijimin e hapësirës fiskale

Nga e kaluara deri më sot, shumë vende në botë janë përballur me deficite të mëdha buxhetore të shkaktuara nga inflacioni i lartë dhe krizat e borxhit. Lidhur me këto janë zhvilluar politikat fiskale dhe luftimi i luhatjeve ciklike, apo me fjalë të tjera stabiliteti ekonomik.

Treguesit makroekonomikë, struktura financiare dhe struktura administrative e vendeve janë faktorë shumë përcaktues në krijimin e hapësirës fiskale. Kur dëshirohet të krijohet një hapësirë fiskale, duhet të zbatohet njëra nga metodat e krijimit të hapësirës fiskale. Por, vështirësitë e hasura në aplikimin e metodave pengojnë formimin e hapësirës fiskale. Vendet e zhvilluara ose në zhvillim do të jenë në gjendje të përmbushin qëllimet e tyre ekonomike dhe fiskale kur përpiqen të identifikojnë dhe zgjidhin arsyet që e bëjnë të vështirë formimin e hapësirës fiskale përmes shpenzimeve, taksave dhe huamarrjeve. Prandaj, vështirësitë e përmendur, mund të shqyrtohen në kategorinë e shpenzimeve, taksave dhe huamarrjeve.

### 2.5.1 Vështirësitë në politikën e shpenzimeve

Problemi kryesor me të cilin përballen sot ekonomitë e vendeve është rritja e vazhdueshme e shpenzimeve publike si rezultat i progresit shoqëror, kurse në anën tjetër të ardhurat publike nuk rriten me të njëjtin ritëm. Këtë fenomen studiuesi Adolph Wagner e emërton si Ligji i rritjes permanente të shpenzimeve publike, që edhe empirikisht dëshmohet pothuaj në të gjitha shtetet përgjatë një periudhe të gjatë kohore, posaçërisht prej Depresionit ekonomik të viteve 1929-1933 e deri në dekadën e fundit të shekullit të kaluar (Peacock & Scott, 2000). Prandaj, autoritetet publike duhet të punojnë më shumë në prioritizimin e shpenzimeve publike. Në fakt, institucionet ndërkombëtare si Banka Botërore mbështesin zbatimin e metodave që rrisin sot pritjet dhe performancën e buxheteve të vendeve lidhur me prioritizimin e shpenzimeve duke aplikuar Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) (World Bank, 2013). Prandaj, vendet që marrin vendime duke u bazuar në KASH, do të mund të parashohin limitet e shpenzimeve afatmesme dhe do të mund t'i ndërlihdhin këto limite me politikat dhe shpenzimet afatmesme.

Probleme të tilla si prioritizimi i joefikas i shpenzimeve publike dhe humbja e burimeve shpesh qëndrojnë në praktikën e gabuar të institucioneve publike, të cilat vërehen në vendet në zhvillim. Në shumicën e vendeve në zhvillim, probleme të tilla si konflikti i brendshëm, konflikti i jashtëm, korrupsioni, ushtria në politikë, tensionet etnike dhe burokracia janë domethënëse në disa vlerësime (Aizenman et al, 2018) lidhur me ndikimin negativ në strukturat financiare dhe ekonomike të vendeve. Korrupsioni zakonisht ndikon në llogaritë ekstra-buxhetore (ku ka më pak transparencë), përzgjedhjen e projekteve të investimeve dhe prokurimin e mallrave dhe shërbimeve (të mbiçmuara ose thjesht inekzistente, siç janë investimet lokale "fantazmë" ose punëtorët). Trajtimi i korrupsionit kërkon strategji që adresojnë faktorët e ofertës dhe kërkesës, dhe, në fund të fundit, forcimi i transparencës dhe praktikave të qeverisjes së mirë mund të rrisin disponueshmërinë e burimeve për zhvillimin shoqëror dhe ekonomik (Ortiz et al, 2011).

Sidoqoftë, ndërsa zvogëlimi i joefikasitetit është strategjia më e përdorur pasi që shmang tensionet politike, reformat e shpenzimeve kërkojnë kohë për të përparuar dhe nuk ka gjasa të japin burime të menjëhershme të konsiderueshme për rimëkëmbjen sociale dhe ekonomike në një periudhë afatshkurtër. Për më tepër, shpenzimet që synojnë rimëkëmbjen sociale dhe

ekonomike mund të rriten pak, por pesha e tyre relative ndaj formave të tjera të investimeve mund të jetë shumë e vogël për të siguruar një rimëkëmbje për të gjithë. Prandaj, ndërsa ri-prioritizimi i shpenzimeve të sektorit publik mund të jetë një pikë e mirë fillestare për të zgjeruar hapësirën fiskale, duhet të shqyrtohen edhe opsione të tjera (Ortiz et al, 2011).

### 2.5.2 Vështirësitë në politikën tatimore

Historikisht, taksat e mbledhura kanë qenë një e ardhur e rëndësishme për shtetin me qëllim të financimit të shërbimeve publike, ndërsa për tatimpaguesit kanë një efekt kufizues (Gale & Samwick, 2014).

Në teorinë e financave, efektet e tatimeve janë shqyrtuar nga disa këndvështrime. Nga aspekti makroekonomik, tatimet kanë efekte në krijimin dhe mbledhjen e të ardhurave publike, si dhe në stabilizimin e të ardhurave shoqërore. Ndërsa në aspektin mikroekonomik tatimet kanë ndikime të llojllojshme. Në radhë të parë subjekti i tatuar, qoftë ai person fizik apo juridik, do të përpiqet të mos e paguaj tatimin, duke bërë gjithfarëlloj veprimesh, legale dhe jo legale, që synojnë ta zhdukin krejt ose ta zvogëlojnë bazën e tatueshme, ta kalojnë barrën mbi të tjerët etj. (Bexheti, 2017).

Zvogëlimi i normës së taksave mund të inkurajojnë individët të punojnë, të kursejnë dhe të investojnë, por nëse zvogëlimi i normës së taksave nuk financohen nga shkurtimet e menjëhershme të shpenzimeve, ato ka të ngjarë të rezultojnë gjithashtu në një deficit të rritur buxhetor të vendit, i cili në planin afatgjatë do të zvogëlojë kursimet kombëtare dhe rrit normat e interesit (Gale & Samwick, 2014).

Gjatë krijimit të hapësirës fiskale, për mbledhjen efektive të të ardhurave nga taksat është shumë e rëndësishme që përveç harmonisë së tatimpaguesve është e nevojshme që edhe institucionet të miratojnë një qëndrim pro-taksave. Sepse, nëse besimi në institucionet publike është i ulët, pajtueshmëria vullnetare e taksave zvogëlohet dhe krijimi i hapësirës fiskale bëhet i vështirë (Brun et al, 2006).

Një vështirësi tjetër që ndikon negativisht në krijimin e hapësirës fiskale në lidhje me politikën tatimore janë humbjet dhe evazionet tatimore të hasura në mungesë të pajtueshmërisë vullnetare të taksave. Kalimi i ekonomisë në sektorë informalë është faktori kryesor që zvogëlon të ardhurat nga taksat. Ndërsa të ardhurat nga taksat që tejkalojnë kufirin fiskal dhe rritjen joefikase, manovrat fiskale të qeverisë do të ngushtohen dhe fleksibiliteti i zbatimit të tij do të jetë i kufizuar. Nga ana tjetër, nuk është e drejtë që qeveria të përdorë nivele të larta taksash për të krijuar hapësirë fiskale. Nivelet e larta të taksave dhe mbledhja joefektive e taksave janë faktorë që rrisin ekonominë informale (Albu, 2004). Në fakt, rritja e barrës tatimore dhe mos përcaktimi i përparësive të shpenzimeve mund të jenë faktorët që më shumë e ngushtojnë hapësirën fiskale sesa që e rrisin atë.

Sistemet bashkëkohore tatimore pretendojnë të gjejnë përmasat optimale, që është një koncept shumë kompleks dhe i diskutueshëm. Një sistem tatimor optimal paraqet baraspeshën midis dështimit të tregut (Market failure) dhe dështimit të shtetit (State failure). (Brummerhoff, 2000).

### 2.5.3 Vështirësitë në politikën e huamarrjes

Një tjetër mjet që mund të përdoret në krijimin e hapësirës fiskale është rritja e shumës së huamarrjes së brendshme apo të jashtme. Huamarrja paraqet financim alternativ të shpenzimeve publike në vend të tatimit. Thjesht huamarrja zhvendos barrën e tatimeve nga momenti aktual në një të ardhme të caktuar me çka edhe përcakton ekuilibrat dhe pritshmërinë politike. Huaja publike, krahas tatimeve, taksave dhe kontributeve shfrytëzohet për financimin e funksioneve publike të shtetit. Deri në fillim të krizës së Madhe Ekonomike (1929-1993), huaja publike konsiderohej vetëm si burim i jashtëzakonshëm i financimit të nevojave të jashtëzakonshme të shtetit, kurse pas recesionit botëror, gjithnjë nën ndikimin e teorisë ekonomike Kejnsiane, huaja publike fillon të marrë formën e burimeve të rregullta duke u shndërruar edhe në instrument ekonomik i shtetit. Ekzistojnë mendime të ndryshme lidhur me huan publike, disa ekonomistë e vlerësojnë si të pavoritshme, e disa të tjerë e arsyetojnë, madje

e rekomandojnë edhe si instrument të suksesshëm për vendosjen e dhe ruajtjen e baraspeshës dhe stabilitetit makroekonomik (Bexheti, 2017).

Një sfidë e madhe në krijimin e hapësirës fiskale është paqëndrueshmëria makroekonomike. Mos përdorimi i politikave të huamarrjes në mënyrë efektive dhe të përshtatshme gjatë përpjekjes për të krijuar burime shtesë të kërkuara për hapësirën fiskale do të shkaktojë paqëndrueshmëri makroekonomike. Përveç kësaj, dhënia e peshës më të madhe tek huamarrja më qëllim të krijimit të hapësirës fiskale dobëson qëndrueshmërinë e borxhit si dhe mund të përjashtojë investimet private (World Bank, 2006; UN, 2011).

Në kohën e fundit bie në sy fenomeni i rritjes së madhe të huas publike pothuajse në të gjitha shtetet. Por, borxhi publik i Kosovës, qëndron më mirë në krahasim me shtetet e Ballkanit Perëndimor. Borxhi publik i Kosovë në fund të vitit 2019 ka qenë 17.5%. (Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, 2021). Ndërsa Maqedonia e Veriut 40.7%, Shqipëria 65.9%, Serbia 52%, Mali i Zi 74.9%, dhe Bosnja dhe Hercegovina 23% për vitin 2019 (World Bank, 2020).

## 2.6 Përdorimi i hapësirës fiskale

Përpos krijimit të hapësirës fiskale, është mjaft e rëndësishme si, me çfarë qëllime dhe në cila fusha hapësira fiskale e krijuar do të përdoret. Sipas Heller (2005), qeveritë duhet të përdorin hapësirën e tyre ekzistuese fiskale (veçanërisht nëse krijohet përmes huamarrjes) në fusha të dobishme si sektori i shëndetësisë dhe i arsimit. Sepse sektorë të tillë kanë karakteristika që mund të ndikojnë pozitivisht në normën e rritjes ekonomike dhe të rrisin kapacitetin e të ardhurave të vendit. Gjithashtu, për shkak të ndikimit të shpenzimeve sociale (mbrojtjes sociale) në rritje ekonomike dhe zbutje të varfërisë, theksohet se hapësira fiskale ekzistuese duhet të përdoret në këto fusha (UNICEF, 2009).

Përveç kësaj, përdorimi i hapësirës fiskale varet nga shumë faktorë që do të përcaktohen bazuar në kushtet specifike të secilit vend (FMN, 2016). Ekzistojnë mendime të ndryshme se si hapësira fiskale është ose duhet të përdoret për vendet me nivele të ndryshme zhvillimi, të cilat kanë probleme të ndryshme ekonomike (Roy et al, 2012). Sipas kësaj, shihet që hapësirën fiskale vendet e pazhvilluara duan ta përdorin në luftën kundër varfërisë kronike, vendet në

zhvillim për luftimin e pabarazisë së të ardhurave dhe goditjeve, kurse vendet e zhvilluara kryesisht duan të përdorin hapësirën fiskale në luftimin e problemeve demografike (Roy et al, 2007).

Nga një perspektivë largpamëse, faktori që duhet të merret parasysh është potenciali i një vendi për të zgjeruar hapësirën fiskale. Hapësira fiskale e një vendi nuk është statike dhe trajektorja e saj përcaktohet jo vetëm nga sjellja e shpenzimeve qeveritare, por edhe nga zhvillimi i hapësirës së të të ardhurave, dhe në rast të matjes së hapësirës fiskale përmes raportit të borxhit nga PBB-së - nga evolucioni i PBB-së. Diskutimet aktuale mbi atë se si qeveritë mund të përdorin hapësirën fiskale për t'u përfshirë në një politikë fiskale mbështetëse janë përqendruar në atë se sa hapësirë fiskale mbetet akoma për manovrën fiskale, pa njohur plotësisht mundësinë e zgjerimit të hapësirës fiskale në të ardhmen (Cheng & Pitterle, 2018).

Shpesh argumentohet që investimet sociale dhe ekonomike nga të cilat përfitojnë fëmijët dhe familjet e varfra nuk janë të përballueshme ose që shkurtimet e shpenzimeve qeveritare janë të pashmangshme gjatë periudhave të rimëkëmbjes. Por alternativat ekzistojnë, madje edhe në vendet më të varfra. Gjetja e hapësirës fiskale për investime kritike ekonomike dhe sociale është e domosdoshme për rezultate të qëndrueshme të të drejtave të fëmijëve dhe zhvillimit njerëzor, veçanërisht gjatë cikleve rënëse ekonomike. Ky arsyetim nuk bazohet vetëm në efektet plotësuese të kapitalit njerëzor ndaj kapitalit fizik në përgjithësi, por gjithashtu edhe në faktin se privimet e fëmijëve mund të kenë ndikime të pakthyeshme negative në aftësitë e tyre të ardhshme dhe, si rezultat edhe perspektivën e vendeve të tyre (Ortiz et al. , 2011). Hapësira e gjerë fiskale duhet të ketë qëllimin përfundimtar ndihmën për luftimin e varfërisë (Brun et al, 2006).

Në tabelën 2 është paraqitur një kornizë treguese lidhur me mekanizmat që ndikojnë në krijimin e hapësirës fiskale, si mund të arrihet qëndrueshmëria financiare dhe treguesit që ndikojnë në ato mekanizma.

Tabela 2. Krijimi, qëndrueshmëria dhe përdorimi i hapësirës fiskale – Një kornizë treguese

| # | Mekanizmi/matja | Indikatorët |
|---|-----------------|-------------|
|---|-----------------|-------------|


|          |                                                                                                                                                                   |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
|----------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>1</b> | Mobilizimi i të ardhurave vendore<br>(matjet e taksave, forcimi i administratës tatimore)                                                                         | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rritja reale e PBB-së (%)</li> <li>• Rritja e të ardhurave nga taksa (ndryshimi vjetor në %)</li> <li>• Kthimi nga taksat (të ardhurat nga taksat si % e PBB-së)</li> </ul>                                                                                                                                                                                                                                                              |
| <b>2</b> | Riallokimi ndërmjet sektorëve<br>(shkurtimi i shpenzimet me prioritet më të ulët për të bërë vend për ato me prioritet më të lartë) dhe përfitimet e efikasitetit | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpenzime e konsumit final të qeverisë së përgjithshme (% e PBB)</li> <li>• Shpenzimet jo diskrecionale (pagat dhe interesi) (% e PBB-së)</li> <li>• Shpenzimet diskrecionale (% e PBB-së)</li> <li>• Shpenzimet e arsimit publik (% e shpenzimeve totale të qeverisë)</li> <li>• Shpenzimet e arsimit publik (% e PBB-së)</li> <li>• Shpenzimet e shëndetit publik (% e PBB-së)</li> <li>• Shpenzimet ushtarake (% e PBB-së)</li> </ul> |
| <b>3</b> | Rritja e shpenzimeve diskrecionale përmes zvogëlimit të borxhit                                                                                                   | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pika e përfundimit të Iniciativës së Vendeve të Varfra me Borxh të Rëndë</li> <li>• Stoku i borxhit të jashtëm me vlerë aktuale neto (% PBB)</li> </ul>                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| <b>4</b> | Rritja e huazimit (nga burime të brendshme ose të jashtme)                                                                                                        | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shërbimi i borxhit të jashtëm (% e eksporteve të mallrave dhe shërbimeve)</li> <li>• Shërbimi total i borxhit qeveritar (% e të ardhurave qeveritare)</li> </ul>                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| <b>5</b> | Rritja e ndihmës                                                                                                                                                  | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Grantet zyrtare (% të PBB-së)</li> <li>• Grantet zyrtare (% e shpenzimeve të</li> </ul>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |

|   |                                                                                          | qeverisë qendrore)                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
|---|------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 6 | Seigniorage (banka qendrore shtyp para për t'i dhënë hua qeverisë)                       | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Paraja e gjerë (para dhe pasuritë me likuiditet të lartës ose M2) si % e PBB-së</li> <li>• Inflacioni (çmimet mesatare të konsumit, ndryshimi vjetor %)</li> </ul>                                                                                                                                                                                                                        |
| 7 | Pritjet që shpenzimet shtesë mund të menaxhohen si duhet                                 | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlerësimi i FMN/Bankës Botërore të Menaxhimit të Shpenzimeve Publike të Iniciativës së Vendeve të Varfra me Borxh të Rëndë: numri i treguesve të përmbushur nga 15 tregues</li> <li>• Rezultatet e zgjedhura të Politikave të Vendit dhe Vlerësimi Institucional për menaxhimin ekonomik dhe menaxhimin e sektorit publik dhe institucionet</li> <li>• Efektiviteti i qeverisë</li> </ul> |
| 8 | Pritjet që shpenzimet shtesë do të rrezikojnë qëndrueshmërinë makroekonomike dhe fiskale | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kredia për sektorin privat (% e PBB-së)</li> <li>• Deficiti i llogarisë rrjedhëse duke përfshirë grantet (% e PBB-së)</li> <li>• Bilanci i përgjithshëm fiskal, duke përfshirë grantet (% e PBB-së)</li> <li>• Bilanci i përgjithshëm fiskal, duke përjashtuar grantet (% e PBB-së)</li> <li>• Deficiti fiskal jo-naftë (% PBB jo-naftë)</li> </ul>                                       |

Burimi: UNICEF. (2009). Fiscal space for strengthened social protection, fq. 23.

Nga të gjitha ato që u diskutuan më lartë, hapësira fiskale mund të paraqitet përmes një prezantimi skematik.

Figura 3. Prezantimi skematik i Hapësirës Fiskale



### Ulja e varfërisë

Burimi: Brun, J. F., Chambas, G., Combes, J. L., Dulbecco, P., Gastambide, A., Guérineau, S., ... & Graziosi, G. R. (2006). Fiscal space in developing countries. *Concept paper*. New York: UNDP, Bureau for Development Policy, Poverty Group, fq. 62.

Paraqitja skematike hedh dritë mbi ndërlidhjet kryesore në mes të përbërësve të ndryshëm të hapësirës së gjerë fiskale. Komponentët e hapësirës fiskale janë paraqitur përmes drejtkëndëshit.

Skema na tregon se përmirësimi i furnizimit me mallra dhe shërbime publike mundëson stimulimin e rritjes dhe uljen e varfërisë. Ulja e varfërisë mundëson rritjen e përpjekjeve për taksat dhe të ardhurat e qeverisë. Efekti i tij është të përmirësojë furnizimet me të mira publike, të cilat më pas mundësojnë uljen shtesë të varfërisë.

Efektiviteti më i madh i shpenzimeve publike, për shkak të transferimit ose decentralizimit të vendimeve, ka të ngjarë të përmirësojë pajtueshmërinë e përgjithshme të taksave. Ky vullnet i rritur shkakton, nga ana tjetër, një rritje në të ardhurat e qeverisë pasi evazoni fiskal zvogëlohet dukshëm. Burimet shtesë më pas mundësojnë furnizim të shtuar të mallrave dhe shërbimeve publike, gjë që forcon më tej pajtueshmërinë me taksat.

Përdorimi i tepërt i huamarrjes do të rrisë momentalisht burimet e disponueshme dhe mundëson rritjen e shpenzimeve publike. Sidoqoftë, përveç efektit negativ që ka huamarrja në motivet e konsumit familjar, ai mund të ndikojë edhe në përpjekjet për taksat, të cilat nga ana tjetër ndryshojnë të ardhurat e qeverisë, gjë që shpie në rritje të huazimit të qeverisë për të kompensuar këtë rënie të burimeve (Brun et al, 2006).

## 2.7 Ballkani Perëndimor dhe pandemia Covid-19


Ekonomia globale u përball me një ndër krizat më të mëdha në dekadat e fundit, e ndikuar nga përhapja e pandemisë Covid-19 dhe masat e ndërmarra për të kufizuar përhapjen e saj (BQK, 2020). Mbyllja e kufijve dhe izolimi total i ekonomive goditi zinxhirin prodhues global, konsumin e përgjithshëm dhe tregtinë ndërkombëtare, duke shkaktuar rënie të ndjeshme të aktivitetit ekonomik. Pandemia Covid-19 ishte një tronditje e papritur dhe e paprecedentë për ekonominë globale. Në vitin 2020, pandemia shkaktoi recesion të thellë në të gjithë vendet e Ballkanit Perëndimor, ashtu si pjesën tjetër të botës. Aktiviteti ekonomik u tkurr me rreth 3.4 përqind, që ishte rënia më e keqe në histori që prej krizës së madhe ekonomike të viteve 29/33 të shekullit të kaluar. Shkaqet kryesore ishin rënia e kërkesës së brendshme dhe të jashtme, si dhe ndërprerjet në zinxhirët e furnizimit, veçanërisht në fillim të vitit kur aktivitetet në një sërë sektorësh thjesht u mbyllën (World Bank, 2021). Recesioni dëmtoi rëndë të ardhurat publike (World Bank, 2020). Pandemia e ndali progresin e një dekade të rritjes së të ardhurave dhe uljes së varfërisë. Rënia e të ardhurave dhe rritja e nevojave për shpenzime së bashku kanë tendosur bilancet fiskale. Në vitin 2020 të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor autorizuan paketa masive ekonomike, ku si rezultat deficitet në të gjashtë vendet u përkeqësuan në mënyrë drastike, duke arritur në 6 deri në 8 për qind të PBB-së për shumicën dhe 11 për qind për Malin e Zi (World Bank, 2021).

Recesioni ishte veçanërisht i rëndë në vendet që mbështeten në turizëm dhe që nuk ishin në gjendje të miratonin paketa mjaft të mëdha stimuluese. Mali i Zi ishte vendi më i goditur: ai pësoi një kolaps 90 për qind në turizëm që shkaktoi tkurrjen e të gjithë ekonomisë, e vlerësuar në 15.2 për qind për vitin 2020. Serbia dhe Shqipëria ishin në gjendje të tejkalonin pritshmëritë e mëparshme të rritjes, Serbia pjesërisht falë një pakete të madhe stimuluese dhe Shqipëria rifillimin e rindërtimit pas tërmetit të vitit 2019. Ekonomia në Kosovë vlerësohet të jetë tkurrur me 6.9 përqind, por një program i konsiderueshëm i mbështetjes publike ndihmoi në shmangien e një recesioni më të thellë. Rritja në Maqedoninë e Veriut dhe në Bosnje dhe

Hercegovinë ishte disi më e ulët se sa pritej, për shkak të valës së dytë të fortë të infeksioneve me Covid-19 (World Bank, 2021).

Në figurën 4 është paraqitur rritja reale e ekonomisë së vendeve të Ballkanit Perëndimor për periudhën 2000-2020.

Figura 4. Rritja ekonomike e vendeve të Ballkanit Perëndimor



Burimi: Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore, Bankat Qendrore dhe Agjencitë statistikore të vendeve përkatëse


Pandemia Covid-19 ka qenë një sfidë e rëndë për financat publike. Në vitin 2020, të 6 vendet e Ballkanit Perëndimor u desh të përballeshin me një rritje të paprecedentë të deficitit fiskal, ku mesatarja rajonale ishte rreth 7.8 përqind e PBB-së - më shumë se 6 pikë përqindjeje (pp) mbi nivelet para pandemisë (World Bank, 2021). Deficitet u rritën në të gjithë rajonin kryesisht për shkak të shpenzimeve të larta publike për masat e lidhura me krizën që kanë ndihmuar në shpëtimin e jetëve dhe mjeteve të jetesës dhe kanë zbutur efektet e pandemisë në konsum dhe prodhim (World Bank, 2021). Për të ndihmuar më tej NVM-të, të gjitha vendet dhanë shtyrje tatimore; Shqipëria dhe Kosova vendosën gjithashtu përjashtime nga TVSH-ja. Në një kohë kur tkurrja ekonomike po reduktonte edhe të ardhurat, kjo mbështetje i shtyu deficitet e qeverisë përtej niveleve të regjistruara gjatë krizës financiare globale (World Bank, 2021). Shkalla e

mbështetjes ka ndryshuar sipas hapësirës fiskale në dispozicion të secilit vend. Për shembull, konsolidimi i suksesshëm fiskal i Serbisë para krizës e lejoi atë të ofronte një paketë mbështetjeje të barabartë me 13 përqind të PBB-së, nga e cila 5 përqind e PBB-së ishte në formën e garancive të kredisë dhe 8 përqind e PBB-së ishte një sërë masash të ardhurash dhe shpenzimesh. Mbështetja e Shqipërisë për COVID-19 u plotësua me mbështetjen për rindërtimin pas tërmetit (World Bank, 2021).

Niveli mesatar i borxhit të mbajtur nga qeveritë në rajonin e Ballkanit Perëndimor më 2019 ishte 49.2% e PBB-së, shumë më e ulët se mesatarja e vendeve të OECD (108.6%) (OECD, 2019). Kjo përqindje u rrit në një mesatare prej 59.9% të PBB-së në Ballkanin Perëndimor. Mali i Zi (nga 76.5% në vitin 2019, në 105.2%), Shqipëria (nga 66.3% në 77.9%) dhe Serbia (nga 52.8% në 57.8%) kanë nivelet më të larta të borxhit publik si përqindje e PBB-së në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Nivelet e borxhit ishin më të ultat në Maqedoninë e Veriut (nga 49.4% në 60.2%), Bosnjë dhe Hercegovinë (nga 32.5% në 36.7%) dhe Kosovë (nga 17.5% në 21.8%) (Banka Botërore, 2021; OECD, 2019; Ministritë e Financave të vendeve, 2021).

Në figurën 5 është paraqitur borxhi publik (% të PBB-së) për vendet e Ballkanit Perëndimor për periudhën kohore 2000 – 2020, aty ku të dhënat kanë qenë të disponueshme.

Figura 5. Borxhi publik në Ballkanin Perëndimor (% të PBB-së)



Burimi: Banka Botërore, OECD, Ministria e Financave dhe Transfereve të Kosovës


Në vitin 2019, mesatarisht, në rajonin e Ballkanit Perëndimor, qeveritë gjeneruan të ardhura që arrinin në 35.0% të PBB-së, kurse në vitin 2020 kishte një rënie të lehtë prej 34.5%. Kjo përfaqëson një përqindje të ngjashme me nivelin e ngritur në vendet e OECD (37.5%), por më e ulët se mesatarja e vendeve të BE (45.2%). Për më tepër, trendi ka shmangie në mes të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor në krahasim me vitin 2008, mesatarisht ka pasur një rënie prej 1.2 p.p. në Ballkanin Perëndimor dhe një rritje prej 1.4 p.p. në BE.

Ka ndryshime në aspektin e të ardhurave të mbledhura në mes të Ballkanit Perëndimor, si në madhësi ashtu edhe në trend. Bosnja dhe Hercegovina mbledhi 41.6% të PBB-së në 2020 (afër mesatares së BE), ndërsa Kosova mbledhi 25.5% të PBB. Për më tepër, ndërsa Mali i Zi (-5.5 p.p.), Maqedonia e Veriut (-4.2 p.p.) dhe Bosnja dhe Hercegovina (-3.9 p.p.) ulën mbledhjen e të ardhurave të tyre si përqindje e PBB-së në krahasim me 2008, Kosova e rriti atë me 1.2 p.p. (OECD, 2019; Banka Botërore, 2021; Ministritë e Financave të vendeve, 2021).

Me rënien e të ardhurave, në vitin 2020 shpenzimet publike bënë një hap historik, por investimet publike u ndalën. Të ardhurat publike në rajon shënuan një rënie nominale prej 7.3 për qind në terma vjetorë, të nxitura kryesisht nga tkurrja e aktivitetit ekonomik. Serbia pati rënien më të vogël, pavarësisht masave të konsiderueshme të të ardhurave tatimore, dhe rënia prej 13 për qind e Malit të Zi ishte më e madhja (World Bank, 2021).

Në figurën 6 janë paraqitur të ardhurat publike (% të PBB-së) për vendet e Ballkanit Perëndimor për periudhën 2000 – 2020.

Figura 6. Të ardhurat publike në Ballkanin Perëndimor (% të PBB-së)




Burimi: World Economic Outlook (WEO); Fondi Monetar Ndërkombëtar; Ministritë e Financave dhe të Ekonomisë të vendeve përkatëse

Qeveritë në rajonin e Ballkanit Perëndimor përballen me sfidën e përmirësimit të infrastrukturës dhe kapitalit njerëzor në mënyrë që të zhvillojnë ekonomitë e tyre, duke respektuar zotimet e shpenzimeve sociale dhe faturat e pagave, në kontekstin e informalitetit të përhapur dhe migrimit në ekonomi më të përparura.

Në vitin 2018, mesatarisht, qeveritë e rajonit të Ballkanit Perëndimor shpenzuan 37.4% të PBB-së, që përfaqëson një rënie prej 3.3 p.p. krahasuar me 2008. Për krahasim, vendet e BE shpenzuan 46.0% në 2018, një rënie e lehtë nga 2008 (-0.4 p.p.); dhe shpenzimet e vendeve të OECD-së mesatarisht 40.3% të PBB-së, një 0.5 p.p. ulje në të njëjtën periudhë (OECD, 2019). Shpenzimet publike u rritën mesatarisht me 6 p.p. të PBB-së në vit, mbi 9 përqind nominalisht, për shkak të shpenzimeve aktuale dhe për shkak të madhësisë së masave stimuluese fiskale të miratuara për të kundërshtuar ndikimin e recesionit të shkaktuar nga pandemia (World Bank, 2021). Në vitin 2020, mesatarja e shpenzimeve publike të Ballkanit Perëndimor ishin 42.0% të PBB-së, që përfaqëson një rritje mesatare prej 5.8% në krahasim me vitin paraprak.

Figura 7. Shpenzimet publike në Ballkanin Perëndimor (% të PBB-së)




Burimi: WEO; FMN; Ministritë e Financave dhe të Ekonomisë të vendeve përkatëse

Ndihmat e huaja kanë pësuar rënie në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor nga një mesatare prej 4.04% në vitin 2009, në 1.81% të PBB-së në vitin 2019. I vetmi vend që ka pasur rritje në vitin 2019 në krahasim me vitin 2018 ka qenë Bosnja dhe Hercegovina me një rritje prej 0.54 p.p. Kurse, në vitin 2020 pas përhapjes së pandemisë u rritën edhe ndihmat e huaja të pranuar në rajonin e Ballkanit Perëndimor për 1.3 p.p. Të gjitha vendet kishin rritje të ndihmave në vitin 2020 në krahasim me vitin paraprak, përveç Serbisë dhe Bosnja dhe Hercegovinës.

Në figurën 8 janë paraqitur ndihmat e huaja në Ballkanin Perëndimor (%GNI) 2000-2020.

Figura 8. Ndhimat e huaja në Ballkanin Perëndimor (% të GNI)




Burimi: Banka Botërore

Gjatë vitit 2020, inflacioni u ngadalësua në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Sipas vlerësimit të Eurostat, niveli i inflacionit në Eurozonë në vitin 2020 ishte - 0.25 përqind (BQK, 2020). Pandemia e Covid-19 uli shpenzimet e brendshme në të gjithë rajonin dhe rënia e çmimeve ndërkombëtare të mallrave shtoi presionet e brendshme. Inflacioni i ushqimeve kontribuoi më shumë në inflacionin total. Në Maqedoninë e Veriut, inflacioni u rrit në mënyrë të qëndrueshme gjatë vitit, në fund të vitit arriti në 2.25 për qind, më i larti në rajon. Për disa muaj, deflacion kishte në Bosnje dhe Hercegovinë (-1.6 përqind në fund të vitit), në Mal të Zi (- 0.9 përqind në fund të vitit) dhe në Kosovë (0.1 përqind në fund të vitit). Ndërsa, në Serbi dhe Shqipëri, pas rritjes së çmimeve në tremujorin e dytë dhe të tretë, inflacioni ra sërish, duke shkuar në Shqipëri nën kufirin e poshtëm të synuar prej 2–4 për qind (World Bank, 2021).

Në figurën 9 është paraqitur inflacioni (% ndryshimi) në Ballkanin Perëndimor.


Figura 9. Inflacioni (% ndryshimi) në Ballkanin Perëndimor



Burimi: WEO dhe FMN

Shumica e vendeve të Ballkanit Perëndimor kanë pasur kryesisht deficit në periudhën 2000-2019, me një trend rënës në Kosovë, Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi; me një trend të qëndrueshëm në Serbi dhe me një trend rritës, pra duke kaluar nga defici në suficit në Shqipëri dhe Bosnje dhe Hercegovinë. Kurse në vitin 2020, të gjitha shtetet pa përjashtim ishin në deficit primar me një mesatare prej -6.0%. Në rritjen e deficitit ka ndikuar rritja e shpenzimeve qeveritare me një ndikim mesatarisht prej 5.8 p.p. kryesisht për shkak të paketave masive të rimëkëmbies ekonomike për të përballuar pasojat e pandemisë Covid-19, si dhe të uljes së të ardhurave publike për shkak të mbylljes së veprimtarive ekonomike, uljes apo heqjes së tatimit për disa kategori dhe sektorë të caktuar.


Figura 10. Bilanci primar në Ballkanin Perëndimor



Burimi: WEO

Treguesi i stabilitetit politik dhe mungesës së dhunës ose terrorizmit është një tregues i indikatorëve qeveritar, që mat perceptimet e gjasave për paqëndrueshmëri politike dhe/ose dhunë të motivuar politikisht, duke përfshirë terrorizmin. Vlerësimet e vendeve bëhen përmes njësive që kanë një shpërndarje normale dhe që variojnë kryesisht nga -2.5 në 2.5 (World Bank, 2021). Vlerat më të vogla (më të mëdha) tregojnë një rrezik politik më të lartë (më të ulët). Vendet Vendet e Ballkanit Perëndimor kanë pasur një tregues me një mesatare prej -0.24, ku vlerat më të ulëta tregojnë vlerësime më të dobët për qeverisjen e një vendi. Në pozita më të përshatshme gjenden Shqipëria, Serbia dhe Mali i Zi.

Figura 11. Stabiliteti politik në Ballkanin Perëndimor



Burimi: Worldwide Governance Indicators – Banka Botërore

Informaliteti është një fenomen global i cili është mjaft i përhapur, si në shtetet e zhvilluara dhe atyre në zhvillim. Informaliteti paraqet një fenomen i cili përshkruan të gjitha aktivitetet ekonomike që zhvillohen fshehurazi nga shteti, dhe përfshin konceptet si evazionin fiskal, punësimin jo-formal dhe nën-deklarimin e pagave të punëtorëve (Riinvest, 2013).


Informaliteti ka rënë në të gjithë Evropën që nga kriza globale financiare, kur ato arritën kulmin e tyre në shumë vende, por mbetet i rëndësishëm, veçanërisht për Ballkanin Perëndimor. Ekonomia informale mbetet mesatarisht rreth 15–20 përqind e PBB-së në ekonomitë e avancuara, kurse në Ballkanin Perëndimor ka një mesatare pak mbi 35 përqind (FMN, 2019). Llogaritjet e vlerësimit të ekonomisë informale të përdorura në këtë studim janë të dhëna të bëra nga stafi i Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Ekonomia informale mund të kenë implikime të rëndësishme ekonomike dhe sociale (FMN, 2019) dhe ka tendencë të tkurr hapësirën fiskale. Prandaj, ballafaqimi me problemin që e shkakton informaliteti dhe gjetja e zgjidhjeve për këtë çështje ka një rëndësi të madhe (Riinvest, 2013). Cilësia e mjedisit të biznesit dhe reduktimi i ekonomisë informale është një dimension

vendimtar për përmbushjen e kriterëve ekonomike të Kopenhagës dhe për anëtarësimin eventual të vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE (SELDI, 2020).

Sipas Sistemit të Monitorimit të Ekonomisë së Fshehur SELDI, në mes të viteve 2016 dhe 2019 punësimi i fshehur është rritur në pesë nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor me një faktor në mes të 2.4% dhe 12.4%. Serbia është i vetmi vend që ka parë një rënie të punësimit të fshehur gjatë kësaj periudhe (me 5.7%).

Figura 12. Ekonomia informale në Ballkanin Perëndimor



Burimi: Llogaritjet e stafit të Fondit Monetar Ndërkombëtar

Ekonomia informale është e lidhur ngushtë me korrupsionin. Studimet empirike tregojnë se ato ushqejnë njëra-tjetrën - një rritje me një pikë e indeksit të korrupsionit, shoqërohet me një rritje të nivelit të ekonomisë së fshehur (në përqindje të PBB-së) me 0,253 pikë përqind (SELDI, 2020). Ekonomia informale dhe korrupsioni janë rezultat edhe simptomë e një qeverisjeje të keqe. Për shtetet e Ballkanit Perëndimor, korrupsioni ka qenë një çështje kryesore që pengon përparimin drejt standardeve të BE-së (Bak, 2019).


SELDI (2020) ka analizuar përhapjen aktuale të dy llojeve të korrupsionit në Ballkanin Perëndimor – korrupsionin administrativ (ryshfetin), i cili prek individët dhe bizneset; dhe kapjen e shtetit (korrupsionin e madh) që ndikon në funksionimin e institucioneve demokratike dhe në vendimmarrjen e qeverisë. Rezultatet tregojnë që ekzistojnë rreziqe të konsiderueshme

të kapjes së shtetit. Ndërsa, sipa SELDI (2021) për format më të vogla të korrupsionit (ryshfetit), tregon se pranueshmëria e korrupsionit mbetet relativisht e lartë në Ballkanin Perëndimor. Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia e Veriut dhe Kosova shfaqin pranueshmëri më të lartë se pjesa tjetër.

Disa studime kanë treguar se korrupsioni pengon përpjekjet për të rritur të ardhurat publike dhe hapësirën fiskale përmes kanaleve të ndryshme. Sipas (Yohou, 2020) efekti i reformës tatimore në hapësirën fiskale nuk është monoton dhe varet nga kontrolli i korrupsionit. Reforma tatimore rrit hapësirën fiskale dhe të ardhurat tatimore kur kontrolli i korrupsionit është më i mirë. Vendet që përfitojnë më shumë nga reforma tatimore janë ato që provojnë aftësi të mjaftueshme për të kontrolluar korrupsionin.

Në figurën 13 është paraqitur kontrolli i korrupsionit në Ballkanin Perëndimor, në periudhën 2000-2020. Kontrolli i Korrupsionit kap perceptimet e shkallës në të cilën pushteti publik ushtrohet për përfitime private, duke përfshirë format e vogla dhe të mëdha të korrupsionit, si dhe "kapjen" e shtetit nga elitat dhe interesat private. Vlerësimet e vendeve bëhen përmes njësive që kanë një shpërndarje normale dhe që variojnë afërsisht nga -2.5 në 2.5 (World Bank, 2021).

Figura 13. Kontrolli i korrupsionit në Ballkanin Perëndimor



### 2.7.1 Kosova


Kosova bën pjesë në vendet me të ardhura të mesme të larta, që ka pasur një rritje solide ekonomike përgjatë dekadës së fundit (World Bank, 2021). Në vitin 2020, aktiviteti ekonomik u tkurr me rreth 6.9 për qind për shkak të rënies së eksportit të shërbimeve (të ndërlidhur me diasporën), investimeve totale, dhe konsumit privat. Politikat mbështetëse dhe një ngritje domethënëse e remitançave dhe eksportit të mallrave zbutën ndikimin ekonomik të pandemisë (World Bank, 2021). Të ardhurat buxhetore në vitin 2020 pësuan një rënie vjetore prej 8.8 përqind. Shpenzimet buxhetore kishin një rritje vjetore prej 6.5 përqind. Ndërsa deficitin primar buxhetor u rrit në 7.1 përqind të PBB-së nga 2.6 përqind sa ishte në vitin 2019 (BQK, 2020).

#### *2.7.1.1 Të ardhurat publike*

Kosova ka një nivel më të ulët të të ardhurave qeveritare sesa ekonomitë evropiane, pasi baza e saj e taksave është e kufizuar. Kjo është për shkak të disa faktorëve duke përfshirë shkallën e lartë të informalitetit në ekonomi (p.sh. shumë firma dhe familje nuk kanë të drejta pronësie për pasuritë e tyre), varësinë e madhe nga dërgesat e remitançave, shkalla e ulët e pjesëmarrjes në tregun e punës (veçanërisht midis grave) dhe borxhet e mëdha tatimore të individëve dhe ndërmarrjeve (FMN, 2018).

Tkurrja ekonomike shkaktoi rënie të të ardhurave publike me gati 9 për qind (World Bank, 2021), ku të gjitha kategoritë kanë shënuar rënie (BQK, 2020), kryesisht për shkak të rënies së të ardhurave tatimore. Një ngritje domethënëse e remitençave prej 15.1 për qind i dha shtytje të ardhurave të disponueshme. Ndërkohë, transferet publike – kryesisht si rezultat i masave mbështetëse për t'iu kundërvënë ndikimit të pandemisë shënuan një rritje prej 38.3 për qind, duke mbështetur të ardhurat e disponueshme me mbi 240 milionë euro (World Bank, 2021).

Figura 14. Të ardhurat publike në Kosovë (% të PBB-së)




Burimi: WEO, FMN

#### 2.7.1.2 Shpenzimet publike

Shpenzimet qeveritare të Kosovës në 2018 ishin 29.0% të PBB-së, një rritje prej 4.7% nga 2008. Ishte e vetmja ekonomi në rajonin e Ballkanit Perëndimor që rriti shpenzimet e saj gjatë kësaj periudhe. Ndryshimi shpjegohet me përfitimet e veteranëve të luftës, të cilat tejkaluan caqet përkatëse të shpenzimeve dhe pagat e larta në sektorin publik, të cilat përfshinin lejime diskrecionale dhe pabarazi në pagë (FMN, 2018b).

Sektori fiskal u karakterizua me rritje më të lartë të shpenzimeve buxhetore krahasuar me të ardhurat (BQK, 2020). Shpenzimet publike rrjedhëse në vitin 2020 u rritën me një shkallë rekorde prej 18.6 për qind, të nxitura nga shpenzimet e lidhura me pandeminë (World Bank, 2021), ndërsa shpenzimet kapitale shënuan rënie prej 28.4 përqind (BQK, 2020).

Figura 15. Shpenzimet publike në Kosovë (% të PBB-së)



Burimi: WEO, FMN

### 2.7.1.3 Borxhi publik


Portofoli i Borxhit Shtetëror të Kosovës është krijuar në vitin 2009. Borxhi Shtetëror i Kosovës përfshin Borxhin Ndërkombëtar, Borxhin e Brendshëm dhe Garancitë Shtetërore. Që nga viti 2009 e deri në vitin 2011, portofoli i borxhit të Kosovës përbëhej vetëm nga kreditë ndërkombëtare, por që nga viti 2012, emetimi i letrave me vlerë të Republikës së Kosovës filloi të kontribuojë në rritjen e Borxhit të Përgjithshëm (Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, 2021). Borxhi Ndërkombëtar i Kosovës është huazuar me qëllim të financimit të projekteve në fusha të ndryshme, si ajo e arsimit, shëndetësisë, bujqësisë, energjisë, ujit, trajtimit të ujërave të zeza, ngrohjes qendrore, sistemit bankar etj. Gjatë vitit 2020 borxhi ndërkombëtar është huazuar edhe me qëllim të menaxhimit të pandemisë Covid-19 (Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, 2021).

Borxhi publik në vitin 2020 ka arritur në 1.5 miliard euro një rritje vjetore prej 23.9 përqind në krahasim me vitin 2019. Si përqindje e PBBsë, borxhi publik ka arritur në 21.8 përqind, nga 17.5 përqind sa ishte në vitin 2019 (BQK, 2020). Rritja e borxhit publik i atribuohet rritjes së borxhit

të brendshëm prej 21.5 përqind, si dhe rritjes së borxhit të jashtëm publik prej 28.6 përqind. Borxhi i jashtëm perbën 35.3 përqind e gjithsej borxhit publik (BQK, 2020). Në vitin 2020 Kosova financoi deficitin duke emetuar borxh të ri të brendshëm të vlerësuar në 2.5 për qind të PBB-së, duke mobilizuar 3.3 për qind të PBB-së në borxh të jashtëm koncesionar dhe duke u mbështetur në pranimet nga likuidimi (1.1 për qind të PBB-së) dhe depozitat qeveritare. Borxhi publik dhe i garantuar publikisht u rrit me 5.2 pp të PBB-së, duke arritur 22.8 për qind të PBB-së (World Bank, 2021).

Borxhi publik i Kosovës megjithëse ka një trend rritës, është në një nivel mjaft të ulët (17 % të PBB-së) në krahasim me mesataren e vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor 49.4%.

Figura 16. Borxhi publik në Kosovës (% të PBB-së)




Burimi: Fondi Monetar Ndërkombëtar, Ministria e Ekonomisë, Punës dhe Transfereve

#### 2.7.1.4 Ndihamat e huaja

Ndihamat e huaja në Kosovë edhe pse kanë një trend rënës, Kosova vazhdon të jetë një nga përfitueset më të larta të ndihmave të huaja zyrtare për zhvillim për kokë banori (OECD, 2018).

Përderisa në vitin 2009 ndihmat e huaja zinin 13.6% të PBB-së, në vitin 2019 ato përfshinë vetëm 4.3% të PBB-së, kurse në vitin 2020 kishte një rritje prej 2.6 p.p.

Figura 17. Ndhmat e huaja në Kosovë (% të GNI-së)



Burimi: Banka Botërore

#### 2.7.1.5 Rritja ekonomike

Rritja ekonomike në Kosovë në vitin 2020 parashikohej të ishte rreth 4% (WB, 2020). Sidoqoftë, për shkak të shpërthimit të Covid-19, ekonomia e Kosovës regjistroi tkurrjen e saj të parë nga shpallja e pavarësisë. Nga 2009 në 2019 rritja ishte mesatarisht 3.6 për qind.

Për të menaxhuar pandeminë Covid-19, ashtu si qeveritë e tjera, qeveria e Kosovës ka marrë masa kufizuese në aspekt të lëvizjes, udhëtimeve, aktiviteteve publike dhe jopublike, aktiviteteve në disa shërbime të ndërmarrjeve etj. (BQK, 2021). Në vitin 2020, masat kufizuese të marra kanë rezultuar në një ulje mesatare të aktivitetit ekonomik me rreth 6.9 për qind, kryesisht për shkak të një rënieje prej 51 për qind në eksportin e shërbimeve të udhëtimit,

rënies së vizitave të diasporës masave si rezultat i masave kufizuese në udhëtim të ndërmarra për të frenuar përhapjen e virusit (BQK, 2020), si dhe rënies së investimeve (World Bank, 2021).

Figura 18. Rritja ekonomike e Kosovës




Burimi: Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore, BQK

#### 2.7.1.6 Inflacioni (% e ndryshimit)

Rënia e kërkesës së përgjithshme dhe dinamika e çmimeve të mallrave kryesore në tregjet ndërkombëtare janë reflektuar në presione të dobëta inflacioniste në Kosovë. Niveli i përgjithshëm i çmimeve në vend, i shprehur përmes indeksit të çmimeve të konsumit, ka shënuar një rritje të ngadaltë prej 0.2 për qind në vitin 2020. Ky ngadalësim i rritjes së çmimeve u ndikua kryesisht nga çmimet e transportit të cilat u ulën me -5.8 për qind, çmimet e veshjeve (-0.9 për qind), çmimet e rekreacionit dhe kulturës (-0.6 për qind), çmimet e energjisë elektrike, gazit dhe materialeve. Lëndët e tjera djegëse (-0,1 për qind) etj. Çmimet e ushqimeve dhe pijeve joalkoolike u rritën me 1,7 për qind, që është një normë dukshëm më e ulët krahasuar me vitin 2019, ku u shënuar një rritje prej 5,4 për qind (BQK, 2020). Si pasojë e peshës së lartë që kanë në shportën e konsumatorit kosovar, çmimet e ushqimeve kanë kontribuar më së shumti

në ngadalësimin e rritjes së përgjithshme të çmimeve. Nga ana tjetër, si pasojë e situatës pandemike, shërbimet shëndetësore kanë shënuar rritjen më të madhe (4,7 përqind), pasuar nga çmimet e restoranteve dhe hoteleve (2,2 përqind), mjeteve të komunikimit (1,9 përqind), etj. (BQK, 2020).

Figura 19. Inflacioni (% ndryshimi) në Kosovë




Burimi: WEO, FMN

#### 2.7.1.7 Bilanci primar

Bilanci primar në Kosovë ishte kryesisht në deficit në periudhën 2002-2020, me një trend rënës. Në vitin 2020 kemi një thellim të deficitit, ku në krahasim me vitin paraprak deficitit është rritur për 4.9 p.p. Në këtë deficit ka ndikuar rritja e shpenzimeve publike për 3.6 p.p. në vitin 2020, po ashtu edhe rënia e të ardhurave publike me 1.3 p.p.

Figura 20. Bilanci primar në Kosovë




Burimi: WEO

#### 2.7.1.8 Stabiliteti politik

Treguesi i stabilitetit politik dhe mungesës së dhunës ose terrorizmit, i cili mat perceptimet e gjasave për destabilizim politik përmes mjeteve të dhunshme e të motivuar politikisht, duke përfshirë terrorizmin, që nga viti 2010 është negativ në Kosovë ashtu siç mund të shihet në figurën 21. Në vitet 2008 dhe 2009, ka pasur përmirësim të ndjeshëm, por pastaj vazhdohet me vlera negative dhe në vitin 2020 kishte një vlerësim prej -0.31.

Në figurën 21 është bërë paraqitja grafike e stabilitetit politik në Kosovë.

Figura 21. Stabiliteti politik dhe mungesa e dhunës ose terrorizmit në Kosovë



Burimi: Worldwide Governance Indicators – Banka Botërore


#### 2.7.1.9 Ekonomia informale

Ekonomia informale e Kosovës vlerësohet të jetë në një nivel më të jofavorshëm, në krahasim me pesë vendet tjera të Ballkanit Perëndimor, me një mesatare vjetore prej 38.4%. Tre komponentët që janë vlerësuar të jenë më të dëmshëm për zhvillimin ekonomik dhe social përfshijnë: mjedisi i biznesit (i ndikuar nga korrupsioni dhe kapja e shtetit); punësimi i fshehtë (të punësuarit informalë kërkojnë ryshfet) dhe evazionin fiskal (mungesa e efikasitetit të organeve tatimore dhe mungesa e besimit në qëndrueshmërinë ekonomike të një vendi) (Seldi, 2016).

Sipas Riinvest (2013), në Kosovë mesatarisht bizneset në industrinë e tyre raportojnë rreth 65.6 përqind të shitjeve, që do të thotë se 34.4 përqind të shitjeve nuk deklarohen. Mesatarisht bizneset raportojnë 63 përqind të punëtorëve të tyre, që do të thotë që në mesatare 37 përqind të fuqisë totale punëtore nuk raportohet. Ndërsa sipas SELDI (2020) Kosova mbetet vendi me punësimin më të lartë të fshehur në rajon me rreth 83% e të punësuarve që kanë një formë informaliteti në marrëdhëniet e tyre të punës. Pandemia e COVID-19 nxori në shesh

problemet e informalitetit të lartë në Ballkanin Perëndimor. Punëtorët e padeklaruar dhe bizneset që punojnë në sektor informal nuk kanë pasur mundësi që përfitojnë nga masat e qeverisë për rimëkëmbjen ekonomike (SELDI, 2020).

Figura 22. Ekonomia informale në Kosovë



Burimi: Llogaritjet e stafit të Fondit Monetar Ndërkombëtar

#### 2.7.1.10 Kontrolli i korrupsionit

Situata e korrupsionit në Kosovë është shumë e ngjashme me atë të fqinjëve të saj në rajon. Ekziston dukuri mjaft serioze në lidhje me perceptimin publik të korrupsionit, që tregon se shumica e njerëzve konsiderojnë se shumë sektorë të shoqërisë dhe segmente të qeverisë janë të njollosur me korrupsion. Një fenomen i tillë dëshmon të jetë një pengesë serioze për avancimin e proceseve demokratike dhe krijimin e një shoqërie me institucione funksionale, transparente dhe llogaridhënëse (Riinvest, 2016).


Kosova përballlet me një nivel të lartë të përhapjes së korrupsionit, mungesë të vullnetit politik për të luftuar në mënyrë serioze korrupsionin dhe me një sistem gjyqësor të dobët dhe të korruptuar. Në Kosovë ekziston agjencioni i specializuar kundër korrupsionit, i cili monitoron

dhe zbaton përpjekjet e vendit kundër korrupsionit. Por, dështimi i agjencisë kundër korrupsionit për të bashkëpunuar plotësisht me institucione të tjera, auditorin e përgjithshëm dhe prokurorinë shpesh krijon joefikasitet dhe i mungon zbatimi (Bak, 2019). Sipas IMF, përpjekjet që synojnë përmirësimin e qeverisjes dhe reduktimin e korrupsionit duhet të vazhdojnë edhe më tej (IMF, 2021).

Gjetjet e SELDI (2020) tregojnë simptoma aktuale të presionit të kapjes së shtetit nga biznesi në Kosovë, si monopolizimi që ndodh në nivel kombëtar, sektorial ose institucional. Zhvillime të tilla hasen në sektorët kryesorë ekonomikë, siç është energjitika, për shkak të niveleve të larta të përqendrimit, mungesës së transparencës dhe strukturës joefikase të qeverisjes së ndërmarrjeve shtetërore si dhe të mungesës së mbikëqyrjes së duhur rregullatore.

Në figurën 23 është paraqitur treguesi i kontrollit të korrupsionit në Kosovë, që në vitin 2020 ishte -0.45. Ndërsa në renditje të korrupsionit në botë zë vendin e 104 nga 180 shtete të përfshiera (Banka Botërore, 2021).

Figura 23. Kontrolli i korrupsionit në Kosovë



Burimi: Worldwide Governance Indicators – Banka Botërore

### 2.7.2 Maqedonia e Veriut

Republika e Maqedonisë së Veriut është një vend me të ardhura të larta të mesme që ka bërë hapa të mëdhenj në reformimin e ekonomisë së saj gjatë dekadës së fundit (World Bank, 2021).

Ekonomia e Maqedonisë së veriut është duke u rikuperuar nga recesioni më i thellë që nga pavarësia, i cili preku pothuajse të gjithë sektorët e ekonomisë. Mbështetja e qeverisë zbuti pjesërisht ndikimin e krizës te punëtorët dhe firmat, por hapësira fiskale u ngushtua me shpejtësi pasi borxhi publik arriti në 60 për qind të PBB-së (World Bank, 2021).

Deficiti i qeverisë së përgjithshme u trefishua në vitin 2020, duke arritur në 8.2 për qind të PBB-së. Të ardhurat u ndikuan nga konsumi më i ulët privat si rezultat i masave kufizuese dhe importeve, duke çuar në një rënie prej 1.3 pp (në 31.3 për qind të PBB-së), niveli më i ulët që nga viti 2014. Rënia e të ardhurave nga TVSH-ja dhe akciza në masën 1.1 për qind të PBB-së u zbut disi nga rritja e kontributeve sociale, e mbështetur kryesisht nga subvencionet e pagave të qeverisë dhe kontributeve sociale. Gjithashtu, të ardhurat jotatimore shënuan rënie me 1 për qind të PBB-së (World Bank, 2021). Në vitin 2020, shpenzimet u rritën me 4.6 për qind të PBB-së, ndërsa shpenzimet shëndetësore dhe të ndihmës sociale dhe subvencionet për të mbajtur vendet e punës u rritën. Shpenzimet për paga dhe pensione u rritën gjithashtu si rezultat i ndryshimeve të politikave para krizës (World Bank, 2021).

Si rezultat i huamarrjes së konsiderueshme publike për financimin e mbështetjes emergjente për ekonominë dhe rifinancimin e borxhit në maturim, borxhi i jashtëm ishte rritur në 79.9 për qind të PBB-së, një rritje prej 7.2 pp krahasuar me 2019-ën (World Bank, 2021). Borxhi publik dhe i garantuar publikisht (PPG) u rrit në 60 për qind të PBB-së. Qeveria rriti huamarrjen për të financuar deficitin në rritje dhe për të shlyer detyrimet e maturuara. Qeveria ishte në gjendje të rifinancoje pagesat e duhura dhe të siguroje financim për të zbutur deficitin në rritje. Huamarrja neto arriti në më shumë se 11 për qind të PBB-së (World Bank, 2021).

PBB-ja ra me 4.5 për qind në vitin 2020 – recesioni më i thellë që nga pavarësia. Recesioni ishte më i butë se sa ishte parashikuar më parë pasi recesioni u lehtësua ndjeshëm në tremujorin e katërt (TM4). Konsumi privat, më parë nxitësi kryesor i rritjes, ra ndjeshëm, me 5.6 për qind në terma vjetorë për shkak të masave të kontrollit dhe besimit të ulët të konsumatorëve. Investimet gjithashtu ranë me më shumë se 10 për qind, edhe pse në tremujorin e tretë u rikuperuan në bazë të investimeve publike në infrastrukturë. Rritja e konsumit të qeverisë prej më shumë se 10 përqind e zbuti pjesërisht rënien pasi stimuli fiskal u rrit për të mbrojtur vendet e punës dhe firmat. Ndërkohë, kërkesa e jashtme pësoi rënie, siç dëshmohet nga rënia prej 10.9 për qind në vit të eksporteve. Nga ana e prodhimit, dy sektorët që kishin qenë më parë nxitës të rritjes ishin sektorët me rëniet më të mëdha, 10.6 për qind për prodhimin dhe 7.9 për qind për tregtinë, transportin dhe turizmin. Në vitin 2020, sektorët e vetëm që u rritën ishin bujqësia; informacioni dhe komunikimi dhe pasuritë e paluajtshme (World Bank, 2021). Çmimet e konsumit u rritën me 1.2 për qind në vitin 2020, ku çmimet e ushqimeve dhe energjisë elektrike kontribuan më së shumti në rritje (World Bank, 2021).

### 2.7.3 Shqipëria

Shqipëria është shndërruar nga një nga vendet më të varfra në Evropë në një vend me të ardhura të mesme të larta (World Bank, 2021). Shqipëria u godit rëndë, fillimisht nga tërmeti i Nëntorit 2019 dhe më pas nga pandemia Covid-19. Rindërtimi dhe stimujt e lidhur me COVID-19 ndikuan në zbutjen e tronditjeve, por hapësira fiskale u ngushtua. Të ardhurat totale publike ranë në 26.5 përqind të PBB-së, pavarësisht granteve për financimin e rindërtimit, ndërsa shpenzimet publike u rritën në 33.2 përqind të PBB-së (World Bank, 2021).

Rritja e deficitit fiskal dhe zgjatja e garancive shtetërore post-COVID për sektorin privat bëri që borxhi publik të rritej në 77.4 përqind të PBB-së. Ndonëse rregulli fiskal përmban detyrimin për uljen e përvitshme të borxhit në raport me PBB-në derisa ai të arrijë në 45 përqind të PBB-së, borxhi i Shqipërisë u rrit për herë të parë që nga viti 2017 (World Bank, 2021).

Me tkurrjen e shpejtë të turizmit dhe shërbimeve, në vitin 2020 PBB-ja u zvogëlua me rreth 3.3 përqind. Pandemia COVID-19 i shkaktoi një dëm të madh një ekonomie tashmë të shkatërruar nga tërmeti i vitit 2019. Megjithatë, tronditja ndaj themeleve të ekonomisë dhe rritjes ekonomike ishte dukshëm më e vogël nga sa u mendua fillimisht. Mbyllja e sektorëve kyç për shkak të pandemisë shkaktoi një rënie të madhe të ekonomisë. Sektorët e parë që u goditën nga pandemia ishin udhëtimi dhe turizmi (World Bank, 2021).

#### 2.7.4 Serbia

Serbia ka kaluar nëpër një periudhë ndryshimesh dramatike, duke menaxhuar një mjedis politik dhe ekonomik në zhvillim të shpejtë (World Bank, 2021).

Në vitin 2020 Serbia kaloi një recesion relativisht modest të lidhur me COVID-19 prej 1 përqind. Pavarësisht ngadalësimit ekonomik, punësimi nuk u ndikua, kryesisht për shkak të programit stimulues fiskal të qeverisë. Megjithatë, mbajtja në këmbë e ekonomisë gjatë pandemisë pati një kosto të lartë: masat stimuluese përbënin gati 13 përqind të PBB-së, nga të cilat të ardhurat fiskale dhe masat e shpenzimeve kushtojnë 8 përqind të PBB-së; Prandaj, deficitin fiskal i vlerësuar i vitit 2020 është një rekord i lartë prej 8.1 përqind (World Bank, 2021).

Përpjekjet për konsolidimin fiskal të Serbisë në vitet e fundit nënkuptuan se ajo hyri në krizën COVID-19 në një pozicion të fortë fiskal që e lejoi atë të zbatonte një program të madh mbështetjeje. Paketa e madhe stimuluese e prezantuar herët ndihmoi në kufizimin e ndikimit negativ të krizës në rritje. Megjithatë, ajo çoi në një deficit fiskal rekord të lartë 2020 prej 8.1 përqind të PBB-së (World Bank, 2021).

Të ardhurat fiskale ranë me 1 përqind në terma nominalë dhe shpenzimet në vitin 2020 ishin më të larta se në vitin 2019 me 17.8 përqind. Nga ana e të ardhurave, të ardhurat jotatimore, TVSH-ja nga importi, akcizat e derivateve të naftës dhe tatimi mbi të ardhurat e korporatave ranë më së shumti krahasuar me 2019-ën. Në të njëjtën kohë, të ardhurat nga TVSH-ja e konsumit të brendshëm u rritën ndjeshëm në vitin 2020 (rritje me 30,4 përqind në terma

nominalë) (World Bank, 2021). Shpenzimet buxhetore u rritën në të gjithë bordin me një përjashtim të dukshëm: shpenzimet për asistencën sociale u ulën me 5.6 për qind në terma nominalë. Shpenzimet më të larta për subvencione përbënin një të tretën e rritjes totale të shpenzimeve buxhetore, ekuivalente me 4.6 për qind të PBB-së në vitin 2020). Shpenzimet kapitale u rritën me 10.1 për qind dhe arritën në 5.4 për qind të PBB-së (World Bank, 2021). Borxhi publik, i cili kishte rënë që nga viti 2015 në nivelin më të ulët të tetë viteve prej 52.9 përqind në 2019, në fund të vitit 2020 ishte 58.2 përqind e PBB-së (World Bank, 2021).

Pas dy vitesh rritjeje mbi 4 për qind, ekonomia serbe në vitin 2020 hyri në një recesion të shkaktuar nga pandemia. Viti 2020 filloi mirë - PBB-ja në tremujorin e parë (TM1) u rrit me 5.2 përqind, nga viti në vit - por rritja u kthye negative në pjesën e mbetur të vitit për shkak të bllokimeve të futura për të kontrolluar përhapjen e pandemisë Covid-19. Vlerësimet paraprake sugjerojnë se në vitin 2020 PBB-ja ra me 1 për qind në terma realë. Recesioni mund të ishte më i thellë nëse nuk do të kishte paketa stimuluese në kohë dhe të konsiderueshme të qeverisë prej afro 13 përqind të PBB-së (nga të cilat 4.8 përqind e PBB-së ishin në formën e garancive të kredisë dhe 8 përqind e PBB-së ishin masa të ndryshme të të ardhurave dhe shpenzimeve). Nga ana e shpenzimeve të PBB-së, konsumi dhe eksportet neto kanë pasur një kontribut negativ në rritje, ndërsa investimet kanë pasur një kontribut pozitiv. Konsumi vlerësohet të ketë rënë me rreth 1 për qind në terma realë në vitin 2020 për shkak të reduktimit të ndjeshëm të konsumit privat (në rënie me 2.5 për qind në terma realë); ndërkohë, konsumi i qeverisë u rrit me 5.6 për qind. Investimi total vlerësohet të jetë rritur me 3.3 për qind në terma realë, falë rritjes me 8 për qind të investimeve publike dhe inventarëve që ishin më të larta në terma realë me 47.7 për qind. Investimet private janë ulur në terma realë me 5.7 për qind krahasuar me vitin 2019, duke kontribuar negativisht në rritjen me 1 pp. (World Bank, 2021). Inflacioni në vitin 2020, ashtu si në vitin 2019, ka qenë i ulët dhe i qëndrueshëm, ku çmimet janë rritur me vetëm 1.3 për qind në fund të vitit (World Bank, 2021).

#### 2.7.5 Mali i Zi

Mali i Zi është një ekonomi e vogël dhe e hapur. Ajo është gjithashtu një ekonomi veçanërisht e ndjeshme ndaj goditjeve të jashtme, pasi ajo mbështetet shumë në hyrjet e kapitalit nga jashtë për të stimuluar rritjen e saj (World Bank, 2021).

Në vitin 2020, recesioni prej 15 për qind i Malit të Zi ishte një nga më të thellët në Evropë. Raporti i borxhit ndaj PBB-së arriti në 105 për qind në fund të vitit 2020; kjo kërkon një politikë fiskale të besueshme dhe të shëndoshë në periudhën afatmesme. Kriza i ofron administratës një mundësi për të forcuar institucionet publike dhe për të zbatuar reforma strukturore për rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse pas krizës (World Bank, 2021). I goditur nga një mungesë e fortë e të ardhurave dhe shpenzimeve për përgjigjen ndaj krizës, deficitin fiskal u zgjerua në 11 për qind të PBB-së. Në vitin 2020, të ardhurat e qeverisë së përgjithshme ranë me 13 për qind, të nxitura nga rënia e TVSH-së (-24 për qind) dhe të ardhurave jotatimore (-35 për qind), megjithëse të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat e korporatave u rritën me 8 për qind (World Bank, 2021).

Shpenzimet e qeverisë së përgjithshme u rritën me 4.6 për qind, pjesërisht për mbështetjen ndaj sektorit privat dhe familjeve, ndërsa vonesat në ndërtimin e autostradave uli shpenzimet kapitale me 25 për qind (World Bank, 2021). Borxhi publik arriti kulmin në 105 për qind të PBB-së në vitin 2020. Kur filloi kriza, Mali i Zi tashmë kishte një nga nivelet më të larta të borxhit publik në rajon – ai kishte arritur në 76.5 për qind të PBB-së në 2019-ën. Ndërsa deficitin fiskal u përkeqësua me krizën, qeveria tërhoqi depozitat dhe rriti huamarrjen.

Humbja e sezonit turistik të Malit të Zi në vitin 2020 çoi në një nga recesionet më të thella në Evropë. Ekonomia u tkurr me rreth 15.2 për qind në vitin 2020 pasi qëndrimet dhe të ardhurat e turistëve të huaj u ulën me pothuajse 90 për qind. Si rrjedhojë, eksportet e mallrave dhe shërbimeve ranë duke ulur rritjen me 25 pikë përqindje (p.p.) dhe duke tejkaluar kontributin pozitiv të rënies së importeve me 18 p.p. Si rezultat, eksportet neto morën pothuajse 7 pikë përqindjeje nga rritja - gati gjysma e rënies së rritjes. Kolapsi i turizmit dhe kufizimet e distancimit social pandemik së bashku uli konsumin privat, duke marrë 4.7 pp nga rritja. Pavarësisht rritjes së mbështetjes fiskale për familjet dhe bizneset, konsumi i qeverisë hoqi një tjetër 0.1 pp. Kështu, konsumi final ka zbritur një total prej 4.8 pp nga rritja. Pavarësisht

rimëkëmbjes në tremujorin e tretë, investimet gjithashtu uli rritjen, me 3.7 pikë përqindjeje (World Bank, 2021). Për shkak të goditjes së kërkesës dhe rënies së çmimeve të naftës, deflacioni mbizotëroi për pjesën më të madhe të vitit 2020. Inflacioni ishte mesatarisht -0.3 për qind ndërsa çmimet ranë për transportin, veshjet dhe shërbimet komunale, megjithëse çmimet u rritën për ushqimet, pijet dhe kujdesin shëndetësor.

#### 2.7.6 Bosnja dhe Hercegovina

Bosnja dhe Hercegovina është një vend me të ardhura të mesme të larta, i cili ka arritur shumë që nga mesi i viteve 1990 (World Bank, 2021).

Pandemia gjeneroi një tkurrje të konsiderueshme të prodhimit prej 4.3 përqind në 2020 për shkak të një ngadalësimi të kërkesës së brendshme, një mjedisi të dobët të jashtëm dhe pasigurisë akute politike. Ndërsa bota rimëkëmbet nga kriza COVID-19 dhe me përparimin në Programin e Reformës Ekonomike të BiH-së, rritja pritet të rikuperohet gradualisht. Kriza nxjerr në pah nevojën e vendit për reforma strukturore të vonuara prej kohësh për të përshpejtuar rimëkëmbjen (World Bank, 2021).

Në vitin 2020, rënia e të ardhurave u ndikua kryesisht nga rënia në mbledhjen e të ardhurave tatimore, veçanërisht për taksat indirekte. Në vitin 2020 shpenzimet u rritën për shkak të shpenzimeve aktuale më të larta për masat që lidhen me krizën, si për sektorin e shëndetësisë ashtu edhe për mbështetjen për biznesin. Deficiti është financuar kryesisht nëpërmjet huamarrjes brenda vendit dhe nga huadhënësit shumëpalësh. Borxhi total publik dhe i garantuar publikisht në vitin 2020 vlerësohet të ketë qenë 39.6 për qind e PBB-së, me 5.1 pp nga një vit më parë, nga të cilat 31.1 për qind e PBB-së është borxh i jashtëm publik, i cili është kryesisht koncensionar dhe i detyrohet institucioneve financiare ndërkombëtare. (World Bank, 2021). Për të zbutur ndikimin e pandemisë, qëndrimi fiskal i Bosnjës dhe Hercegovinës u kthye në ekspansion. Një deficit fiskal prej 5.4 përqind të PBB-së pritet për vitin 2020, nga suficiti prej 1.9 përqind në 2019-ën (World Bank, 2021).

Në vitin 2020 rritja ishte pozitive në tremujorin e parë (TM1), por pasi masat e bllokimit dhe frenimit u futën në tremujorin e dytë, ekonomia u ndal në një ndalesë të papritur pasi kërkesa e brendshme dhe e jashtme ranë. Në tremujorin e katërt, kërkesa e brendshme dhe aktiviteti ekonomik ishin forcuar, por rritja vjetore mbeti negative me konsumin e përgjithshëm në rënie me 3.4 pikë përqindje (pp) dhe investimet 4.7 pikë përqindje (World Bank, 2021). Me rënien e kërkesës dhe uljen e çmimeve të naftës, në vitin 2020 deflacioni u kthye. Në dhjetor, indeksi i çmimeve të konsumit ra me 1.6 për qind në terma vjetorë. Tendencat më të forta deflacioniste erdhën nga dy kategori që së bashku përbëjnë 30 për qind të shportës së IÇK-së: çmimet e transportit, me 8.6 për qind në vit, dhe çmimet e veshjeve dhe këpucëve, me 10 për qind (World Bank, 2021).

### **III. QASJET E NDRYSHME RRETH MATJES SË HAPËSIRËS FISKALE**

Përveç që nuk ka një konsensus unanim lidhur me definimin dhe përkufizimin e hapësirës fiskale, është e vështirë të thuhet që ekziston një konsensus edhe për vlerësimin e saj në vende të ndryshme. Me fjalë të tjera, matja e hapësirës fiskale, e cila është shumë e vështirë të përcaktohet me anë të një rregulli mekanik ose pragu, kërkon analizë duke përdorur mjete të ndryshme për shkak të pragjeve të qëndrueshmërisë së borxhit, goditjeve të mundshme dhe institucioneve ekonomike që ndryshojnë nga vendi në vend (IMF, 2016).

Në literature ekzistojnë qasje të ndryshme lidhur me atë se si duhet të bëhet matja e hapësirës fiskale, si për shtetet e zhvilluara, ashtu edhe ato në zhvillim. Në fakt, hapësira fiskale duhet të vlerësohet veçmas për secilin vend dhe mund të ndërtohet në varësi të kushteve aktuale makroekonomike, politike dhe kulturore të secilit vend.

#### **3.1 Qasja e FMN-së**

Hapësira fiskale si dukuri, mund të thuhet që ka filluar me përpjekjet për ta matur atë. Metodat e përdorura në fillim kanë qenë më të thjeshta se sa ato që përdoren sot. Prandaj, FMN-ja është një nga prijësit e studimeve lidhur me hapësirën fiskale.

Shihet që FMN i afrohet matjes së hapësirës fiskale si një manifestim i përpjekjeve të tij për të krijuar hapësirë shtesë fiskale. Prandaj, hapësira fiskale e një vendi mund të vlerësohet bazuar në atë se sa mund të zbatohet për të ardhurat publike, shpenzimet, ndihmën e huaj dhe politikat e huazimit, të cilat janë ndër metodat e krijimit të hapësirës fiskale.

Faktori i parë që modeli i FMN-së merr parasysh kur analizon situatën makroekonomike të një vendi është nëse infrastruktura dhe shpenzimet e programeve sociale po dëmtojnë stabilitetin makroekonomik ose qëndrueshmërinë e borxhit. Faktori i dytë është nëse mund të krijohet apo jo një hapësirë fiskale nga ato shpenzime që kalojnë vlerësimin e parë. Është e pashmangshme që qeveritë të aplikojnë në bankën qendrore nëse shpenzime të tilla dëmtojnë stabilitetin

makroekonomik ose qëndrueshmërinë e borxhit. Kjo do të sjellë nivele të larta të inflacionit të pasuara nga dëmtimi i rritjes dhe varfërinë. Prandaj, është e nevojshme të gjendet një burim që nuk ndikon negativisht në qëndrueshmërinë fiskale dhe qëndrueshmërinë e borxhit për sa i përket shpenzimeve në infrastrukturë dhe programe sociale, të cilat janë dy faktorë të rëndësishëm për zhvillimin e vendeve (Heller, 2005).

Qasja e FMN-së ka një strukturë relativisht të thjeshtë. Sidoqoftë, kjo thjeshtësi përbën më shumë disavantazhin sesa avantazhin e qasjes. Për shkak se kjo qasje bie në sy që është larg analizës së thellë analitike dhe është një metodë numerike. Për shembull, qasja nuk lejon vlerësimin ndër-kohor dhe përjashton nga analiza treguesit e rëndësishëm financiarë të vendit, si subvencionet, pasuritë publike, etj. (Heller, 2005).


### 3.2 Qasja "Diamanti i hapësirës fiskale"

Diamanti i hapësirës fiskale (apo diamanti fiskal), paraqet një nga metodat e përdorura për të krijuar hapësirën fiskale. Sipërfaqja totale e diamantit i referohet hapësirës totale fiskale që posedon një vend. Në çdo cep të formës që përfaqëson diamantin gjenden mjete të ndryshme të politikës fiskale që mund të përdoren në krijimin e hapësirës fiskale (Roy et al., 2007). Këto mjete të politikave, të vendosura në të katër cepat e fushës fiskale, e cila paraqet një pasqyrë të thjeshtuar të hapësirës fiskale, janë të ardhurat publike, shpenzimet publike, ndihma e huaj dhe huamarrja (Development Committee, 2006). Nëse ndonjëri nga këto mjete është relativisht më i lartë tregon se diamanti i hapësirës fiskale do të zgjerohet në atë drejtim.

Ekzistojnë pesë hapa në ndërtimin e diamantit. Këto hapa janë: përcaktimi i kushteve makroekonomike dhe çështjet e zhvillimit njerëzor, identifikimi i sfidave fiskale afatshkurtra dhe afatgjata, të identifikohet nëse sfidat janë ekzogjene ose endogjene në periudhë afatshkurtër, ndërtimi i diamantit, dhe paraqitja e kornizës së përgjithshme analitike (Roy et al, 2012).

Në figurën 74, është paraqitur një shembull i diamantit të hapësirës fiskale. Në anën e djathtë të diamantit gjendet përpjekja e përmirësimit të ardhurave publike (% e PBB-së), në anën e majtë efikasiteti i përmirësuar i shpenzimeve publike (% e PBB-së), në pjesën e sipërme rritja e ndihmës së huaj për grande (% e PBB-së) dhe në anën e poshtme huamarrja e re (% e PBB-së). Çdo mundësi e hapësirës fiskale që mund të merret veç e veç përmes këtyre mjete nxjerr në pah formën e diamantit në total. (Roy et al., 2007). Natyra e kësaj qasjeje, e cila nuk merr parasysh karakteristikat ekonomike të vendeve, eliminon mundësinë për të bërë një krahasim midis vendeve. Për shembull, nëse ekziston mundësia që në një vend hipotetik të rriten të ardhurat publike me 4% dhe ndihmën e huaj 3% , ndërsa si rezultat i rishikimit dhe ripriorizimit të shpenzimeve publike të jetë e mundur rritja prej 2%, si dhe të ketë një burim shtesë paralel me mundësinë e huazimit deri në 2% më shumë, diamanti i hapësirës fiskale do të ketë pamjen siç paraqitet në figurën 3 (Development Committee, 2006).

Figura 24. Diamanti i Hapësirës Fiskale



Burimi: Development Committee (2006). "Fiscal Policy for Growth and Development: An Interim Report". Poverty Reduction and Economic Management. World Bank fq.18.

Qëllimi i hapësirës fiskale është të njohë mundësitë makroekonomike të nevojshme nga politikëbërësit në mënyrë që të ketë hapësirën e nevojshme fiskale për të arritur politikat e ndjekura. Për të diagnostikuar një hapësirë të tillë fiskale, duhet të njihen padyshim karakteristikat e vendeve (Roy et al., 2007).

Mund të thuhet se kjo qasje është një formë e përparuar e përpjekjeve të FMN-së për të matur hapësirën fiskale. Me fjalë të tjera, në qasjen e FMN-së, gjatë matjes së hapësirës fiskale të vendeve, të ardhurat dhe shpenzimet publike, ndihmat e huaja dhe instrumentet e politikës së huamarrjes vlerësohen një nga një. Ndërsa, qasja "diamanti i hapësirës fiskale" e zhvillon më tej këtë metodë dhe kryen një analizë totale bazuar në këto mjete. Kjo është ndryshimi thelbësor në mes të këtyre dy qasjeve.

Qasja e hapësirës fiskale është një mjet veçanërisht i dobishëm për të zbuluar pamjen e potencialit të hapësirës fiskale. Sidoqoftë, arritja e rezultateve më reale kërkon domosdoshmërisht një analizë më të thellë. Është e qartë se për vendet me karakteristika të ndryshme ekonomike, analizat e hollësishme bazuar në kushtet e tyre specifike do të jenë më të dobishme (Development Committee, 2007). Ndërsa natyra e kësaj qasjeje eliminon mundësinë për të bërë një krahasim midis vendeve.

### 3.3 Qasja e Aizenman - Jinjark (2010)

Duke e konsideruar hapësirën fiskale si një variabël të matshme, Aizenman dhe Jinjark (2010) shtuan frazën "de facto" në fillim të konceptit me një qasje origjinale dhe bënë një përkufizim si në vijim: "Hapësira fiskale de facto përfshinë burimet e përdorura në pagimin e borxhit publik në kohë kur taksat nuk mund të mbledhen (në periudhat e mbledhjes së ulët të taksave)." (Aizenman & Jinjark, 2010). Matja e hapësirës fiskale mund të bëhet përmes formulës:

$$Hapësira\ fiskale\ de\ facto = \frac{Borxh\ publik}{Të\ ardhurat\ nga\ taksat} \quad (1)$$

Aizenman dhe Jinjark (2012) përmes kësaj metode kanë llogaritur hapësirën fiskale të 123 vendeve (për periudhën para krizës globale financiare). Kur bëhet një vlerësim brenda grupeve të vendeve për sa i përket nivelit të të ardhurave, shihet se vendet me hapësirën më të ulët fiskale për periudhën para krizës janë vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme. Për shkak se këto vende kanë borxhin publik / bazën mesatare të taksave më të larta (Aizenman & Jinjark, 2012).

Përveç kësaj, bëhet edhe një llogaritje e hapësirës fiskale mbi deficitet fiskale. Në këtë metodë alternative të matjes së hapësirës fiskale, deficitit buxhetor përdoren në vend të borxhit publik (Aizenman & Jinjark, 2010):

$$Hapësira\ fiskale\ de\ facto = \frac{Deficiti\ buxhetor}{Të\ ardhurat\ nga\ taksat} \quad (2)$$

Sipas kësaj, është bërë një llogaritje e hapësirës fiskale duke llogaritur raportin ndërmjet deficitit buxhetor dhe të ardhurave tatimore për periudhën 2000-2006 (Aizenman & Jinjark, 2010). Përveç kësaj, Aizenman et al. (2011) në mënyrë empirike llogaritën çmimin e rrezikut të përcaktuar në treg lidhur me krizat e borxhit publik të përjetuara në periudhën e krizës në 60 vende duke përdorur këto dy metoda të llogaritjes së hapësirës fiskale. Hapësira fiskale nuk është e vetmja variabël e përdorur në këtë llogaritje. Përveç kësaj, norma e interesit të huaj, borxhi i jashtëm, hapja ndaj tregtisë së jashtme, inflacioni, të ardhurat për kokë banori dhe rritja ekonomike janë variabla të tjerë të marra në konsideratë. Një nga përfundimet e rëndësishme të arritura në këtë studim është se hapësira fiskale luan një rol të rëndësishëm në çmimin e rrezikut.

### 3.4 Qasja Ostry et al. (2010)

Ostry et al. (2010) përkufizon hapësirën fiskale si diferencën në mes të nivelit aktual të borxhit të vendeve dhe kufirit të borxhit të përcaktuar në mënyrë analitike dhe duke zbuluar

karakteristikat ekonomike të këtyre vendeve. Prandaj, në mënyrë që të llogaritet hapësira fiskale duhet të llogaritet kufiri i borxhit. Kështu që, fillohet me llogaritjen e funksionit primar të reagimit të ekuilibrit, i cili është përgjigja e bilancit primar ndaj shumë variabla ekonomike dhe joekonomike, kryesisht borxhit. Gjithashtu në llogaritje përfshihet diferenca në mes të normës së interesit dhe normës së rritjes, që ndikon ndjeshëm në stokun e borxhit. Duke kombinuar këta dy faktorë të rëndësishëm (funksioni i reagimit dhe diferenciali) në një ekuacion standard të kufizimit të buxhetit, do të gjendet kufiri i borxhit të një vendi. Distanca e këtij kufiri të llogaritur (kufiri i borxhit) nga niveli aktual i borxhit të vendeve paraqet hapësirën fiskale. Opinioni i përgjithshëm është që qasja që duhet ndjekur për matjen e hapësirës fiskale duhet të jetë metoda që merr parasysh ndryshoret makroekonomike dhe presionet fiskale që mund të shkaktohen nga goditjet në mënyrën më gjithëpërfshirëse (FMN, 2016). Në këtë kontekst, qasja e Ostry et al. (2010) është metoda që merr më së shumti parasysh gjendjen e ekuilibrit të përgjithshëm në matjen e hapësirës fiskale.

### 3.5 Qasja Park (2012)

Park (2012) përdor një mënyrë mjaft interesante për të matur hapësirën fiskale. Për këtë qëllim përdor lakoren Laffer, e cila përshkruan se si të ardhurat nga taksat mund të maksimizohen. Në këtë rast, hapësira fiskale përcaktohet si diferenca në mes të të ardhurave tatimore aktuale dhe të ardhurave nga taksat që mund të merren në kulm të kurbës Laffer. Prandaj, një tkurrje në hapësirën fiskale është zbuluar në disa vende për shkak të plakjes së popullsisë. Kjo tkurrje është për shkak të uljes së të ardhurave publike të shkaktuara nga rritja e shpenzimeve publike me plakjen e popullsisë dhe ulja e orëve të punës paralelisht me uljen e popullsisë së re (Park, 2012).

Prandaj, sipas Park (2012), kërkohen masa korrigjuese të tilla si një reformë në sistemin e pensioneve dhe një politikë fleksibël e shpenzimeve në mënyrë që të zvogëlohet ndikimi negativ i plakjes së popullsisë në hapësirën fiskale në këto vende.

### 3.6 Shqyrtimi empirik

Megjithëse hapësira fiskale është një koncept mjaft i ri, ajo ka tërhequr vëmendjen e shumë hulumtuesve dhe akademikëve. Kose et al. (2017) prezantuan një bazë të të dhënave gjithëpërfshirëse ndërvendore të hapësirës fiskale të mbi 200 vendeve gjatë periudhës 1990-2016 që përfshin 28 tregues të hapësirës fiskale, të grupuar në katër kategori: qëndrueshmëria e borxhit qeveritar; përbërja e bilancit; borxhi i sektorit të jashtëm dhe privat; dhe perceptimi i tregut për rrezikun sovran. Secila nga këto kategori mbulon një dimension të ndryshëm të hapësirës fiskale.

*Qëndrueshmëria e borxhit qeveritar:* Matjet e qëndrueshmërisë së borxhit dhe ekuilibrit fiskal i referohen kapacitetit afatgjatë të qeverisë për të financuar detyrimet e saj. Grupi i treguesve të qëndrueshmërisë së borxhit qeveritar përbëhet nga dymbëdhjetë variabla: Bilanci primar (në % të PBB-së); bilanci fiskal (në % të PBB-së); borxhi bruto i qeverisë së përgjithshme (në % të PBB-së); hendeku i qëndrueshmërisë, bilanci primar (kushtet aktuale, në % të PBB-së); bilanci fiskal (përqindja e të ardhurave mesatare të taksave); borxhi bruto i qeverisë së përgjithshme (përqindja e të ardhurave mesatare të taksave)

*Përbërja e bilancit:* Përbërja e bilancit mund të ndikojë në ekspozimet ndaj rreziqeve të një ndryshimi të papritur të kushteve të tregut financiar. Tërësia e treguesve përqendrohet në strukturën e balanceve sovrane, përfshirë burimet e financimit, strukturën e monedhës dhe profilin e maturitetit. Në këtë kategori përfshihen gjashtë variable: borxhi i qeverisë së përgjithshme në valutë të huaj në përqindje të borxhit total të përgjithshëm të qeverisë; letrat me vlerë të borxhit të mbajtura nga jorezidentët në përqindje të gjithsej letrave me vlerë të borxhit; borxhi i përgjithshëm i qeverisë i mbajtur nga jorezidentët në përqindjen e borxhit total të qeverisë së përgjithshme; rezervat koncesionare të borxhit të jashtëm në përqindje të borxhit bruto të qeverisë së përgjithshme; maturiteti mesatar i borxhit sovran; dhe borxhi i qeverisë qendrore që maturohet në 12 muaj ose më pak në përqindje të PBB-së.

*Borxhi i sektorit të jashtëm dhe privat:* Grupi i treguesve të borxhit të sektorit të jashtëm dhe privat përfshin matjet e madhësisë dhe përbërjes së borxhit total të jashtëm të një vendi,

lidhjen e tyre me rezervat valutore dhe detyrimet e sektorit privat. Variablat në këtë kategori janë: rezervat totale të borxhit të jashtëm në përqindje të PBB-së; borxhi i jashtëm në valutë të huaj në përqindje të borxhit total të jashtëm; rezervat e borxhit të jashtëm privat në përqindje të PBB-së; kredia e brendshme për sektorin privat në përqindje të PBB-së; rezervat e borxhit të jashtëm afatshkurtër në përqindje të gjithsej stokeve të borxhit të jashtëm; rezervat e borxhit të jashtëm afatshkurtër në përqindjen e rezervave totale; rezervat totale të borxhit të jashtëm në përqindje të rezervave totale; dhe rezervat totale të borxhit të jashtëm në përqindjen e rezervave duke përjashtuar arin.

*Perceptimi i Tregut për rrezikun sovran:* Databaza përfshin treguesit e perceptimit të tregut mbi aftësinë e një vendi për të transferuar borxhin, ose për të emetuar borxh të ri, dhe për koston e tij të huamarrjes në treg. Treguesit e perceptimit të tregut mund të shërbejnë si përfaqësues me frekuencë të lartë për qëndrueshmërinë fiskale. Ata shpesh janë në dispozicion kur informacioni në kohë për bazat makroekonomike nuk është. Variablat e përfshiera janë përhapja 5-vjeçare e CDS-së sovrane dhe vlerësimet e borxhit afatgjatë në valutë të huaj nga agjencitë kryesore të vlerësimit ndërkombëtar (të vlerësuara nga 1-21 [më e mira]).

Korrelacionet e thjeshta ndërmjet treguesve mbështesin ndarjen e tyre në katër grupe. Ata i kanë kategorizuar vendet në dy grupe, vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim. Rezultatet kryesore të studimit të tyre janë si në vijim: hapësira fiskale ishte përmirësuar në shumë vende përpara krizës financiare globale. Në vendet e zhvilluara, pas përkeqësimeve të rënda gjatë krizës, shumë tregues të hapësirës fiskale janë kthyer praktikisht në nivelet e mesit të viteve 2000. Në të kundërtën, hapësira fiskale është tkurrur në shumë vende në zhvillim që nga kriza. Për më tepër, rezultatet tregojnë se vendet e zhvilluara kanë hapësirë më të madhe fiskale se vendet në zhvillim. Vendet e zhvilluara kanë pasur vazhdimisht raporte të konsiderueshme më të ulëta borxhi ndaj të ardhurave dhe një pjesë të konsiderueshme më të ulët të borxhit në valutë të huaj.

IMF (2016a) propozoi një kornizë të re me katër faza për të vlerësuar hapësirën fiskale në një mënyrë që të jetë gjerësisht e krahasueshme në të gjithë vendet. Korniza e përshkruar në punim fokusohet në vlerësimin e disponueshmërisë së hapësirës, por jo në përdorimin e saj. Të

kesh hapësirë fiskale nuk do të thotë domosdoshmërisht se është optimale për ta përdorur atë. Ndërsa në vitin 2018 FMN zgjeroi kornizën për të forcuar analizën e hapësirës fiskale, duke përfshirë 34 ekonomi të avancuara dhe tregje në zhvillim (IMF, 2018). Si në punimin e Kose et al. (2017), gjithashtu IMF (2018) zbuloi se vendet e zhvilluara kanë më shumë hapësirë fiskale sesa tregjet në zhvillim, kryesisht për shkak se financimi i tyre është më i sigurt, duke reflektuar në masë të madhe besueshmëri më të madhe dhe fuqinë institucionale. Disavantazhi kryesor i qasjes së FMN-së është se ka një strukturë relativisht të thjeshtë. Për shkak se korniza e FMN-së është larg nga analiza e thelluar analitike, ajo nuk përfshin ndonjë model empirik të përdorur, por më shumë është një metodë numerike.

Zandi et al. (2011) përdorën qasjen e Ostry et al. (2010) për të vlerësuar hapësirën fiskale duke përdorur funksionin e reagimit të bilancit primar për 30 vende me regresion të panelit me efekte fikse gjatë periudhës 1985-2007. Rezultatet e regresionit treguan se marrëdhënia ndërmjet bilancit primar dhe hendekut të prodhimit (output gap) është pozitive. Hendeku i shpenzimeve qeveritare (government expenditure gap) ka një ndërlidhje negative me bilancin primar. Shumica e vendeve eksportuese të naftës mbështeten shumë në të ardhurat e krijuara nga taksat, prandaj çmimet më të larta të naftës rezultojnë në një bilanc primar më të mirë. Vendet me hapësirën më të madhe fiskale janë vendet skandinave dhe ato aziatike. Belgjika dhe Spanja kanë pak hapësirë fiskale; Franca dhe Britania e Madhe kanë një hapësirë të mjaftueshme fiskale; SHBA dhe Gjermania kanë një sasi të konsiderueshme të hapësirës fiskale të mbetur. Ndërsa pesë vende kanë mbetur pa hapësirë fiskale, Greqia, Irlanda, Italia, Japonia dhe Portugalia. Këto rezultate janë të ngjashme me ato të Ostry et al. (2010). Përrjashtim bën vetëm Irlanda që ka më shumë hapësirë fiskale në studimin e Ostry-t.

Ghosh et al. (2011) ofruan gjithashtu vlerësime empirike të hapësirës fiskale të disponueshme për 23 vende të zhvilluara gjatë periudhës 1970–2007, me një marrëdhënie jolineare në mes të bilancit primar dhe borxhit publik. Ata gjetën mbështetje të fortë për ekzistencën e një marrëdhënieje jolineare ndërmjet bilancit primar dhe borxhit publik të vonuar. Rezultatet tregojnë se Greqia, Italia, Japonia dhe Portugalia kanë hapësirë më të vogël fiskale; Islanda, Irlanda, Spanja, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Mbretëria e Bashkuar kanë pak hapësirë

fiskale. Në të kundërtën, Australia, Koreja, Zelanda e Re dhe vendet nordike duket se kanë hapësirë të madhe fiskale për t'u marrë me goditjet e papritura. Rezultatet empirike janë në përputhje me gjetjet e Mendoza dhe Ostry (2008) për vendet industriale.

Bastos dhe Pineda (2013) ndoqën qasjen e Ostry et al. (2010) për të përcaktuar hapësirën fiskale për 26 shtetet braziliane ndërmjet viteve 2000 dhe 2011 si diferencën në mes të borxhit aktual të një shteti dhe kufirit teorik të borxhit të nënkuptuar nga sjellja historike e politikëbërësve të tij. Për të vlerësuar hapësirën fiskale, ata përdorën funksionin e reagimit të bilancit primar përmes një regresioni të të dhënave të panelit me efekte fikse. Rezultatet tregojnë se, pas një dekade konsolidimi fiskal, një numër shtetesh kanë hapësirë fiskale, por mbetet një heterogjenitet i rëndësishëm në të gjithë shtetet braziliane. Në punimin e tyre "Hapësira fiskale në euro zonë", Hajnovic et al. (2013) prezantuan një qasje për përcaktimin e nivelit kritik të borxhit në Bashkimin Evropian, duke përdorur të dhënat nga viti 1995 deri në vitin 2008. Kjo qasje, e sugjeruar fillimisht nga Ostry et al. (2010) është përshtatur, duke reflektuar kryesisht faktin se punimi trajton një grup të ndryshëm vendesh (BE) nga ai origjinal (vendet e zhvilluara të OECD-së). Ata vlerësuan funksionet e reagimit fiskal të qeverive në Bashkimin Evropian me regresionin e panelit me efekte fikse. Ata supozuan se reagimi është deri në polinom të shkallës së katërt dhe përtej reagimit ndaj borxhit total, bilanci primar ndikohet gjithashtu nga hendeku i prodhimit dhe hendeku i shpenzimeve të qeverisë. Rezultati tregon se BE-ja në tërësi kishte hapësirë mjaft të madhe fiskale (2009). Disa vende individuale të BE-së kishin gjithashtu hapësirë të mjaftueshme fiskale, ndër të tjera Finlanda. Përkundrazi, disa vende ishin tashmë afër nivelit kritik të borxhit (Italia, Greqia) në vitin 2009 dhe hapësira e tyre fiskale ishte shteruar praktikisht.

Nerlich dhe Heinrich Reuter (2015) analizuan ndërveprimin e rregullave fiskale dhe hapësirës fiskale. Ata llogaritën hapësirën fiskale, bazuar në qasjen e Ostry et al. (2010) me përkufizim të zgjeruar të hapësirës fiskale në përputhje me metodologjinë e Ghosh et al. (2013), për 27 shtete anëtare të BE-së që mbulojnë periudhën 1990-2014. Për të përfituar hapësirën fiskale, kufiri i borxhit llogaritet nga regresioni i funksionit të reagimit të bilancit primar në nivelet e borxhit të kaluar dhe krahasohet me nivelin aktual të borxhit. Ata gjetën se rregullat fiskale janë

në korrelacion të fortë me hapësirën më të lartë fiskale. Për më tepër, analiza tregon se vendet me më shumë hapësirë fiskale priren të kenë shpenzime më të larta diskrecionale, por që ky efekt zvogëlohet ndjeshëm nëse ekzistojnë rregulla fiskale.

Baum et al. (2017) llogaritën hapësirën fiskale të vendeve me të ardhura të ulëta si distancën ndërmjet nivelit aktual dhe nivelit të sigurt të borxhit. Si kufi të borxhit përdorën pragjet e borxhit nga Korniza e Qëndrueshmërisë së Borxhit (Debt Sustainability Framework-DSF). Qasja është e ngjashme me qasjes e Ostry et al. (2010), por duke e përshtatur atë me kontekstin vendeve me të ardhura të ulta. Ata vlerësuan empirikisht një funksion reagimi fiskal për një panel me të dhëna të pabalancuara prej 27 vendesh me të ardhura të ulta gjatë periudhës 2003–2013 me Blundell-Bond System GMM si vlerësues kryesor. Punimi tregon se hapësira fiskale ndryshon shumë varësisht nga natyra e pasigurisë. Hapësira fiskale e disponueshme me goditje relativisht të lehta është dyshifrore, por nuk do të jetë e mjaftueshme për të plotësuar të gjitha nevojat për shpenzime në vendet me të ardhura të ulëta. Fotografia bëhet edhe më e zymtë në kushte më ekstreme. Në veçanti, një përsëritje e goditjeve makroekonomike të viteve 1990 mund të ulë hapësirën fiskale përafërsisht të tretën, ndërkohë që luhatjet e mëdha në çmimet e mallrave mund ta zhdukin atë plotësisht në rastin e eksportuesve të mineraleve. Romer dhe Romer (2019) përcaktuan dhe matën hapësirën fiskale sipas këndvështrimit të Ghosh et al. (2013) dhe Kose et al. (2017). Ata kryen regresione me të dhëna panel dhe matën hapësirën fiskale si negativin e raportit të borxhit publik ndaj PBB-së për 30 vendet e OECD-së për periudhën 1980-2017. Rezultatet tregojnë se përgjigja fiskale e një vendi ndaj një krize lidhet me raportin e tij të mëparshëm të borxhit ndaj PBB-së. Vendet që përballen me një krizë me borxh më të ulët ndjekin një politikë fiskale më ekspansioniste sesa vendet që përballen me një krizë me borxh më të lartë.

Roy et al. (2012) analizuan hapësirën fiskale të shteteve arabe. Diamanti i hapësirës fiskale përdoret si një pajisje për të shpjeguar se si do të dukej një kornizë analitike. Diamanti i katër shtylla, të ardhurat publike, shpenzimet publike, huammarrja dhe ndihmat e huaja. Por, duke pasur parasysh rëndësinë relativisht të ulët të ndihmave zyrtare për zhvillim (ODA) në rajonin arab, fokusi ishte në tre elementët e tjerë të diamantit. Rezultatet tregojnë se hapësira fiskale

ndryshon ndjeshëm midis vendeve arabe, në varësi të nivelit të tyre të të ardhurave dhe nëse janë eksportues apo importues të naftës. Është e qartë se eksportuesit e naftës nuk kanë problem me hapësirën fiskale. E meta kryesore e këtij punimi është se nuk bazohet në analiza empirike dhe është larg analizës së thelluar analitike.

Aizenman dhe Jinjark (2012) hulumtuan ndërlidhjen ndërmjet pabarazisë më të madhe të të ardhurave, hapësirës fiskale de-facto dhe diferencave sovrane. Duke përdorur qasjen e tyre De facto (2010), ata llogaritën hapësirën fiskale të 50 vendeve në 2007, 2009 dhe 2011 me të dhëna panel duke përdorur vlerësuesin OLS ndërmjet vendeve dhe vlerësuesin e katrorëve më të vegjël me dy faza (2sls). Ata identifikuan se pabarazia më e lartë e të ardhurave shoqërohet me një bazë më të ulët tatimore, hapësirë fiskale de facto më të ulët dhe diferencë më të lartë sovrane.

Botev et al. (2016) rivlerësuan hapësirën fiskale në 31 vendet e OECD-së duke përdorur tre përqasje të ndryshme: hapësirën fiskale si matës të distancës deri në humbjen e qasjes në treg; boshllëqet tatimore dhe normat e qëndrueshme të taksave; dhe përdorimi i kurbës Laffer dhe përcaktimi i kufijve të borxhit të largët. Ata vlerësuan funksionet e reagimit fiskal duke përdorur të dhënat vjetore të panelit bazuar në qasjen e Ghosh et al. (2013). Rezultatet tregojnë se ka hapësirë fiskale në shumicën e vendeve kryesore të zhvilluara. Ekzistojnë gjithashtu dëshmi se hapësira fiskale mund të jetë rritur në shumicën e vendeve të OECD që nga viti 2014, e nxitur kryesisht nga ulja e normave të interesit. Ortiz et al. (2011) ofruan një pamje të çastit të treguesve të hapësirës fiskale për 182 vende, duke përfshirë gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor. Rezultatet tregojnë se hapësira fiskale ekziston edhe në vendet më të varfra. Në këtë punim kemi një listë të treguesve përkatës, por mungojnë analizat e thelluara dhe vlerësimet e rezultateve për të gjithë skenarët e mundshëm.

Për ta përmbledhur, janë shqyrtuar shumë punime dhe raporte të publikuara në lidhje me hapësirën fiskale, por vetëm një numër shumë i kufizuar prej tyre kanë përdorur modele empirike për të analizuar hapësirën fiskale dhe asnjë prej tyre nuk ka të bëjë me vendet e Ballkanit Perëndimor. Prandaj, ky punim tenton të jetë ndër të parat e këtij lloji në këtë fushë, duke krijuar një model empirik për të matur hapësirën fiskale të vendeve të Ballkanit

Perëndimor dhe për të analizuar marrëdhënien ndërmjet treguesve të funksioneve të reagimit fiskal dhe bilancit primar, në periudhën 2000-2020.

## IV. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Në këtë kapitull do të paraqitet metodologjia e përdorur në këtë studim. Ky kapitull do të nxjerr në pah metodat e përdorura të kërkimit, variablat e përdorura në studim, burimin e të dhënave, modelet dhe teknikat e përdorura për të testuar hipotezat e studimit.

### 4.1 Metodat e kërkimit

Për studimin e problemeve do të shfrytëzohen ose do të përdoren metodat e njohura të tilla si:

- i. Metoda e analizës dhe sintezës – në bazë të këtyre metodave është bërë analiza të hollësishme për të arritur në përfundime të përgjithshme duke bërë sinteza në funksion të arritjes së qëllimit përmes dhënies së përgjigjeve të pyetjeve të kërkimit shkencor dhe vërtetimit të hipotezave.
- ii. Metoda e induksionit dhe deduksionit - nëpërmjet metodës së induksionit prej rasteve të veçanta janë arritur përfundime të përgjithshme dhe nëpërmjet metodës së deduksionit nga e përgjithshmja është kaluar tek e veçanta.
- iii. Metoda krahasuese – në bazë të kësaj metode është bërë krahasimi në mes të vendeve të Ballkanit Perëndimor për sa i përket hapësirës fiskale. Përveç metodave studimore cilësore janë përdorur edhe metodat e kërkimit sasior. Për këtë qëllim do ndërtojmë dhe paraqesim disa modele ekonometrike nëpërmjet të të cilave do të studiohet lidhja dhe ndërvlerësia midis variablave të ndryshëm ekonomikë dhe do të bëhet interpretimi ekonomik i të dhënave që do të rezultojnë nga modeli
- iv. Metoda historike – përmes të dhënave sekondare të siguruara nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK), Bankat Qendrore të vendeve tjera të Ballkanit Perëndimor, Banka Botërore (WB), Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Organizata ndërkombëtare e punës (ILO), Agjencitë Statistikore të vendeve kemi arritur deri tek përgjigjet e pyetjeve kërkimore.
- v. Analiza empirike - përmes analizës empirike është ndërtuar dhe paraqitur modeli ekonometrik, përmes së cilës synohet që të bëhet matja e hapësirës fiskale e Kosovës

dhe të shteteve tjera të Ballkanit Perëndimor – Maqedonisë së Veriut, Shqipërisë, Serbisë, Malit të Zi dhe Bosnja dhe Hercegovinës, për periudhën 2000-2020, duke përdorur panel data me modelet siç janë: Regresioni OLS, efektet fikse, efektet e rastit dhe Hausman Taylor me variabla instrumental.

#### 4.2 Variablat e përdorura në studim

Në tabelën e më poshtme janë paraqitur variablat të cilat do të përdoren në këtë studim, shkurtesat e përdorura për emërtimin e tyre gjatë analizës në STATA, përshkrimi i këtyre variablave dhe burimi i të dhënave.

Tabela 3. Variablat e përdorura në studim

| Shkurtesa   | Variabla               | Përshkrimi                                           | Burimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
|-------------|------------------------|------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>pb</b>   | Bilanci primar         | Bilanci primar (% të PBB-së)                         | Databaza e World Economic Outlook (WEO)                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| <b>dlag</b> | Borxhi publik i vonuar | Gjithsej borxhi i përgjithshëm i vonuar (% e PBB-së) | Ministria e Ekonomisë, Punës dhe Transfereve e Kosovës;<br>Ministria e Financave e Maqedonisë së Veriut;<br>Ministria e Financave dhe Ekonomisë e Shqipërisë;<br>Banka Qendrore e Bosnjës dhe Hercegovinës; Ministria e Financave dhe Mirëqenies Sociale e Malit të Zi; Banka Popullore e Serbisë; OECD |

|                         |                                                               |                                                                                              |                                                                                                                                   |
|-------------------------|---------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>d<sup>2</sup>lag</b> | Borxhi publik i vonuar në katror                              | Gjithsej borxhi i përgjithshëm i vonuar në katror (% e PBB-së)                               | Llogaritjet vetanake duke u bazuar në Ministrinë e Financave dhe Bankat Qendrore të vendeve përkatëse                             |
| <b>govrev</b>           | Të ardhurat publike                                           | Të ardhurat publike (% të PBB-së)                                                            | Databaza e World Economic Outlook (WEO); Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë të vendeve përkatëse; Fondi Monetar Ndërkombëtar |
| <b>govexpend</b>        | Shpenzimet publike                                            | Shpenzimet publike (% të PBB-së)                                                             | Databaza e World Economic Outlook (WEO); Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë të vendeve përkatëse; Fondi Monetar Ndërkombëtar |
| <b>ogap</b>             | Hendeku i prodhimit (Output gap)                              | Diferenca ndërmjet PBB real dhe PBB potencial të llogaritur përmes Hodrick-Prescott filterit | Llogaritjet vetanake duke përdorur Hodrick-Prescott filterin me parametrin $\lambda=100$                                          |
| <b>govexgap</b>         | Hendeku i shpenzimeve qeveritare (Government expenditure gap) | Diferenca ndërmjet konsumit qeveritar aktual dhe potencial të llogaritur përmes              | Llogaritjet vetanake duke përdorur Hodrick-Prescott filterin me parametrin $\lambda=100$                                          |

|                           |                                                                                    |                                                                                                    |                                                                                                                         |
|---------------------------|------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                           |                                                                                    | Hodrick-Prescott<br>filterit dhe<br>parametrit $\lambda=100$                                       |                                                                                                                         |
| <b>infl</b>               | Iflacioni                                                                          | Iflacioni (%<br>ndryshimi)                                                                         | Databaza e World Economic<br>Outlook (WEO) dhe Fondi<br>Monetar Ndërkombëtar                                            |
| <b>pstab</b>              | Treguesi i<br>stabilitetit politik<br>dhe mungesës së<br>dhunës ose<br>terrorizmit | Vlerat më të vogla<br>(më të mëdha)<br>tregojnë një rrezik<br>politik më të lartë<br>(më të ulët). | Worldwide Governance<br>Indicators - World Bank                                                                         |
| <b>shadow_ec</b>          | Ekonomia<br>informale                                                              | Vlerësimi i<br>ekonomisë<br>informale                                                              | Llogaritjet e stafit të Fondit<br>Monetar Ndërkombëtar                                                                  |
| <b>corruption_control</b> | Kontrolli i<br>korrupsionit                                                        | Kontrolli i<br>korrupsionit                                                                        | Worldwide Governance<br>Indicators - World Bank                                                                         |
| <b>gdp_growth</b>         | Rritja reale e<br>PBB-së                                                           | Norma reale e<br>rritjes ekonomike                                                                 | Fondi Monetar Ndërkombëtar,<br>Banka Botërore, Bankat<br>Qendrore dhe Agjencitë<br>statistikore të vendeve<br>përkatese |

Për të vërtetuar hipotezën e parë të ngritur *Hapësira fiskale ka ndikim në stabilitetin makroekonomik të vendeve*, do të analizohet funksioni i reaksionit fiskal për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe si variabël e varur do të përdoret bilanci primar (buxheti në % të PBB-së). Ndërsa si variabla të pavarura do të përdoren:

- Borxhi publik (% të PBB-së)
- Borxhi publik në katror (% të PBB-së)
- Të ardhurat publike (% të PBB-së)
- Shpenzimet publike (% të PBB-së)
- Hendeku i shpenzimeve qeveritare
- Hendeku i prodhimit
- Inflacioni (% ndryshimi)
- Stabiliteti politik
- Ekonomia informale

Për të analizuar hipotezën e dytë *“Korpusi i faktorëve politik sfidon krijimin e hapësirës fiskale”* si variabël e varur do të përdoret hapësira fiskale e vendeve të Ballanit Perëndimor për periudhën 2000-2020. Ndërkaq si variabla të pavarura do të përdoren faktorët politik siç janë kontrolli i korrupsionit dhe indeksi i stabilitetit politik dhe mungesës së dhunës ose terrorizmit.

Ndërkaq , për të vërtetuar hipotezën e tretë *“Hapësira fiskale në ciklet rënëse ekonomike krijojnë hapësirë ndikuese për politika fiskale ekspansive”* si variabël e varur do të përdoret rritja reale e ekonomisë, kurse si variabla të pavarura do të përdoret hapësira fiskale dhe dummy variabla për identifikimin e cikleve rënëse.

#### 4.3 Burimi i të dhënave

Për nevoja të këtij hulumtimi që të arrihet tek përgjigjet e pyetjeve kërkimore dhe hipotezave janë përdorur të dhëna sekondare, të cilat janë siguruar nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK), Banka Botërore (WB), Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), Organizata ndërkombëtare e punës (ILO), Agjencitë Statistikore, Ministritë e financave dhe Bankat Qendrore të vendeve përkatëse. Të gjitha analizat dhe testimet janë bërë përmes programit STATA 16.

#### 4.4 Metodatat e analizës së të dhënave

Pas analizimit të metodave dhe modeleve të ndryshme që janë përdorur nga autorët për vendet e ndryshme, është tentuar që të adaptohet metodologjia që i përshtatet më së shumti karakteristikave specifike të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Ostry et al. (2010) bënë definimin e hapësirës fiskale si diferencën ndërmjet nivelit aktual të borxhit dhe kufirit të borxhit. Për të përcaktuar nivelin e kufirit të borxhit përdorin funksionin e reaksionit fiskal. Duke u bazuar në qasjen e Ostry et al. (2010) kemi zhvilluar një model empirik për të vlerësuar marrëdhënien ndërmjet funksionit të reagimit fiskal dhe bilancit primar (%PBB-së) në shtetet e Ballkanit Perëndimor për periudhën kohore 2000-2020. Për këtë qëllim, kemi përdorur regresionin OLS, regresionin me efekte fikse dhe efekte të rastit, si dhe Hausman – Taylor me variabla instrumentale. Po ashtu është përdorur Hausman testi, për të bërë përzgjedhjen ndërmjet modelit me efekte fikse, të rastit dhe Hausman - Taylor. Rezultati i testit të Hausman tregon që modeli Hausman - Taylor është më konsistent dhe eficient se sa efektet fikse dhe të rastit (Tabela 5).

Në vijim mund të gjeni përmbledhjen e modeleve ekonometrike të përdorura në këtë punim.

##### 4.4.1 Modeli i regresionit të katrorëve të vegjël (OLS)

Regresioni i katrorëve të vegjël (OLS) është metoda që zakonisht përdoret më së shumti për vlerësimin e modeleve lineare, pra të shkallës së parë. Regresioni OLS është një metodë e analizës ekonometrike, e cila vlerëson marrëdhëniet lineare në mes të një variabli të varur dhe të një ose më shumë variablave të pavarura. Kjo metodë bën vlerësimin e marrëdhënies së variablës së varur me atë/ato të pavarur/a, duke minimizuar shumën e katrorëve në diferencën në mes të vlerave të vëzhguara dhe atyre të parashikuara të variablës së varur, të paraqitur si një vijë e drejtë.

Regresioni është një metodë e fuqishme që mund të analizojë shumë variabla në të njëjtën kohë për t'iu përgjigjur pyetjeve komplekse kërkimore. Megjithatë, nëse nuk përmbushen

supozimet e OLS-së, atëherë rezultatet mund të mos jeni të besueshme. Në mënyrë që të mund të përdoret ky lloj i regresionit, duhet të plotësohen disa supozime, si: 1) koeficientët dhe termi i gabimit janë linear; 2) termi i gabimit ka një mesatare të dukurisë prej zero; 3) nuk ka ndërlidhje në mes të variablave të pavarura dhe termit të gabimit; 4) vëzhgimet e termit të gabimit nuk janë të ndërlidhura me njëri-tjetrin; 5) termi i gabimit ka një variancë konstante (pa heteroskedasticitet); 6) asnjë variabël e pavarur nuk ka korrelacion linear perfekt me variablat e tjera shpjeguese dhe 7) termi i gabimit ka një shpërndarje normale.

Nëse supozimet e regresionit OLS janë të vërteta, atëherë katrorët më të vegjël japin vlerësimet më të mira. Por, nëse disa nga këto supozime nuk janë të vërteta, atëherë duhet të përdoren masa korrigjuese ose të përdoren metoda të tjera vlerësimi në mënyrë që fitohen rezultate më të mira dhe më të besueshme.

#### 4.4.2 Modeli i regresioni me efekte fikse (Fixed-effects)

Efektet fikse (FE) përdoren për të analizuar ndikimin e variablave që ndryshojnë me kalimin e kohës. Efektet fikse eksplorojnë marrëdhënien ndërmjet variablave parashikues dhe rezultateve brenda një njësie ekonomike. Çdo njësi ekonomike ka karakteristikat e veta individuale që mund ose nuk mund të ndikojnë në variablat parashikues. Kur përdoren efektet fikse supozohet se diçka brenda individit mund të ndikojë ose të paragjykojë variablat parashikues ose të rezultatit dhe ne duhet ta kontrollojmë këtë. Ky është arsyetimi pas supozimit të korrelacionit në mes të termit të gabimit të njësisë ekonomike dhe variablave parashikuese. Efektet fikse largojnë efektin e atyre karakteristikave që janë të pandryshueshme në kohë, kështu që ne mund të vlerësojmë efektin neto të parashikuesve në variablën e rezultatit.

Një supozim tjetër i rëndësishëm i modelit FE është se ato karakteristika të pandryshueshme në kohë janë unike për individin dhe nuk duhet të lidhen me karakteristika të tjera individuale. Çdo njësi ekonomike është e ndryshme, prandaj termi i gabimit të njësisë ekonomike dhe konstantja (e cila kap karakteristikat individuale) nuk duhet të jenë në korrelacion me të tjerët. Nëse termat e gabimit janë të ndërlidhura, atëherë aplikimi i efektit fiks nuk është i përshtatshëm

(Nwakuya and Ijomah, 2017), prandaj duhet të përdoren metoda të tjera, si ato me efekte të rastit.

#### 4.4.3 Modeli i regresionit me efekte të rastit (Random-effects)

Arsyeja kryesor pas modelit të efekteve të rastit është se, ndryshe nga modeli i efekteve fikse, variacioni ndërmjet entiteteve supozohet të jetë i rastësishëm dhe i pakorreluar me parashikuesin ose variablat e pavarur të përfshirë në model. Nëse ndryshimet në mes të njësive kanë ndonjë ndikim në variablën e varur, atëherë duhet të përdoren efektet e rastësishme (RE).

Një avantazh i efekteve të rastësishme është se mund të përfshihen variabla të pandryshueshme në kohë si gjinia, ndryshe nga efektet fikse. Termi i gabimit të individit nuk është në korrelacion me parashikuesit, gjë që lejon që variablat e pandryshueshme në kohë të luajnë një rol si variabla shpjeguese (Nwakuya and Ijomah, 2017).

#### 4.4.4 Hausman testi

Hausman testi zakonisht përdoret për të bërë përzgjedhjen metodës së duhur në mes të efekteve fikse dhe efekteve të rastit. Hipoteza zero është se modeli i preferuar është efektet e rastit përkundër efekteve fikse si hipotezë alternative. Në thelb teston nëse gabimet unike janë të ndërlidhura me regresorët, hipoteza zero është se ato nuk janë.

#### 4.4.5 Modeli Hausman-Taylor me variabla instrumental (IV)

Modelet e efekteve të rastit dhe modelet e efekteve fikse përdoren gjerësisht në ekonometri për të dhënat panel. Shumë ekonomistë priren ta pëlqejnë më shumë modelin me efekte fikse, pasi ai eliminon të gjitha të përbashkëtat brenda një individi, prandaj në këtë mënyrë kontrollohet heterogjeniteti individual i pavëzhguar. Megjithatë, në një model me efekte fikse, çdo variant që është konstant brenda individit nuk mund të përfshihet në vlerësim. Një model me efekte të rastit mund të ketë një ndryshore të pandryshueshme në kohë në regresion;

megjithatë, ai supozon ndërlidhje ndërmjet termit të gabimit dhe efekteve individuale, gjë që shpesh nuk është e vërtetë.

Vlerësuesi Hausman-Taylor është një vlerësues instrumental i variablave i aplikuar në modelin e efekteve të rastësishme për të kapërcyer problemin e mospërputhjes së shkaktuar nga korrelacioni midis efekteve të rastit dhe disa prej variablave shpjegues. Hausman dhe Taylor (1981) zhvilluan një model të ri, i cili kombinon modelin e efekteve fikse dhe modelin e efekteve të rastësishme. Modeli Hausman-Taylor (1981) përdor një strukturë "të përzier" për të trajtuar këtë situatë dhe duhet të përfshihet një ndryshore e pandryshueshme në kohë dhe të modelohet heterogjeniteti individual i pavëzhguar. Pra, modeli Hausman-Taylor është një model ndërmjet efektit fiks dhe efektit të rastit, ose një përzierje e të dyjave.

Ky model përfshin dy kufizime kryesore: nëse ka korrelacion apo jo; dhe nëse supozohet se efektet specifike individuale janë të ndërlidhura me variablat shpjeguese, atëherë nuk mund të vlerësojmë variablat shpjeguese të pandryshueshme në kohë. Ky model quhet edhe teknika Hausman Taylor me variabla instrumental dhe eliminon korrelacionin në mes të efekteve specifike të vendit dhe termit të gabimit përmes informacionit që përfshihet në model.

#### 4.5 Modeli empirik

Rezultati i testit të Hausman tregon që modeli Hausman - Taylor është më konsistent dhe eficient se sa efektet fiske dhe të rastit (Tabela 5). Prandaj, ne do të përdorim modelin Hausman – Taylor IV si model empirik për të matur dhe vlerësuar ndërlidhjen në mes të funksionit të reagimit fiskal dhe bilancit primar (%PBB-së) në shtetet e Ballkanit Perëndimor ndërmjet viteve 2000-2020. Po ashtu do të paraqiten rezultatet nga regresioni OLS, me efekte fiske dhe të rastit për qëllime krahasimore. Duke aplikuar modelin Hausman – Taylor IV bëhet zgjidhja e problemit të endogjenitetit.

Për përlllogaritjen e funksionit të reaksionit fiskale, si variabël e varur përdoret bilanci primar (në % të PBB-së). Ndërsa dy variablat kryesore të pavarura janë *hendeku i prodhimit* (output

gap), të përlogaritur si diferenca ndërmjet PBB real dhe PBB potencial përmes Hodrick-Prescott filterit, duke përdorur parametrin  $\lambda=100$ , si dhe *hendeku i shpenzimeve qeveritare* (government expenditure gap), të përlogaritur si diferenca ndërmjet konsumit qeveritar aktual dhe potencial, po ashtu të përlogaritur përmes Hodrick-Prescott filterit dhe parametrin  $\lambda=100$ . Ndërsa variablat të tjera të pavarura duhet të përshtaten me karakteristikat specifike të vendeve për të cilat llogaritet hapësira fiskale.

Ekuacioni i modelit empirik të Hausman - Taylor IV është si në vijim:

$$y_{it} = c + \beta_1(y_{it-1}) + \beta_2(d_{it-1}) + \beta_3(d^2_{it-1}) + \beta_4(govrev_{it}) + \beta_5(govexpend_{it}) + \beta_6(gegap_{it}) + \beta_7(infl_{it}) + \beta_8(pstab_{it}) + \beta_9(shadow_{ec_{it}}) + \beta_{10}(ogap_{it}) + u_{it} \quad (3)$$

Ku,  $y_{it}$  është variabla e varur, pra bilanci primar (në % të PBB-së) për secilin shtet  $i$  dhe vitet  $t$ ;  $c$  është konstantja; variablat e pavarura përfshijnë  $y_{it-1}$  që është variabla e varur për një periudhë të vonuar;  $d_{it-1}$  paraqet borxhin publik të vonuar (në % të PBB-së);  $d^2_{it-1}$  paraqet borxhin publik në katror të vonuar (në % të PBB-së);  $govrev_{it}$  paraqet të ardhurat publike (në %PBB-së);  $govexpend_{it}$  paraqet shpenzimet publike (në % të PBB-së);  $gegap$  paraqet hendekun e shpenzimeve qeveritare (diferenca ndërmjet konsumit qeveritar aktual dhe potencial duke përdorur Hodrick-Prescott filterin);  $infl_{it}$  paraqet inflacionin (% e ndryshimit);  $pstab_{it}$  paraqet indeksin e stabilitetit politik dhe mungesën e dhunës ose terrorizmit që mat perceptimet për mundësinë e paqëndrueshmërisë politike dhe/ose dhunës së motivuar politikisht, duke përfshirë terrorizmin. Vlerat më të vogla (më të mëdha) tregojnë një rrezik politik më të lartë (më të ulët);  $shadow_{ec_{it}}$  paraqet shkallën e informalitetit (në % të PBB-së);  $ogap_{it}$  paraqet hendekun e prodhimit (diferenca ndërmjet PBB real dhe PBB potencial duke përdorur Hodrick-Prescott filterin) dhe  $u_{it}$  paraqet gabimin stohastik.

#### 4.6 Statistikat deskriptive

Ky studim përdor të dhëna panel për gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, për periudhën kohore 2000-2020. Baza e të dhënave përbëhet nga të dhëna të balancuara. Të dhënat janë

grumbulluar nga Banka Botërore (WB), Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), Organizata ndërkombëtare e punës (ILO), Bankat Qendrore të vendeve, Agjencitë Statistike dhe Ministrinë e financave të vendeve përkatëse.

Duke u bazuar në shqyrtimin e gjerë të literaturës dhe duke aplikuar qasjen e Ostry et al. (2010), bilanci primar (në % të PBB-së) është përdorur si variabël e varur, kurse borxhi publik i vonuar (në % të PBB-së) është variabla kryesore e pavarur. Determinantët tjerë të bilancit primar, përveç borxhit publik të vonuar, përfshin borxhin publik në katror të vonuar, të ardhurat publike (në %PBB-së), shpenzimet publike (në % të PBB-së), hendekun e shpenzimeve qeveritare, inflacionin (% e ndryshimit), indeksin e stabilitetit politik, shkallën e informalitetit dhe hendekun e prodhimit.

Përmbledhja e statistikave të studimit është paraqitur në tabelën 4.

Tabela 4. Statistikat deskriptive

| Variablat | Observimet <sup>1</sup> | Mesatarja | Dev. Std | Minimumi  | Maksimumi |
|-----------|-------------------------|-----------|----------|-----------|-----------|
| Pb        | 122                     | -1.074361 | 2.725334 | -8.207    | 9.47      |
| pblag1    | 119                     | -.8120756 | 2.495748 | - 5.86    | 9.47      |
| Dlag      | 115                     | 45.61922  | 25.82033 | 5.27      | 224.75    |
| d2lag     | 115                     | 2742.005  | 4846.929 | 27.7729   | 50512.56  |
| Govrev    | 124                     | 34.1579   | 8.868893 | 5.353     | 52.289    |
| Govexpend | 124                     | 36.58743  | 9.16136  | 8.506     | 56.306    |
| Govexgap  | 118                     | .0253268  | 2.287029 | -6.049661 | 8.06853   |
| Infl      | 126                     | 4.574357  | 10.19698 | -2.419    | 80.744    |

<sup>1</sup> Studimi përdor të dhëna panel të pabalancuara për 6 vendet e Ballkanit Perëndimor për periudhën 2000-2020, prandaj numri i observimeve është i ndryshueshëm ndërmjet variablave.

|           |     |           |          |           |          |
|-----------|-----|-----------|----------|-----------|----------|
| Pstab     | 108 | -.2436303 | .454084  | -1.642953 | 1.00747  |
| shadow_ec | 102 | 35.34902  | 3.666432 | 27.1      | 41       |
| Ogap      | 126 | .0623845  | 2.053516 | -9.582899 | 10.93986 |

*Burimi:* Kalkulimet vetanake të autores bazuar në të dhënat nga Ministrinë e Financave dhe Agjencinë Statistikore të vendeve përkatëse.

## V. REZULTATET EMPIRIKE

Në këtë pjesë paraqiten rezultatet nga regresioni OLS, efektet fiske, efektet e rastit dhe Hausman-Taylor me variabla instrumental. Koeficienti nga vlerësuesi i regresionit OLS është i paragjykuar për shkak të heterogjenitetit të efektit të pavrojtuar individual-spezifik. Prandaj, kalkulohen modelet me efekte fikse dhe efekte të rastit, të cilat janë të paraqitura në tabelën 6. Hausman testi është aplikuar për të mundësuar krahasimin e vlerësuesve nga efektet fikse dhe efekteve të rastit (Tabela 5). Hausman testi si hipotezë zero gjithmonë preferon efektet e rastit, ndërsa si hipotezë alternative efektet fikse. Statistika e testit Hausman rezulton **49.41**, ndërsa testi chi-square **0.000**, që është më e vogël se 0.05 dhe nënkupton që **hipoteza alternative mund të pranohet**, prandaj përzgjedhja duhet të bëhet në favor të vlerësuesit të efekteve fikse. Për t'u marrë me problemin e endogjenitetit, i cili mund të çojë në koeficientë të njëanshëm (biased) të regresionit është përlogaritur vlerësuesi i Hausman-Taylor (Tabela 5). Hausman testi është kalkuluar gjithashtu për vlerësuesin e efekteve fikse dhe vlerësuesin e Hausman-Taylor, për të identifikuar nëse teknika e variablave instrumental (IV) eliminon korrelacionin ndërmjet efekteve të pavrojtura individual-specifike dhe variablave shpjeguese. Hausman testi është 1638.57 dhe testi chi-square 0.000, që nënkupton hipoteza zero refuzohet në favor të Hausman-Taylor (IV) (tabela 5). Prandaj, metoda e Hausman-Taylor (IV) me variabla instrumental eliminon korrelacionin ndërmjet variablave që janë përfshirë në model dhe komponentëve individual të termit të gabimit. Po ashtu, kjo metodë eliminon problemin e endogjenitetit. Prandaj, mund të konkludojmë që Hausman-Taylor IV është zgjidhja më e mirë ndërmjet efekteve fikse dhe të rastit. (Tabela 5).

Tabela 5. Hausman test

| Test                              | Chi <sup>2</sup> | Prob > Chi <sup>2</sup> | Rezultati                |
|-----------------------------------|------------------|-------------------------|--------------------------|
| Efektet fikse vs Efektet e rastit | 49.41            | 0.0000                  | Refuzohet H <sub>0</sub> |
| Hausman Tylor vs Efektet fikse    | 1638.57          | 0.0000                  | Refuzohet H <sub>0</sub> |

*Burimi:* Kalkulimet vetanake të autorëve

Gjatë aplikimit të vlerësuesit të Hausman-Taylor IV, variablat të cilat konsiderohen si variabla ekzogjene dhe të përdorura si instrumente të tyre janë bilanci primar i vonuar, borxhi publik i vonuar, borxhi publik në katror i vonuar, të ardhurat publike (% PBB-së), shpenzimet publike (% PBB-së), hendeku i shpenzimeve qeveritare, inflacioni, stabiliteti politik dhe ekonomia informale. Variabla që konsiderohet të jetë endogjene dhe instrument nga devijimi i mesatares së individëve është hendeku i prodhimit.

Tabela 6. Rezultatet e regresionit të funksionit të reaksionit fiskal

|           | (Model 1)<br>OLS | (Model 2)<br>Fixed-effects | (Model 3)<br>Random-effects | (Model 4)<br>Hausman Taylor-IV) |
|-----------|------------------|----------------------------|-----------------------------|---------------------------------|
| VARIABLAT | pb               | pb                         | pb                          | Pb                              |
| pblag1    |                  |                            |                             | -0.00901                        |
| d.s.      |                  |                            |                             | (0.0357)                        |
| Dlag      | 0.0557***        | 0.0496***                  | 0.0557***                   | 0.0510***                       |
| d.s.      | (0.0123)         | (0.0169)                   | (0.0123)                    | (0.0158)                        |
| d2lag     | -0.000336***     | -0.000364**                | -0.000336***                | -0.000363**                     |
| d.s.      | (0.000123)       | (0.000148)                 | (0.000123)                  | (0.000142)                      |

|                 |           |           |           |           |
|-----------------|-----------|-----------|-----------|-----------|
| Govrev          | 0.832***  | 0.885***  | 0.832***  | 0.871***  |
| d.s.            | (0.0281)  | (0.0339)  | (0.0281)  | (0.0297)  |
| Govexpend       | -0.866*** | -0.878*** | -0.866*** | -0.882*** |
| d.s.            | (0.0295)  | (0.0288)  | (0.0295)  | (0.0287)  |
| Govexgap        | -0.167*** | -0.141*** | -0.167*** | -0.147*** |
| d.s.            | (0.0370)  | (0.0327)  | (0.0370)  | (0.0345)  |
| Infl            | -0.0296*  | -0.0459** | -0.0296*  | -0.0427** |
| d.s.            | (0.0178)  | (0.0202)  | (0.0178)  | (0.0208)  |
| Pstab           | 0.00171   | -0.342**  | 0.00171   | -0.329**  |
| d.s.            | (0.139)   | (0.158)   | (0.139)   | (0.149)   |
| shadow_ec       | -0.101*** | -0.101*   | -0.101*** | -0.116**  |
| d.s.            | (0.0222)  | (0.0598)  | (0.0222)  | (0.0489)  |
| Ogap            | 0.0514    | -0.0130   | 0.0514    | 0.00805   |
| d.s.            | (0.0415)  | (0.0423)  | (0.0415)  | (0.0462)  |
| Code            |           |           |           | -0.0185   |
| d.s.            |           |           |           | (0.142)   |
| Constant        | 4.307***  | 3.185     | 4.307***  | 4.393**   |
| d.s.            | (0.852)   | (2.649)   | (0.852)   | (1.819)   |
| Observimet      | 83        | 83        | 83        | 83        |
| R-squared       | 0.957     | 0.970     |           |           |
| Numri i vendeve |           | 6         | 6         | 6         |

**Sqarim:** \* Statistikisht signifkant në nivelin 10%, \*\* statistikisht signifkant në nivelin 5%; \*\*\* statistikisht signifkant në nivelin 1%.

**Burimi:** Kalkulimet vetanake të autorëve

Bilanci primar i vonuar është niveli fillestar i rritjes së borxhit publik, i cili instrumentohet nga devijimet mesatare të individëve. Me këtë variabël kontrollohet konvergjenca e kushtëzuar e 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor. Pasi që koeficienti është negativ ( $y_{it-1}$ ) -0.00901 (dev.st.

0.0357) dhe josignifikant, rezultat i cili është i ndryshëm nga rezultatet e (Ostry et al, 2010 dhe Baum et al, 2017), mund të themi që nuk ka pasur ndikim në funksionin e reaksionit fiskal për vendet e Ballkanit Perëndimor.

Në tabelën 6 mund të shihet që borxhi publik ka një koeficient pozitiv 0.0510 (dev.st. 0.0158) dhe është statistikisht signifikant, në nivelin 99% saktësi që do të thotë se borxhi publik ka një lidhje pozitive me bilancin primar. Rezultatet e këtij studimi janë në përputhje me (Baum et al 2017, Mendoza&Ostry, 2008). Vendet me nivel të ulët të borxhit kanë ndërlidhje pozitive, ndërsa vendet me borxh të lartë kanë ndërlidhje negative me bilancin primar (Mendoza&Ostry, 2008).

Rezultatet tregojnë që katrori i borxhit publik ndikon negativisht në bilancin primar në vendet e Ballkanit Perëndimor -0.000363 (dev.st. 0.000142), që do të thotë se marrëdhënia e tyre është jolineare dhe në formë të U-së. Rezultati është signifikant me 95% nivel saktësie. Rezultati është në përputhje me rezultatet e (Ostry et al, 2010; Zandi et al, 2011; Bastos dhe Pineda, 2013; Ghosh et al, 2013), të cilat gjetën një lidhje jolineare në mes të borxhit publik dhe bilancit primar. Në hulumtimin e tyre, borxhi kur arrin nivelin në shkallën e tretë (kub) atëherë bëhet negative. Por për vendet e Ballkanit Perëndimor, borxhi në katror është i mjaftueshëm që bilanci primar të jetë negativ.

Nga tabela 6 shohim që të ardhurat publike kanë ndërlidhje pozitive, me një koeficient prej 0.871 (dev.st. 0.0297), statistikisht signifikant me 99% nivel saktësie. Koeficienti 0.871 paraqet elasticitetin e të ardhurave, ku me një rritje prej 1% të të ardhurave, atëherë reaksioni fiskal do të rritej për 0.871%, në rast kur të gjithë faktorët të tjerë mbesin të pandryshuar. Prandaj, nga ky rezultat kuptojmë që vendet që kanë elasticitet më të lartë të të ardhurave, përmes politikave qeveritare mund të rrisin nivelin e të ardhurave (siç mund të jetë rritja e grumbullimit të taksave), gjë që do të ndikonte në mënyrë direkte në rritjen e hapësirës fiskale të vendeve. Rezultatet janë në përputhje me (Heller, 2005; Schick, 2009 e të tjerë).

Rezultatet e regresionit tregojnë që shpenzimet publike kanë ndërlidhje të zhdrejtë, me një koeficient prej -0.882 (dev.st. 0.0287), statistikisht signifikant me 99% nivel saktësie. Koeficienti -0.882 paraqet elasticitetin e shpenzimeve publike, ku një ulje prej 1% të shpenzimeve publike

do të ndikonte në rritjen e reaksionit fiskal për 0.882%, në qoftë se të gjithë faktorët të tjerë mbesin të pandryshuar. Vendet që kanë elasticitet më të lartë të shpenzimeve, përmes rialokimit të shpenzimeve joefikase, apo uljes së shpenzimeve do të mund të krijojnë hapësirë fiskale. Rezultatet janë në përputhje me gjetjet e (Herrera, 2007; Ortiz et al, 2011 e të tjerë).

Rezultatet në tabelën 6 tregojnë se koeficienti i hendekut të shpenzimeve të qeverisë, i llogaritur si diferenca në mes të konsumit aktual dhe atij potencial të qeverisë duke përdorur Hodrick-Prescott filterin është negativ -0.147 (dev.st 0.0345) dhe statistikisht signifikant në 99% nivel saktësie, pra, rritja e përkohshme në shpenzimet qeveritare rezulton në një përkeqësim në bilancin primar. Rezultati është në përputhje me gjetjet e shumë studimeve të mëparshme si (Ostry et al, 2010; Zandi et al, 2011; Bastos&Pineda, 2013; Ghosh et al, 2013; Nerlich&Heinrich Reuter 2015; Baum et al. 2017) dhe të tjerë.

Rezultatet e regresionin tregojnë që koeficienti i inflacionit është negativ -0.0427 (dev.st 0.0208) dhe statistikisht signifikant në 95% nivel saktësie, që do të thotë ekziston një ndërlidhje negative, pra me uljen e inflacionit rritet bilanci primar. Zakonisht në vendet në zhvillim, ekziston një ndërlidhje e kundërt, pra rritja e inflacionit ka ndikim pozitiv në bilancin primar, kryesisht për shkak të printimit të parave. Por, edhe pse në parim inflacioni është fenomen monetar, jodomosdoshmërisht inflacioni është monetar, pra që shkaktohet nga printimi i parave apo rritjes së masës monetare. Inflacioni aktual dëshmon këtë, ku mbi 2/3 e tij shkaktohet nga importi, pra është inflacion i importuar. Ndërsa në vendet e zhvilluara ndërlidhja është negative, pra inflacioni në vendet e zhvilluara ndikon në mënyrë negative në bilancin primar (IMF, 2003).

Rezultatet në tabelën 6 tregojnë se koeficienti i indeksit të stabilitetit politik dhe mungesës së dhunës ose terrorizmit është negativ -0.329 (dev.st 0.149) dhe statistikisht signifikant në 95% nivel saktësie. Rezultatet janë të ndryshme nga ato të studimeve të mëparshme (Ostry et al., 2010; Ghosh et al., 2013; Nerlich&Heinrich Reuter 2015), ku për vendet e Ballkanit Perëndimor rezulton që bilanci primar ndikohet negativisht nga stabiliteti politik. Mund të thuhet që një gjetje e tillë është e çuditshme, pasi që pritshmëria e ndikimit pozitiv në bilancin primar është mjaft e arsyeshme.

Rezultatet e regresionin tregojnë që koeficienti i shkallës së informalitetit është negativ -0.116 (dev.st 0.0489) dhe statistikisht signifikant në 95% nivel saktësie. Pra, çdo ulje e shkallës së informalitetit do të ketë ndikim pozitiv në rritjen e bilancit primar, nëse faktorët e tjerë mbesin të pandryshueshëm (Kose et al, 2018; Barroy et al, 2016).

Rezultatet në tabelën 6 tregojnë se hendeku i prodhimit, i llogaritur si diferenca në mes të PBB-së real aktual dhe potencial duke përdorur Hodrick-Prescott filterin është pozitiv 0.00805 (dev.st. 0.0462), që do të thotë se bilanci primar i përgjigjet pozitivisht hendekut të prodhimit. Në kohë prosperiteti ekonomik, kur hendeku i prodhimit është pozitiv dhe ekonomia funksionon në ose mbi potencialin e saj, qeveria do të mbledhë më shumë të ardhura nga taksat dhe shpenzimet qeveritare do të bien. Bilanci primar përmirësohet. Në recesione, kur hendeku i prodhimit është negativ, bilanci primar përkeqësohet. Por, koeficienti i hendekut të prodhimit është statistikisht josignifikant për vendet e Ballkanit Perëndimor. Rezulte të ngjashme, por signifikante hasim tek studimet e (Ostry et al, 2010; Zandi et al, 2011; Bastos&Pineda, 2013; Ghosh et al, 2013; Nerlich&Heinrich Reuter 2015; Baum et al 2017) dhe të tjerë.

Për të përlllogaritur hapësirën fiskale të shteteve të Ballkanit Perëndimor, nevojitet që të kalkulohet kufiri i nivelit të borxhit. Hapi i parë është përcaktimi i një kufizimi standard buxhetor të qeverisë. Sipas Ghosh et al. (2013) dhe Bastos&Pineda (2013) :

$$d_{t+1} - d_t = (r_t - g_t)d_t - pb_{t+1} \quad (4)$$

Ku,  $d$  paraqet borxhin (në % të PBB-së);  $g$  paraqet normën e rritjes reale të PBB-së;  $pb$  paraqet bilancin primar (në % të PBB-së);  $r_t$  paraqet normën reale të interesit (nga obligacionet).

Funksioni i reaksionit fiskal është si në vijim:

$$pb_{t+1} = \mu + f(d_t) + e_t \quad (5)$$

Ku,  $\mu$  përfshin të gjithë determinantët sistematik të bilancit primar, përveç borxhit të vonuar. Dy determinantët kryesor janë janë *hendeku i prodhimit* (output gap), *hendeku i shpenzimeve qeveritare* (government expenditure gap). Ndërsa determinantët të tjerë duhet të përshtaten


me karakteristikat specifike të vendeve për të cilat llogaritet hapësira fiskale;  $f(d_t)$  paraqet funksionin e borxhit të vazhdueshëm si përgjigje të bilancit primar ndaj borxhit të vonuar. Nga llogaritjet e mësipërme  $f(d_t)$  supozohet që të jetë fukcion në katror.

Kryqëzimi midis funksionit të reagimit të bilancit primar dhe kurbës së pagesës së interesit të rregulluar nga rritja përcakton kufijtë e borxhit si një kusht ekuilibri nën të cilin raportet e borxhit stabilizohen:

$$(r_t - g_t)d_t = \mu + f(d_t) + e_t \quad (6)$$

Kjo gjendje e ekuilibrit është paraqitur në figurën 25.

Figura 25. Përcaktimi i kufirit të borxhit



Burimi: Ostry et al. *Fiscal space*. (2010). Washington: International Monetary Fund, Research Department, fq. 8.

$$f(d_t) = (r_t - g_t)d_t \quad (7)$$

Nëse:

$$f(d_t) = 0 \rightarrow (r_t - g_t)d_t = \mu + 0$$

$$(r_t - g_t)d_t = \mu$$

$$\frac{(r_t - g_t)d_t}{(r_t - g_t)} = \frac{\mu}{(r_t - g_t)}$$

$$d_t = \frac{\mu}{(r_t - g_t)} \quad (8)$$

Në ekuacionin e fundit është paraqitur formula për përlllogaritjen e kufirit të borxhit. Pra, raporti ndërmjet determinantëve sistematik të bilancit primar, përveç borxhit të vonuar dhe diferencës ndërmjet normës reale të interesit dhe rritjes reale të PBB-së paraqet kufirin e borxhit.

Duke u bazuar në formulat e mësipërme dhe rezultatet e regresionit të funksionit të reaksionit fiskal janë bërë llogaritjet për të përcaktuar nivelin e kufirit të borxhit për 6 vendet e Ballkanit Perëndimor. Për të llogaritur r-g, si r është marrë norma e interesit nga obligacionet (mesatarja e 10 viteve), kurse g - rritja reale e ekonomisë. Por, vlerat që dalin nga përlllogaritjet janë jashtë realitetit!

Bastos&Pineda (2013), për të llogaritur r-g për 27 vendet e Brazilit kanë përdorur dy vlera 4.5 dhe 1. Në mënyrë analogjike janë vendosur vlera të ngjashme për shtetet e Ballkanit Perëndimor, duke u bazuar nga mesatarja e viteve të mëparshme, por përsëri vlerat rezultojnë të jenë të pasakta.


Në mënyrë që të llogaritet kufiri i borxhit për secilin vend veç e veç të vendeve të Ballkanit Perëndimor, janë bërë edhe përlllogaritje specifike në bazë të analizave të trendeve korrelative. Përmes të dhënave konsistente të periudhës 2000-2020 është analizuar korrelacioni ndërmjet normës së rritjes reale ekonomike dhe nivelit të borxhit publik për të konstatuar në cilat kufij dhe deri në cilat nivele të borxhit dinamika e rritjes ekonomike ka qenë më e lartë se sa ajo e

borxhit publik. E gjithë kjo për të konstatuar një kufi optimal të borxhit – aty ku norma e rritjes së borxhit e tejkalon normën e rritjes ekonomike do të ishte kufiri optimal i tij.

Nga përlogaritja e korrelacionit ndërmjet borxhit publik (në % të PBB-së) dhe rritjes reale ekonomike në vitet 2000-2020, rezulton që ekziston një korrelacion negativ në të gjitha vendet, me një korrelacion të fuqishëm negativ Shqipëria prej -0.706 dhe korrelacion negativ të moderuar Kosova prej -0.323. Ndërsa vetëm Serbia ka pasur një korrelacion pozitiv të moderuar prej 0.290. Trendi i rritjes së borxhit publik ka qenë më i theksuar, ndërsa rënia ekonomike ka pasur një trend më linear, përveç Kosovës dhe Bosnja dhe Hercegovinës. Kurse Serbia ka pasur trend të theksuar të uljes së borxhit publik dhe trend linear të lehtë të uljes ekonomike.


Në vijim janë paraqitur në mënyrë grafike borxhi publik, rritja ekonomike dhe trendet lineare të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Figura 26. Rritja ekonomike, borxhi publik dhe trendet lineare - Kosova




Burimi: Kalkulimet vetanake të autores

Figura 27. Rritja ekonomike, borxhi publik dhe trendet lineare – Maqedonia e Veriut




Burimi: Kalkulimet vetanake të autores

Figura 28. Rritja ekonomike, borxhi publik dhe trendet lineare – Shqipëria




Burimi: Kalkulimet vetanake të autores

Figura 29. Rritja ekonomike, borxhi publik dhe trendet lineare – Serbia




Burimi: Kalkulimet vetanake të autores

Figura 30. Rritja ekonomike, borxhi publik dhe trendet lineare – Mali i Zi



Burimi: Kalkulimet vetanake të autores

Figura 31. Rritja ekonomike, borxhi publik dhe trendet lineare – Bosnja dhe Hercegovina



Burimi: Kalkulimet vetanake të autores

Nga analiza e nivelit të borxhit publik, ku norma e rritjes reale ekonomike ka qenë më e lartë se ajo e borxhit publik, rezulton që niveli optimal i borxhit për Maqedoninë e Veriut është 49.4% (viti 2019), ku rritja reale ekonomike ka qenë 3.9% (ndërsa rritja e borxhit publik ndër vite ka qenë 1.0 pikë përqind). Për Shqipërinë është 55.14% (viti 2008), ku rritja reale ekonomike ka qenë 7.5% (ndërsa rritja e borxhit publik ndër vite ka qenë 1.59 pikë përqind). Për Serbinë është 54.35% (viti 2018), ku rritja reale ekonomike ka qenë 4.4% (ndërsa ulja e borxhit publik ndër vite ka qenë 4.26 pikë përqind). Malin e Zi është 55.18% (viti 2013), ku rritja reale ekonomike ka qenë 3.5% (ndërsa rritja e borxhit publik ndër vite ka qenë 1.76 pikë përqind). Për Bosnjën dhe Hercegovinën është 44.74% (viti 2015), ku rritja reale ekonomike ka qenë 3.1% (ndërsa rritja e borxhit publik ndër vite ka qenë 0.71 pikë përqind). Ndërsa për Kosovën është 17.51% (viti 2019), ku rritja ekonomike ka qenë 4.8% (ndërsa rritja e borxhit publik ndër vite ka qenë 0.61 pikë përqind).

Duke marrë parasysh që Kosova gjatë tërë periudhës kohore të vrojtuar ka pasur nivel të ulët të borxhit publik, së pari për shkaqe të njohura të suksesionit (ndarjes) debitor-kreditor nga Serbia. Në njërin anë ka kërkesa nga fondet pensionale për rreth 2.3 miliard euro, kurse në anën tjetër Serbia pretendon kërkesa nga “fondi i privatizimeve”. Andaj për momentin borxhi

aktual dhe statistikor nuk e përfshin borxhin e padukshëm. Si rrjedhojë, përzgjedhja e një pragu kaq të ulët për Kosovën nuk do të ishte reale.

(Bexheti & Sadiku, 2019) në mënyrë empirike kanë përlogaritur nivelin e kufirit të borxhit për Maqedoninë e Veriut duke aplikuar bootstrap metodën sipas Hansen (1999). Niveli i kufirit ka rezultuar të jetë 53.42%. Ndërsa, përpos rastit të Maqedonisë, në vendet tjera të Ballkanit Perëndimor nuk janë gjetur llogaritje specifike lidhur me përlogaritjen e kufirit të borxhit ku mund të referohemi. Prandaj përpos Maqedonisë së Veriut, kufiri i borxhit do të përcaktohet me nivelin normativ të kriterëve të Kopenhagës dhe Mastrihtit (60% të PBB-së) që vetë Bashkimi Evropian e merr si pikë referente dhe si konvergjencë fiskale për vendet që pretendojnë të anëtarësohen në BE.

### 5.1 Llogaritja e hapësirës fiskale sipas qasjes së Ostry et al. (2010)

Ostry et al. (2010) e definojnë hapësirën fiskale si diferencën në mes të nivelit aktual të borxhit të vendeve dhe kufirit të borxhit. Duke u bazuar në këtë qasje do të përlogaritet hapësira fiskale për vendet e Ballkanit Perëndimor.

Në tabelën 7 është paraqitur piku i borxhit publik (në % të PBB-së), borxhi publik (në % të PBB-së) më i fundit (viti 2020) dhe limiti i borxhit për vendet e Ballkanit Perëndimor.

Tabela 7. Borxhi publik dhe kufiri i borxhit

| Shteti             | Niveli më i lartë i observuar i borxhit | Niveli më i fundit i observuar i borxhit | Kufiri i borxhit * |
|--------------------|-----------------------------------------|------------------------------------------|--------------------|
|                    |                                         |                                          |                    |
| Kosova             | 21.83                                   | 21.83                                    | 60                 |
| Maqedonia e Veriut | 60.20                                   | 60.20                                    | 53.42              |

|                        |        |        |    |
|------------------------|--------|--------|----|
| Shqipëria              | 77.90  | 77.90  | 60 |
| Serbia                 | 224.75 | 57.82  | 60 |
| Mali i Zi              | 105.15 | 105.15 | 60 |
| Bosnja dhe Hercegovina | 56.04  | 36.72  | 60 |

*Burimi:* Kalkulimet vetanake të autores

Sqarim: \* Për vendet tjera të Ballkanit Perëndimor sipas kritereve të Mastrihtit, ndërsa për Maqedoninë e Veriut sipas (Bexheti, A. & Sadiku, L., 2019).

Nga tabela 7 shihet që shumica e vendeve e kanë arritur pikun e borxhit publik në vitin e fundit të observuar (2020), si Kosova, Maqedonia e Veriut, Shqipëria dhe Mali i Zi. Ndërsa, piku i borxhit publik në Bosnje dhe Hercegovinë ishte në vitin 1999, ndërsa piku i Serbisë ishte në vitin 2000.

Tabela 8 paraqet përlogaritjen e hapësirës fiskale të vendeve të Ballkanit Perëndimor si diferencë ndërmjet kufirit të borxhit dhe nivelit të borxhit publik në vitin më të fundit (2020).

Tabela 8. Hapësira fiskale dhe reduktimet e borxhit të kaluar

| Shteti                 | Diferenca ndërmjet pikut dhe borxhit publik 2020 | Hapësira fiskale |
|------------------------|--------------------------------------------------|------------------|
| Kosova                 | 0.0                                              | 38.17            |
| Maqedonia e Veriut     | 0.0                                              | 0.00             |
| Shqipëria              | 0.0                                              | 0.00             |
| Serbia                 | 166.93                                           | 2.18             |
| Mali i Zi              | 0.0                                              | 0.00             |
| Bosnja dhe Hercegovina | 19.32                                            | 23.28            |

*Burimi:* Kalkulimet vetanake të autores

**Sqarim:** Ngjyra e kuqe nënkupton që nuk ka hapësirë fiskale, ngjyra e portokalltë hapësirë

fiskale të limituar dhe ngjyra e verdhë pak hapësirë fiskale.

Të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor kanë pasur një rritje drastike të borxhit në vitin 2020, përveç Bosnjës dhe Hercegovinës që ka pasur një rritje më të lehtë. Këto rritje të nivelit të borxheve kanë ndikuar në uljen e hapësirave fiskale të vendeve. Siç shihet në tabelën 8, Maqedonia e Veriut, Shqipëria dhe Mali i Zi nuk kanë hapësirë fiskale. Serbia ka hapësirë fiskale shumë të limituar, ndërsa Bosnja dhe Hercegovina dhe Kosova kanë pak hapësirë fiskale.

## 5.2 Llogaritja e hapësirës fiskale sipas qasjes së Aizenman dhe Jinjark (2010)

Duke marrë parasysh që hapësira fiskale nuk është një dimensionale, atëherë nuk duhet shikuar vetëm në aspektin e borxhit publik. Të ardhura publike dhe shpenzimet publike, posaqërisht në vendet e Evropës Juglindore janë edhe më të rëndësishme, pra mundësia për ndryshime në këto dy krahë të bilancit krijon hapësirë fiskale strukturore dhe të ardhshme. Për këtë arsye hapësira fiskale është përlogaritur edhe sipas modelit të Aizenman dhe Jinjark (2010).

Aizenman dhe Jinjark (2010) shtuan frazën "de facto" në fillim të konceptit me një qasje origjinale dhe bënë një përkufizim si në vijim: "Hapësira fiskale de facto përfshinë burimet e përdorura në pagimin e borxhit publik në kohë kur taksat nuk mund të mbledhen (në periudhat e mbledhjes së ulët të taksave)." Matja e hapësirës fiskale mund të bëhet përmes formulës:

$$\text{Hapësira fiskale de facto} = \frac{\text{Borxh publik}}{\text{Mbledhja e taksave}} \quad (9)$$

Përveç kësaj, bëhet edhe një llogaritje e hapësirës fiskale mbi deficitet fiskale. Në këtë metodë alternative të matjes së hapësirës fiskale, deficitet buxhetor përdoren në vend të borxhit publik (Aizenman & Jinjark, 2010):

$$\text{Hapësira fiskale de facto} = \frac{\text{Deficiti buxhetor}}{\text{Të ardhurat nga taksat}} \quad (10)$$

Duke përdorur hapësirën fiskale de facto, janë bërë përllogaritjet për vendet e Ballkanit Perëndimor sipas dy mënyrave. Sipas mënyrës së parë, për një vend të caktuar në një vit të caktuar, Hapësira fiskale de facto është raporti i borxhit publik (% PBB-së) në vitin t me mesataren e të ardhurave nga taksat (% PBB-së) gjatë viteve t-5 në t. Ndërsa sipas metodës së dytë, për një vend të caktuar në një vit të caktuar, Hapësira fiskale de facto është raporti ndërmjet mesatares së deficitit fiskal gjatë viteve t-5 në t me mesataren e të ardhurave nga taksat (% PBB-së) gjatë viteve t-5 në t. Rezultatet e hapësirës fiskale de facto janë paraqitur në tabelën 9.

Tabela 9. Hapësira fiskale de facto

| Shteti                 | Të ardhurat<br>nga taksat<br>(mesatarja<br>2015-2020) % | Borxhi<br>publik<br>2020 % | Hapësira<br>fiskale 1 | Deficiti fiskal               |                       |
|------------------------|---------------------------------------------------------|----------------------------|-----------------------|-------------------------------|-----------------------|
|                        |                                                         |                            |                       | (mesatarja<br>2015-2020)<br>% | Hapësira<br>fiskale 2 |
|                        | (I)                                                     | (II)                       | (II)/(I)              | (III)                         | (III/I)               |
| Kosova                 | 24.13                                                   | 21.83                      | 0.90                  | 3.13                          | 0.13                  |
| Maqedonia e Veriut     | 16.97                                                   | 60.20                      | 3.55                  | 3.46                          | 0.20                  |
| Shqipëria              | 18.20                                                   | 77.90                      | 4.28                  | 2.77                          | 0.15                  |
| Serbia                 | 23.51                                                   | 57.82                      | 2.46                  | 1.60                          | 0.07                  |
| Mali i Zi              | 26.14                                                   | 105.15                     | 4.02                  | 6.31                          | 0.24                  |
| Bosnja dhe Hercegovina | 20.05                                                   | 36.72                      | 1.83                  | -0.15                         | -0.01                 |

*Burimi:* Kalkulimet vetanake të autorëve

Nga rezultatet në tabelën 9 mund të shohim që hapësira fiskale de facto sipas metodës së parë, në përgjithësi paraqet vitet e mbledhjes së taksave që kërkohen për pagesën e borxhit publik. Prandaj, sipas kësaj qasjeje vendet e zhvilluara konsiderohet që janë përgjithësisht në një pozicion më të favorshëm për sa i përket hapësirës fiskale. Në këtë metodë, mbledhja e taksave luan një rol të rëndësishëm. Të ardhurat mesatare tatimore të vendeve të Ballkanit Perëndimor


përfshijnë 17% ose më shumë të PBB-së, me një mesatare të përgjithshme prej 21.50% të PBB-së.

Shumë faktorë i vendosin vendet e zhvilluara në një pozicion më të favorshëm përsa i përket taksimit, si norma e taksave në vendet e zhvilluara është më afër nivelit optimal në krahasim me vendet në zhvillim, sektori më i ultë informal në vendet e zhvilluara, modernizimi i sistemit tatimor dhe pajisja e administratave tatimore me sisteme më të përshtatshme në pikën e mbledhjes, si dhe ndërgjegjësimi më i lartë i taksapaguesve. Norma mesatare tatimore e vendeve të Ballkanit Perëndimor me rreth 20% na lë të nënkuptojmë që normat e taksave janë larg nga optimalja për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe hapësira fiskale mund të krijohet duke rritur të ardhurat publike.

Një tjetër variabël në tabelën 9 është borxhi publik në % të PBB-së, i cili është nën 60% në tre vende të Ballkanit Perëndimor, si në Kosovë, Serbi dhe Bosnie dhe Hercegovinë për shkak të rregullave fiskale të Mastrihtit të aplikuara në ketë vende. Vendet që janë mbi këtë normë, si Maqedonia e Veriut, Shqipëria dhe Mali i Zi kanë tendosur kapacitetet e tyre të borxhit, veçanërisht për shkak të pandemisë Covid-19. Derisa vendet e Ballkanit Perëndimor po kërkonin rimëkëmbjen pas pandemisë, rajoni u përball me një grup të ri sfidash. Niveli i borxhit publik është përkeqësuar edhe më tej. Lufta ruso-ukrainase tani po dërgon valë tronditëse në të gjithë rajonin, veçanërisht nëpërmjet krizës inflatorike dhe posaçërisht asaj energjetike, por edhe nëpërmjet një ndërprerjeje në flukset e tregtisë dhe investimeve, duke vënë në rrezik rimëkëmbjen e rajonit. Mbështetje e kujdesshme e politikave brenda një hapësire fiskale më të kufizuar do të nevojitet për të drejtuar Ballkanin Perëndimor në sfidat e ardhshme (World Bank, 2022).

Megjithatë vendet e zhvilluara kanë sisteme të forta financiare, kufijtë e tyre të borxhit mund të jenë më të larta se vendet në zhvillim. Prandaj, raportet e borxhit në vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim janë në nivele të ndryshme. Si përfundim, sipas qasjes Aizenman–Jinjarak, mund të thuhet se vendet e zhvilluara janë më të favorshme për sa i përket potencialit të tyre për të krijuar hapësirë fiskale.

Figura 32. Hapësira fiskale de facto në vendet e Ballkanit Perëndimor



Burimi: Kalkulimet vetanake të autores duke u bazuar në Agjencitë statistikore, Ministrinë e Financave dhe Bankat Qendrore të vendeve përkatëse të Ballkanit Perëndimor.

Borxhi i ulët publik në raport me të ardhurat tatimore nënkupton kapacitet më të madh fiskal për të financuar stimujt duke përdorur kapacitetin ekzistues tatimor. Pra, një rënie e këtij raporti tregon një hapësirë më të madhe fiskale. Kurse, një rritje e 'Hapësirës Fiskale De Facto' në një vend nënkupton se ky vend po përjeton vështirësi për të përmbushur detyrimet e tij të borxhit, pasi do të duheshin më shumë vite që të shlyente borxhin e tij publik të papaguar.

Nga figura 32, mund të shohim që hapësira fiskale de facto sipas metodës së parë, të përlogaritur si raporti në mes të borxhit publik të vitit të fundit (në rastin tonë viti 2020) dhe mesatares së të ardhurave nga taksat (ndërmjet viteve 2015-2020 për të zbutur luhatjet e ciklit të biznesit) ka variacion të gjerë të viteve tatimore të nevojshme për shlyerjen e borxhit publik, nga më pak se 1 vit në Kosovë (që tregon një hapësirë të lartë fiskale), deri në rreth 4.3 vite në Shqipëri (që tregon një hapësirë të ulët fiskale). Kosovës i duhen mesatarisht 0.90 vite, apo rreth 330 ditë për grumbullimin e taksave për të shlyer borxhin publik. Bosnja dhe Hercegovinës

i duhen 1.83 vite, pasuar nga Serbia 2.46 vite. Ndërsa në pozita më të jofavorshme qëndrojnë Maqedonia e Veriut me 3.55 vite, Mali i Zi me 4.02 vite dhe Shqipëria me 4.28 vite.

Nga figura 32 mund të shohim që hapësira fiskale de facto e llogaritur sipas metodës së dytë, si raport ndërmjet mesatares së deficitit fiskal (të viteve 2015-2020) dhe mesatares së të ardhurave nga taksat (të viteve 2015-2020) është në përputhje me konceptin se, edhe pa rritur bazën tatimore, vendet e Ballkanit Perëndimor kishin hapësirë të konsiderueshme fiskale në vitin 2020.

### 5.3 Testimi i hipotezave

Për vërtetimin e hipotezës së dytë: *“Korpusi i faktorëve politik sfidon krijimin e hapësirës fiskale”* do të analizojmë ndikimin e treguesit të kontrollit të korrupsionit dhe të stabilitetit politik në hapësirën fiskale, si variabël të varur.

Ekuacioni i modelit empirik është:

$$y_{it} = c + \beta_1(\text{corruption\_control}_{it}) + \beta_2(p\_stability_{it}) + e_{it} \quad (11)$$

Ku,  $y_{it}$  është variabla e varur, pra hapësira fiskale për secilin shtet  $i$  dhe vitet  $t$ ;  $c$  është konstantja; variablat e pavarura përfshijnë  $\text{corruption\_control}_{it}$  që është treguesi i kontrollit të korrupsionit;  $p\_stability_{it}$  paraqet indeksin e stabilitetit politik dhe mungesës së dhunës ose terrorizmit.

Statistikat deskriptive:

Tabela 10. Statistikat deskriptive

| Variabla           | Observimet | Mesatarja | Dev. Std | Minimumi  | Maksimumi |
|--------------------|------------|-----------|----------|-----------|-----------|
| fiscal_space       | 118        | 12.54709  | 26.05624 | -164.75   | 54.73     |
| corruption_control | 120        | -.3997912 | .2387114 | -1.177213 | .3920856  |
| p_stability        | 108        | -.2436303 | .454084  | -1.642953 | 1.00747   |

Burimi: Kalkulimet e autores

Sipas Aizenman & Jinjark (2012) zakonisht ekziston autokorrelacioni ndërmjet termit të gabimit dhe variablave. Prandaj, kemi testuar autokorrelacionin përmes testit Durbin-Watson, ku rezulton që edhe për vendet e Ballkanit Perëndimor ekziston autokorrelacion 0.4587478 (Tabla 11).

Tabela 11. Vlerësimi i Auto-korrelacionit (Testi i Durbin-Watson)

| fiscal_space       | Koeficienti | Dev. Std | Dev. Std | P> t  | [95% Conf. Interval] |          |
|--------------------|-------------|----------|----------|-------|----------------------|----------|
| corruption_control | 24.90324    | 12.11195 | 2.06     | 0.042 | .8874826             | 48.919   |
| p_stability        | -6.848131   | 5.905321 | . -1.16  | 0.249 | -18.55729            | 4.86103  |
| _cons              | 21.21402    | 5.286402 | 4.01     | 0.000 | 10.73207             | 31.69598 |

Prob > F = 0.1154

R-squared = 0.0403

Adj R-squared = 0.0220

Durbin-Watson d-statistic (3, 108) = 0.4587478

Burimi: Kalkulimet e autores

Për të korrigjuar autokorrelacionin kemi përdorur regresionin Prais-Winsten me opsionin Cochrane–Orcutt, ku koeficienti i determinacionit është rritur në vlerën 19.6%, ndërsa testi i Durbin-Watson është përmirësuar në vlerën 1.232967.

Rezultatet e regresionit të Prais-Winsten janë paraqitur në tabelën 12.

Tabela 12. Rezultatet e regresionit Prais-Winsten:

---

|                 |
|-----------------|
| (Prais-Winsten) |
|-----------------|

| VARIABLES          | Fiscal_space        |
|--------------------|---------------------|
| corruption_control | 46.43***<br>(15.66) |
| p_stability        | 10.48*<br>(6.111)   |
| Constant           | 17.91<br>(19.71)    |
| Observations       | 101                 |
| R-squared          | 0.196               |

*Burimi:* Kalkulimet vetanake të autores

Nga rezultatet e regresionit shohim që ekziston ndërlidhje pozitive ndërmjet treguesit të kontrollit të korrupsionit me hapësirën fiskale, me koeficient prej 46.43 me signifikançë 99%. Pra, vendet që kanë nivel më të lartë të kontrollit të korrupsionit, janë vende me më pak korrupsion, rrjedhimisht kanë edhe hapësirë fiskale më të madhe. Rezultatet janë të ngjashme me (Aizenman & Jinjark, 2012; Aizenman et al, 2018; Ortiz et al, 2011) dhe të tjerë.

Po ashtu koeficienti i indeksit të stabilitetit politik dhe mungesës së dhunës ose terrorizmit është pozitiv 10.48, me signifikançë 90%, që do të thotë vendet me stabilitet politik më të lartë, kanë edhe hapësirë fiskale më të madhe. Rezultatet janë në përputhje me shumë autorë, si (Ostry et al, 2010; Ghosh et al, 2013).

Përveç variablave ekonomike, tek korpusi i faktorëve politik përfshihen edhe disa tregues politiko-intitucional, e në veçanti qeverisjet me koalicione. Shumë autorë kanë argumentuar se qeverisjet me koalicione dhe përmbushje të dëshirave dhe programeve të partnerëve të koalicionit shkaktojnë deficite dhe borxhe rritëse.

Natyra e sistemeve partiake dhe e strukturës së qeverisë varet nga sistemi zgjedhor. Sistemet zgjedhore proporcionale dhe përfaqësuese zakonisht krijojnë sisteme shumëpartiake dhe

qeverisje koalicioni, ndërsa sistemet mazhoritare çojnë në qeverisje njëpartiake. Institucionet politike dhe ligjet zgjedhore që çojnë në formimin e qeverisjeve të koalicionit, shoqërohen me deficite më të larta sesa qeveritë njëpartiake. Qeverisjet me koalicione të dobëta zakonisht i shtyjnë rregullimet fiskale, prandaj borxhet publike akumulohen më shpejt në këto vende. Ku sa më i lartë të jetë numri i partive në një qeverisje koalicioni, aq më i lartë është borxhi publik (Alesina dhe Perotti, 1994). Sipas Alesina dhe Perotti (1996) qeverisjet me koalicione gjenerojnë vonesa në politikëbërje, pasi që kërkojnë miratimin e disa partive për të qeverisur dhe fuqia e vetos e secilit anëtar të koalicionit mund të vonojë procesin legjislativ. Prandaj edhe deficitet buxhetore janë rezultat i rregullimeve fiskale të vonuara të qeverive me qeverisje të koalicionit.

Qeverisjet e koalicionit kanë po aq gjasa sa qeveritë e tjera për të provuar politika fiskale shumë të shtrënguara. Megjithatë, ata duket se nuk janë në gjendje të kryejnë llojet e shkurtimeve të shpenzimeve që nevojiten për të bërë një rregullim të fortë fiskal afatgjatë. Si rezultat, shkalla e suksesit të tyre është drastikisht më e ulët se ajo e qeverive të pakicave dhe qeverive njëpartiake. Arsyeja kryesore është se konfliktet ndërmjet anëtarëve të koalicionit dhe brishtësia e qeverisjeve të koalicionit e bëjnë të vështirë mbajtjen e një qëndrimi fiskal "të ashpër", veçanërisht kur përfshihen programe të ndjeshme politike, punësimet në qeveri dhe sigurimet shoqërore (Alesina dhe Perotti, 1995a). Pra, qeverisjet e koalicionit duket se nuk janë në gjendje të sigurojnë një konsolidim të përhershëm buxhetor. Mosmarrëveshjet brenda koalicionit e bëjnë të vështirë mbajtjen e politikave "të ashpra" dhe marrëveshja arrihet me koncesione fiskale ndaj grupeve të ndryshme të presionit brenda koalicionit (Alesina dhe Perotti, 1995b). Ky këndvështrim është gjithashtu në përputhje me rezultatet empirike nga Roubini dhe Sachs (1989) mbi efektin e qeverisjeve të koalicionit në deficitet buxhetore. Ku gjetjet e tyre tregojnë që ekziston një tendencë e qartë për deficite më të mëdha në vendet e karakterizuara nga një qeverisje me jetëgjatësi më të shkurtër dhe nga prania e shumë partive politike në një koalicion qeverisës. Problemi i qeverisjeve të koalicionit është pamundësia për të siguruar marrëveshje në mes të partnerëve të koalicionit brenda një qeverie të caktuar. Sa më i shkurtër të jetë mandati i pritshëm i qeverisë, aq më e vështirë mund të jetë arritja e bashkëpunimit ndërmjet partnerëve të koalicionit. Thelbi i problemit buxhetor për një qeverisje koalicioni vjen nga tre faktorë. Së pari, partnerët individualë të koalicionit në qeveritë

shumëpartiake kanë interesa dhe zona të veçanta elektorale. Nuk ka asnjë funksion të vetëm objektiv për partitë e ndryshme politike në qeveri. Të gjithë partnerët e koalicionit mund të preferojnë shkurtime gjithëpërfshirëse buxhetore në vend të vazhdimit të deficiteve të mëdha, por secili partner koalicioni mund të ketë nxitjen për të mbrojtur pjesën e tij të veçantë të buxhetit kundër masave shtrënguese. Në mungesë të një koordinimi të fortë ndërmjet anëtarëve të koalicionit për të prodhuar rezultatin "bashkëpunues", zgjidhja jobashkëpunuese e mos shkurtimit të buxhetit ka shumë të ngjarë të lindë. Së dyti, partnerët individualë të koalicionit shpesh do të kenë fuqi të madhe për të parandaluar një ndryshim në status quo, ndonëse ata zakonisht nuk do të kenë fuqinë vetë për të zbatuar një program pozitiv ndryshimi. Pra, anëtarët e koalicionit do të kenë të drejtën e vetos kundër ndryshimit. Edhe një parti shumë e vogël në një koalicion shumëpartiak mund të ketë fuqi të madhe për shkak të aftësisë së saj për të shpërbërë qeverinë. Së treti, mekanizmat e zbatimit midis partnerëve të koalicionit për të siguruar rezultatin e bashkëpunimit shpesh do të jenë shumë të dobëta.

Grilli et al. (1991) tregojnë gjithashtu se deficitet buxhetore janë të ndërlidhura me qëndrueshmërinë e qeverisë, ku qeveritë me jetë më të gjatë kanë deficite më të vogla. Duke pasur parasysh që qeverisjet e koalicionit zakonisht kanë jetë më të shkurtër se qeveritë njëpartiake, ato kanë tendencë të kenë deficite më të mëdha. Dallimi ndërmjet paqëndrueshmërisë dhe shpeshtësisë së ndryshimeve qeveritare është i rëndësishëm në të gjitha vendet që zakonisht qeverisen nga qeveritë e koalicionit, ku ndryshimet e qeverisë rrallëherë janë për shkak të një ndarjeje totale të koalicionit themelor.

Qeverisje të paqëndrueshme dhe të ndryshueshme të koalicionit hasim edhe në vendet e Ballkanit Perëndimor, e sidomos në Kosovë, ku aktualisht është funksionale legjislatura e tetë që nga pas lufta. Përjashtim bën Bosnja dhe Hercegovina që ka një regjim hibrid të qeverisjes.

Nga rezultatet e mësipërme mund të themi që **vërtetohet hipoteza e dytë** *“Korpusi i faktorëve politik sfidon krijimin e hapësirës fiskale”*.

Për të vërtetuar hipotezën e tretë: *“Hapësira fiskale në ciklet rënëse ekonomike krijon hapësirë ndikuese për politika fiskale ekspansive”* është krijuar një model i ri. Variabla e varur është rritja reale e PBB-së, ndërsa si variabël e pavarur është hapësira fiskale. Po ashtu është ndërtuar një

dummy variabël, duke u bazuar tek modeli Romer&Romer (2017) dhe Romer&Romer (2019) për përcaktimin e cikleve rënëse të shkaktuar nga krizat.

Ekuacioni i modelit empirik është:

$$y_{it} = c + \beta_1(fiscal\_space_{it}) + \beta_2(crisis_{it}) + e_{it} \quad (12)$$

Ku,  $y_{it}$  është variabla e varur, pra rritja reale ekonomike për secilin shtet  $i$  dhe vitet  $t$ ;  $c$  është konstantja; variablat e pavarura përfshijnë  $fiscal\_space_{it}$  që është hapësira fiskale;  $crisis_{it}$  paraqet dummy variabilën për identifikimin e cikleve rënëse.

Modeli empirik është zhvilluar për të vlerësuar marrëdhënien ndërmjet hapësirës fiskale, krizave ekonomike dhe rritjes reale ekonomike në shtetet e Ballkanit Perëndimor për periudhën kohore 2000-2020. Për këtë qëllim, kemi përdorur regresionin OLS, me efekte fikse, me efekte të rastit, si dhe Hausman – Taylor me variabla instrumental. Po ashtu është përdorur Hausman testi, për të bërë përzgjedhjen ndërmjet modelit me efekte fikse, të rastit dhe Hausman - Taylor. Rezultati i testit të Hausman tregon që modeli Hausman - Taylor është më konsistent dhe eficient se sa efektet fiske dhe të rastit (Tabela 14).

Në studim janë përfshier gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, ku të dhënat për rritjen reale ekonomike janë grumbulluar nga Ministritë e Financave, Bankat Qendrore të vendeve përkatëse, ndërsa hapësira fiskale në bazë të kalkulimeve vetanake të autorëve.

Përmbledhja e statistikave të studimit është paraqitur në tabelën 13

Tabela 13. Statistikat deskriptive

| Variablat  | Observimet | Mesatarja | Dev. Std | Minimumi | Maksimumi |
|------------|------------|-----------|----------|----------|-----------|
| gdp_growth | 124        | - 3.12329 | 3.404825 | -15.307  | 11.063    |
| Crisis     | 126        | .2380952  | .427618  | 0        | 1         |
| Fs         | 118        | 16.6194   | 16.41522 | 0        | 54.73     |

*Burimi:* Kalkulimet vetanake të autores

Është llogaritur regresioni OLS, efektet fiske, efektet e rastit dhe Hausman-Taylor me variabla instrumental. Koeficienti nga vlerësuesi i regresionit OLS është i paragjykuar për shkak të heterogjenitetit të efektit të pavrojtuar individual-spezifik. Prandaj, kalkuloohen modelet me efekte fikse dhe efekte të rastit, të cilat janë të paraqitura në tabelën 15. Hausman testi është aplikuar për të mundësuar krahasimin e vlerësuesve nga efektet fikse dhe efekteve të rastit (Tabela 14). Statistika e Hausman testit rezulton **11.81**, ndërsa testi chi-square **0.0027**, që është më e vogël se 0.05 dhe nënkupton që **hipoteza alternative mund të pranohet**, prandaj përzgjedhja duhet të bëhet në favor të vlerësuesit të efekteve **fikse**. Për t'u marrë me problemin e endogjenitetit, i cili mund të çojë në koeficientë të njëanshëm (biased) të regresionit është përllogaritur vlerësuesi i Hausman-Taylor (Tabela 14). Hausman testi është kalkuluar gjithashtu për vlerësuesin e efekteve fikse dhe vlerësuesin e Hausman-Taylor, për të identifikuar nëse teknika e variablave instrumental (IV) eliminon korrelacionin ndërmjet efekteve të pavrojtura individual-specifike dhe variablave shpjeguese. Hausman testi është 29.30 dhe testi chi-square 0.0000, që nënkupton hipoteza zero refuzohet në favor të Hausman-Taylor (IV) (tabela 14). Prandaj, metoda e Hausman-Taylor (IV) me variabla instrumental eliminon korrelacionin ndërmjet variablave që janë përfshirë në model dhe komponentëve individual të termit të gabimit. Po ashtu, kjo metodë eliminon problemin e endogjenitetit. Prandaj, mund të konkludojmë që Hausman-Taylor IV është zgjidhja më e mirë ndërmjet efekteve fikse dhe të rastit. (Tabela 14).

Tabela 14. Hausman test

| Test                              | Chi <sup>2</sup> | Prob > Chi <sup>2</sup> | Rezultati                |
|-----------------------------------|------------------|-------------------------|--------------------------|
| Efektet fikse vs Efektet e rastit | 11.81            | 0.0027                  | Refuzohet H <sub>0</sub> |
| Hausman Tylor vs Efektet fikse    | 29.30            | 0.0000                  | Refuzohet H <sub>0</sub> |

*Burimi:* Kalkulimet vetanake të autores

Rezultatet e regresionit janë paraqitur në tabelën e më poshtme.

Tabela 15. Rezultatet e regresionit

|                | (Model 1)            | (Model 2)            | (Model 3)            | (Model 4)            |
|----------------|----------------------|----------------------|----------------------|----------------------|
|                | OLS                  | Fixed-effects        | Random-effects       | Hausman Taylor-IV)   |
| VARIABLAT      | gdp_growth           | gdp_growth           | gdp_growth           | gdp_growth           |
| Crisis         | -2.721***<br>(0.678) | -3.010***<br>(0.650) | -2.750***<br>(0.672) | -2.954***<br>(0.651) |
| Fs             | 0.0333*<br>(0.0181)  | 0.136***<br>(0.0337) | 0.0420**<br>(0.0198) | 0.111***<br>(0.0303) |
| Code           |                      |                      |                      | -0.00133<br>(0.492)  |
| Constant       | 3.213***<br>(0.437)  | 1.584**<br>(0.622)   | 3.066***<br>(0.491)  | 1.866<br>(2.018)     |
| Observations   | 118                  | 118                  | 118                  | 118                  |
| R-squared      | 0.134                | 0.227                |                      |                      |
| Number of code |                      | 6                    | 6                    | 6                    |

*Sqarim:* \* Statistikisht signifikanant në nivelin 10%, \*\* statistikisht signifikanant në nivelin 5%; \*\*\* statistikisht signifikanant në nivelin 1%.

*Burimi:* Kalkulimet vetanake të autores

Nga rezultatet e regresionit të Hausman Taylor IV shohim që hapësira fiskale ka ndërlidhje pozitive me rritjen ekonomike, me një koeficient prej 0.111 (dev. st 0.0303) dhe me signifikanacë 99%. Në qoftë se hapësira fiskale rritet për 1%, atëherë rritja reale ekonomike pritet që të rritet për 0.111, nëse faktorët të tjerë mbasin të pandryshuar. Rritja ekonomike është një nga

treguesit kryesor të stabilitetit ekonomik të vendit. Prandaj, nga kjo mund të konkludojmë që **vërtetohet hipoteza e parë**: *“Hapësira fiskale ka ndikim në stabilitetin makroekonomik të vendeve”*. Rezultatet janë të ngjashme me gjetjet e autorëve të tjerë si (Heller, 2005; Ley, 2009).

Nga tabela 15 shohim që dummy variabla e krizës ka ndikim negativ në rritjen ekonomike. Pra, atëherë kur kemi pasur kriza, ka ndikuar që ekonomia të shkon në recesion. Koeficienti i dummy variablës së krizës është -2.95 (me një devijim standard prej 0.651), që do të thotë kur kemi kriza ekonomike këto e shpiejnë ekonominë në recesion. Kurse hapësira fiskale ka ndikim pozitiv me rritjen ekonomike. Prandaj, mund të themi që hapësira fiskale ekzistente do të mund të përdoret për politika ekspansioniste. Nga ky konstantim, mund të themi që **vërtetohet hipoteza e tretë**: *“Hapësira fiskale në ciklet rënëse ekonomike krijon hapësirë ndikuese për politika fiskale ekspansive”*. Rezultatet janë të ngjashme me gjetjet e autorëve të tjerë si (Romer&Romer 2017; Romer&Romer, 2019).

#### 5.4 Vlerësimet dhe alternativat lidhur me hapësirën fiskale të Kosovës

Për të marrë vlerësime shtesë lidhur me hapësirën fiskale të Kosovë, se si është e mundur që Kosova si vendi më i pazhvilluar në Ballkanin Perëndimor ta ketë hapësirën fiskale më të lartë; sa është real borxhi publik i Kosovës kur nuk ka fond të sigurimit shëndetësor dhe pensional të konsoliduar dhe ka raporte të paharmonizuara të borxhit me Serbinë dhe pse qeveria e Kosovës këtë hapësirë të lirë fiskale nuk e përdorë në mënyrë më proaktive dhe ekspansioniste në funksion të zhvillimit të përsheptuar ekonomik; janë kontaktuar përfaqësuesit e misionit të Bankës Botërore në Kosovë, Fondit Monetar Ndërkombëtar, ministri aktual dhe ish ministrat e Financave në Kosovë.

Përkundër parashtrimit të kërkesës dhe pritjes së përgjigjes nga Ministri aktual i Financave, nuk kemi marrë ndonjë përgjigje. Prandaj, janë përfshier konstatimet e Institucioneve financiare ndërkombëtare.

Nga Banka Botërore është intervistuar z. Besart Myderrizi, i cili thotë që shtetet të cilat kanë pasur adaptim unilateral të një valute, atëherë roli i politikës fiskale si vegël për të stimuluar kërkesën agregate duhet të balancohet edhe me rolin e kësaj politike në menaxhimin e cikleve biznesore.

Në Kosovë operacionet e borxhit kanë filluar të funksionalizohen prej vitit 2012. Pra, deri në vitin 2012 Kosova nuk ka pasur kapacitete për të grumbulluar borxh të brendshëm në veçanti. Brenda një periudhe shumë të shkurtër, pra nga periudha 2012-2022, Kosova ka kaluar nga një gjendje ku stoku i brendshëm ka qenë 0% ndaj PBB-së, në një gjendje ku është duke e tejkaluar vlerën prej 1 miliard €. Prej perspektivës së menaxhimit të borxhit dhe idesë se a ka hapësirë për borxh shtesë të shfrytëzohet për qëllime zhvillimore dhe ekspansion fiskal më të shpejtë, duhet të kemi parasysh që borxhi kur ka filluar në Kosovë ka filluar me maturitete shumë të shkurta, sidomos borxhi i brendshëm. Pra, nga bonot e thesarit që kanë pasur maturitet gjashtë mujor, pastaj 1 vjeçar dhe më vonë kanë filluar të zgjaten maturitetet edhe pse tash maturiteti mesatar i borxhit të Kosovës nuk është shumë i lartë, është diku rreth 3.2 vjet. Përveç amortizimit të borxhit të jashtëm, nëse nuk dëshirojmë ta rrisim fare borxhin, por vetëm ta mirëmbajmë këtë stok të borxhit të brendshëm që sot ekziston e që është rreth 1 miliard € me maturitet pak mbi 3 vite, atëherë duhet përafërsisht 200-300 milion € për t'i rifinancuar në vjet në mënyrë që të mbahet stoku i tanishëm i borxhit.

Te borxhi i brendshëm ka disa kufizime. Kosova dhe Bosnja e Hercegovina janë dy vendet e vetme në Ballkanin Perëndimor që nuk kanë qasje në tregjet ndërkombëtare financiare, pra nuk kanë mundësi të shfrytëzojnë lëshimin e eurobondit sidomos me maturitete më të gjata për të arritur të mbulojnë nevojat e financimit. Përveç kësaj Kosova është i vetmi vend në Ballkanin Perëndimor që nuk ka një rejting kreditor. Kjo përveç që e kufizon qasjen në tregjet ndërkombëtare, e kufizon edhe hapësirën për ngritjen e borxhit të brendshëm dhe blerjen e borxhit të brendshëm nga bankat komerciale, të cilët janë akterët primar në borxhin e brendshëm. Bankat komerciale në Kosovë janë të dominuara prej bankave të huaja. Mbi 80% e aseteve financiare janë në pronësi të tre bankave e që janë në pronësi të huaj. Bankat i nënshtrohen rregullave financiare të menaxhimit të rrezikut që vijnë nga shtetet apo kompanitë

amë. Kompanitë amë nuk i njohin letrat me vlerë të thesarit të Kosovës si letra pa rrezik. Edhe pse Banka Qendrore e Kosovës për qëllime të përlogaritjes së mjaftueshmërisë së kapitalit dhe të vlerësimit se sa është adekuat kapitali i bankave i konsiderojnë këto letra si asete pa rrezik. Prandaj, kjo në anën tjetër e kufizon dëshirën e bankave komerciale se sa mund të blejnë borxh të brendshëm.

Ndërsa sa i përket borxhit të jashtëm, prej vitit 2009 kur Kosova është anëtarësuar në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore, si pjesë e procesit të anëtarësimit, Kosova ka marrë përsipër përgjegjësinë për servisimin e një pjese të borxheve të konsoliduar të ish Jugosllavisë. 1/3 e këtij borxhi është shlyer menjëherë, kryesisht si rezultat i një donacioni nga qeveria Amerikane, por edhe me mbështetje të Bankës dhe Komisionit Evropian. Megjithatë ai është borxh i Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) i cili mbetet që të servisohet edhe në të ardhmen.

Borxhi ndaj Klubit të Parisit dhe Klubit të Londrës, janë dy pjesë të borxhit të cilat Kosova si shtet ende nuk i ka pranuar që janë të saja. Ende nuk ka një proces të arbitrazhit. Nëse shikojmë analizën e qëndrueshmërisë së borxhit, më herët është marrë si detyrim kontingjent kjo, mirëpo tashmë nuk konsiderohet si faktor kufizues. Natyrisht ekziston një probabilitet i shpagimit të tillë, mirëpo kjo është një çështje shumë politike se si do të trajtohet në kuadër të zgjedhjes së kontestit të përgjithshëm me Serbinë. Këto borxhe janë duke u servisuar prej anës së Serbisë. Bilanci i tyre është vazhdimisht në rënie e sipër të atyre borxheve. Në një proces eventual të arbitrazhit përderisa Serbia nuk e njeh Kosovën, nuk është e lehtë të shkohet në arbitrazh për këto borxhe përderisa nuk iniciohet prej Serbisë. Interesi financiar që Kosova t'i merr ato borxhe dhe Serbia të mos i servisojë, mirëpo Serbia është duke i servisuar dhe për momentin nuk është i kontestuar në aspektin e Kosovës.

Sa i përket arsyes se pse nuk është shfrytëzuar deri tash hapësira fiskale e Kosovës, duhet të kemi parasysh disa gjëra:

- 1) Të hyrat e grumbulluara si tatimore si ato jo tatimore – më herët ka pasur shumë të hyra që janë shfrytëzuar nga ana e qeverisë, që kanë ardhur si fonde të përkohshme nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit (AKP). Prej vitit 2018 e deri në vitin 2021, qeveria e

Kosovës i ka tërhekur nga Agjensioni Kosovar i Privatizimit rreth 300 milion €, të cilat në fakt janë detyrime kontigjente dhe varen nga procesi i trajtimit të kërkesave të kreditorëve për ndërmarrjet shoqërore që janë në proces të likuidimit. Ky është detyrim kontigjent më i rëndësishëm se sa borxhi ndaj Klubit të Parisit dhe Klubit të Londrës.

- 2) Kapacitetet për marrjen e borxheve nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare (IFN) janë zhvilluar gradualisht. Megjithatë edhe në këtë drejtim Kosova ka pasur një rritje mjaft të shpejtë të borxhit. Pra, hapësirën fiskale nuk duhet shikuar vetëm në aspektin statik, por duhet shikuar edhe në aspektin dinamik se sa po ndryshohet kjo brenda viteve. Kosova ka filluar prej një baze të ulët në anën e të hyrave tatimore, formalizimi por në anën tjetër edhe rritja e bazës tatimore ka qenë shumë e shpejtë, sidomos brenda periudhës 2010-2021. Me përjashtim të vitit 2020, ku për shkak të pandemisë ka pasur për herë të parë një ulje në grumbullimin e taksave. Në anën tjetër efektiviteti i shpenzimeve dhe kapacitetet për shpenzime kanë qenë më të kufizuara. Nëse i heqim tre projektet e mëdha infrastrukturore që nuk janë përfunduar me prokurim lokal, autostrada “rruga 7” dhe “rruga 6”. Projektet të cilat përfundohen me prokurime lokale historikisht kanë normë të ulët të ekzekutimit. Prandaj edhe pyetja duhet të shtrohet jo vetëm në funksionin se pse nuk po shfrytëzohet hapësira fiskale, por edhe a duhet të shfrytëzohet hapësira fiskale dhe si duhet të shfrytëzohet hapësira fiskale kundrejt kapaciteteve për ekzekutim dhe efektivitetit të shpenzimeve. E dijmë që rritja më e madhe e shpenzimeve brenda këtyre 5 viteve të fundit sidomos është duhet ndodhur në shpenzimet rrjedhëse, me fokus tek kategoria e subvencioneve dhe transfereve që sot zë mbi 25% të shpenzimeve të përgjithshme me fokus te transferet kategorike që kompensojnë merita e përfitime që ndërlidhen me evente e që nuk ndërlidhen me gjendjen ekonomike të përfituesit që do të thotë nuk janë të shënjestruara ndaj varfërisë, por edhe tek kategoria e pagave dhe mëditjeve që sot zë mbi 20% të shpenzimeve të përgjithshme.
- 3) Elementi i tretë që duhet pasur parasysh është që qeveria e Kosovës ka sistem kontabël të bazuar në para të gatshme. Ndonjëherë ky sistem nuk e paraqet pasqyrën e drejtë. Për momentin përveç shifrave të borxhit që ne i shohim, ekzistojnë marrëveshje me

institucione financiare ndërkombëtare të cilat janë të ratifikuara nga Parlamenti i Kosovës, por megjithatë ende nuk janë disbursuar dhe këto marrëveshje kanë vlerë mbi 8% të PBB-së. Periudha e implementimit varet prej planit do të përdoret. P.sh. projekti me francezët 60 milion € që parasheh ndërtimin e fabrikës për trajtimin e ujërave të zeza në Prishtinë, me një periudhë implementimi afatmesëm 2-3 vite, kurse periudha e kthimit varet nga kushtet e kreditimit të institucionit financiar ndërkombëtar, në rastin e Kosovës me Bankën Botërore. Kosova është ende anëtare e Agjencionit Ndërkombëtar të Zhvillimit, edhe pse PBB-ja dhe të ardhurat janë rritur dhe kanë kaluar në të ardhura të mesme të larta, por Kosova është në periudhën e tranzicionit prej Agjencionit Ndërkombëtar Zhvillimor dhe vazhdon të përfitojë nga kushtet e kredisë që zakonisht janë 5 vjet grace periudhë plus 25 vjet periudhë kthimi, me normë interesi që në të drejtat speciale të tërheqjes shkon në 1%.

- 4) Arsyeja e mos shfrytëzimit të hapësirës fiskale në Kosovë është që burimet e financimit kanë qenë të kufizuara, në anën tjetër rritja shumë e madhe e të hyrave duke marrë parasysh kapacitetet e kufizuara të shpenzimit e ka kufizuar në masë të madhe nevojën për shpenzime. Ka kufizime reale në kapacitet për shpenzime, sidomos kur ndërlidhen me çështjet e prokurimit, me çështjet e shpronësimit etj. Përgatitja e projekteve kërkon kapacitete teknike që të mund të vazhdohet me përdorim. Në të kaluarën ka pasur edhe fonde domethënëse të donatorëve. Por, Kosova në aspektin e kontraktimit, veçse është shumë më lartë se sa që tregojnë të dhënat aktuale të disbursimit. Natyrisht, ajo që ka ndodhur tash rishtazi është që janë shpague shumë kredi që më herët kanë qenë të ndërlidhura me programet standby me FMN-në. Kjo krijon hapësirë në aspekt të borxhit.
- 5) Ekziston një rregull fiskale që e kufizon deficitin fiskal në 2% të PBB-së në Kosovë, pa i marrë parasysh përjashtimet. Njëri nga përjashtimet thotë që mund të tejkalohet ky deficit nëse ka të hyra shtesë nga privatizimi. Këto të hyra shtesë nga privatizimi mund të shfrytëzohen vetëm nëse ka bilanc bankar, apo rezerva buxhetore që e tejkalojnë 4.5% të PBB-së. Një vend që është unilateralisht i eurizuar, gjithë rrezikun makroekonomik e realizon nga ana fiskale. P.sh. i kemi dhënë Bankës Qendrore me ligj të drejtën e luajtjes së rolit të kreditorit të fundëm. Pra, nëse bankat në Kosovë kanë

problem me likuiditet, BQK-ja ka mandatin me intervenu dhe me i dhënë likuiditet të përkohshëm. BQK-ja këto para i merr nga qeveria e Kosovës. Në vitin 2011 është krijuar fondi për likuiditet emergjent dhe 45 milion euro prej bilancit të qeverisë janë në të vërtetë para të ngriera. Pra, përveç transaksioneve që i shohim shpenzime dhe të hyra, ekzistojnë edhe transaksione që kanë të bëjnë me krijimin e rezervave të mjaftueshme buxhetore. Në vitin 2014 Kosova ka pasur një bilanc bankar prej 168 milion euro, prej të cilave kanë qenë vetëm 100 milion euro të autorizuar, pra të shfrytëzueshme prej Qeverisë. Është shumë me rëndësi të kuptohet që një shtet si Kosova që nuk ka asnjë burim tjetër të rezervave, politika fiskale përveç objektivës të stimulimit të zhvillimit e ka edhe objektivën e mbarëvajtjes së stabilitetit makroekonomik. E kjo më së miri u pa në vitin 2020, ku po të mos e kishte atë hapësirë fiskale Kosova do të kishte shumë probleme më të mëdha se sa që ka pasur. Po të mos kishte rezerva të mjaftueshme, nuk do të kishte pasur mundësi që qeveria t'i reagoonte krizës. Më e keqja do të ishte që qeveria do të ishte faktor në shtimin e pasigurisë, p.sh. nëse qeveria do të ishte e detyruar t'i vononte pagesat për furnitorë, që t'i reduktonte pagat për shërbyesit civil e që do të ndikonin në shtimin e panikut. Kosova ka një rritje mjaft të shpejtë të borxhit dhe rregulla e kufizimi të deficitit fiskal në 2% të PBB-së është një rregull që është ndërtuar si derivat i analizës së qëndrueshmërisë së borxhit, një analizë 50 vjeçare. Ideja është me çfarë deficiti, mund të rritet borxhi publik i Kosovës por në periudhë afatgjatë raporti i borxhit publik ndaj PBB-së të mbetet stabil, e jo eksploziv. Pra, është shumë e rëndësishme që akumulimi i borxhit të jetë gradual. Mirëpo, ekziston një përjashtim tjetër të rregullës fiskale prej 2% të PBB-së, që njihet si Klauzola e Investimeve në ligjin për Menaxhimin e Financave Publike. Klauzola e Investimeve thotë nëse ka fonde që mund të mirën borxh nga institucionet financiare ndërkombëtare me renome dhe nëse edhe këto financime janë të dedikuara për projekte kapitale, atëherë mund të shfrytëzohen përtej kufirit të deficitit. Mirëpo, pengesa kryesore është mungesa e kapaciteteve në implementimin e projekteve kapitale, mungesa e kapaciteteve në prokurimin e projekteve me financim prej institucioneve financiare ndërkombëtare,

sepse prokurimi nuk bëhet vetëm me standardet e sistemit kosovar të prokurimit, por edhe me rregullat e këtyre institucioneve për prokurim.

Kosova përkundër hapësirës fiskale që e ka, ka shumë mundësi që hapësirën fiskale me e rritë nga ana e të ardhurave. Kjo për shkak që Kosova vazhdon të ketë një nivel shumë të lartë të informalitetit, por në anën tjetër vazhdon të ketë edhe norma tatimore shumë të ulëta.

Sa i përket fondit për sigurime shëndetësore (FSSH), ligji i aprovuar në vitin 2014 parasheh që punëtorët formal dhe punëdhënësit e tyre, bashkërisht të kontribuojnë në 7% të të ardhurave bruto ndaj fondit për sigurime shëndetësore. Mirëpo, mbledhja e primeve kushtëzohet nga operacionalizimi i fondit, kurse në anën tjetër operacionalizimi i fondit kushtëzohet pikë së pari nga funksionalizimi i sistemit informativ të sigurimit shëndetësor. Për këtë arsye shpenzimet që kryhen sot prej anës së qeverisë, vazhdojnë të jenë të financuara vetëm prej të ardhurave publike. Një gjë e tillë shpie në shërbime të kufizuara. Vlerësohet se kosovarët në krahasim me vendet e tjera të rajonit i kanë shpenzimet më të larta nga xhepi për medikamentet. Kur primet fillojnë të mblidhen, ka hapësirë shumë të madhe për rritje të shpenzimeve në shëndetësi dhe rrjedhimisht në zgjerimin e hapësirës fiskale primet nuk mund të kenë shumë ndikim, paraprakisht duhet aprovuar lista e garantuar e medikamenteve, lista e garantuar e shërbimeve shëndetësore etj. Në Kosovë ka shumë nën-konsum të shërbimeve shëndetësore, sidomos tek shtresat më të ulëta të popullsisë dhe në momentin që shtohet trajtimi parandalues, atëherë kjo shpie edhe në rritje të shpenzimeve që ndërlidhen me trajtimin parandalues, siç mund të jenë p.sh. kontrollat dentare.

Dizajni origjinal i sistemit pensional ka qenë që pensionet shtetërore të jenë vetëm programe tranzicionale, duke qenë që nuk janë të bazuara në kontribute, programet shtetërore pensionale janë efektivisht programe të mbrojtjes sociale. P.sh. pensioni prej 100 euro në esencë nuk ka të bëjë asgjë me kursim shpenzim mes gjeneratave, apo kursim shpenzim individual. Por, thjesht ka të bëjë me program social, por që ka dedikim moshën. Sepse nuk ka asnjë ndërlidhje as me kontributin as me statusin e punësimit, por me një mbrojtje të moshës që është univerzale dhe që i jepet të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës që i kanë mbi 65 vjeç. I njëjtë është edhe programi i ish kontributdhënësve të sistemit Jugosllav, sepse edhe

ky sistem nuk ka ndërlidhje me kontributet që janë dhënë sepse nuk është vazhdimësi e sistemit të mëhershëm. Për dallim nga vendet anëtare të ish Jugosllavisë, Kosova nuk ka pasur asnjëherë proces të negociuar të ndarjes, rrjedhimisht edhe shpagimi që i bëhet sot ish kontributdhënësve ka karakter social e karakter shoqëror në kuptim të një programi të mbrojtjes sociale, se sa të një programi që sot i jep këto pensione, por që është e paprecedent të jenë të diferencuara me nivel të edukimit, pa marrë parasysh në cilën fushë edukimi apo angazhimi ka qenë pensionisti. Por, nuk ka ndonjë ndërlidhje që thotë në qoftë se do të ketë një proces të arbitrazhit dhe të ardhurat do të kthehen, atëherë këto fonde do të jenë të qeverisë. Për momentin fondet janë individuale, prandaj në qoftë se do të kishte bilanc pozitiv të procesit të arbitrazhit ku fondet e ish kontributdhënësve do të ktheheshin në Kosovë, atëherë pritet që të ri-shpërndahen tek ish kontributdhënësit.

Kosova, për nga ana e vlerësimit të Bankës Botërore, por edhe të FMN-së përgjithësisht në aspektin e menaxhimit makrofiskal është shembull i menaxhimi të përgjegjshëm. Përbashkë këtu ndryshimet që kanë të bëjnë me politikat sociale dhe fakti që efektiviteti i shpenzimeve në rritje ka hapësirë shumë të madhe për përmirësim. Ideja është që shfrytëzimi i hapësirës fiskale me qenë tandem me efektivitetin e shpenzimeve në rezultatet zhvillimore. P.sh. rasti i subvencioneve bujqësore, si rast eklatant i shpenzimit me efektivitet të ulët në arritjen e rezultateve zhvillimore. Vlera e shtuar nga bujqësia është në rënie, në anën tjetër subvencionet janë në rritje me vitet të tëra. Po ashtu kompensimi i punonjësve në paga dhe mëditje ka një rritje mjaft të theksuar brenda viteve, e në anën tjetër nuk mund të themi që ka pasur rritje të produktivitetit të punonjësve në sektorin publik. Prandaj, a ja vlen të shfrytëzohet ajo hapësirë fiskale pa i përforcuar themelet e menaxhimit financiar publik, por edhe planifikimit të përgjithshëm strategjik të vendit. Por, edhe mundësitë për me u rrit janë të mëdha pa krijuar borxh, si ristrukturimi i shpenzimeve, ulja e shkallës së informalitetit, rishikimi i rregullave të normave tatimore. Kosova është vendi i vetëm që nuk e tatton të ardhurën në dividendë, në kohën kur është vendosur ka pasur mundësi të ketë qenë politikë e mirë, por nuk do të thotë që nuk duhet rishikuar. Po ashtu Kosova është vendi me normë më të ulët të TVSH-së në regjion.

Nga Fondi Monetar Ndërkombëtar është intervistuar z. Selim Thaçi, i cili thotë që ekzistojnë arsye të ndryshme të mos shfrytëzimit të hapësirës fiskale të Kosovës. E para, edhe pse Kosova ka nivel relativisht të ulët të borxhit në krahasim me regjionin, koha kur Kosova ka filluar të marrë borxh është relativisht e shkurtë. E dyta, niveli i raportit të borxhit në krahasim me PBB-në është i kufizuar në 40% sipas Ligjit për Borxhin Publik. Arsyeja pse Kosova nuk e ka arritur nivelin 40% është sepse në vitin 2014 Kosova ka vendosur rregulla fiskale që e kufizon deficitin në nivelin prej 2% të PBB-së. Edhe para se të vendosej rregulla fiskale deficiti ka qenë i ulët. Arsyeja pse ka qenë i ulët është e lidhur me shumë aspekte, kryesisht mungesa e kapaciteteve për të shpenzuar. Historikisht ekzekutimi i shpenzimeve kapitale ka qenë i ulët. Kjo ka rezultuar që deficiti të jetë relativisht i ulët. Në vitin 2016, FMN-ja ka pasur një program me qeverinë dhe aty është shprehur interesimi i qeverisë së atëhershme që të gjenden format se si të stimulohen investimet. Pjesë të programit kanë qenë pjesë të ashtu quajtura Klauzola e Investimeve, që nënkupton se për financimin e projekteve të cilat financohen nga donatorët dhe institucionet financiare ndërkombëtare, deficiti mund të tejkalohet mbi nivelin prej 2% të PBB-së. Nuk ka pasur në Klauzolë ndonjë kufizim se sa mund të tejkalohet niveli prej 2%, mirëpo kufizimi ka qenë që derisa borxhi publik të arrijë nivelin 30%, atëherë duhet të rishikohet edhe një herë. Përndryshe, ajo çfarë ka ndodhur është që ekzekutimi edhe i kësaj pjese ka qenë shumë i ulët. Arsyet janë nga më të ndryshmet, nga qeveria thonë që procedurat që kërkohen sidomos nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), i cili është financuesi kryesor i projekteve përmes Klauzolës së Investimeve janë shumë të mundimshme. Por, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Institucionet Ndërkombëtare Financiare e vlerësojnë që këto janë procedura standarde, prandaj duhet të ulen kapacitetet. Çka nënkuptojmë me kapacitete? Si kriter për një projekt të madh që BERZH e financon është që duhet të krijohet një njësi implementuese të projektit. Këtu ka pasur dështime, njerëzit që kanë qenë të përzgjedhur të udhëheqin këto njësi nuk i kanë respektuar kërkesat dhe procedurat që kanë ardhur nga BERZH-i. Kjo ka rezultuar që Kosova ka pasur një ekzekutim shumë të ulët edhe të kësaj pjese. Dallimi në deficit është në vitin 2020, por ajo lidhet më shumë me çështjen e pandemisë dhe ekzekutimin e masave që janë ndërmarrë në atë kohë.

Një arsye shtesë pse borxhi i Kosovës është kaq i ulët është që projektet e mëdha kapitale Kosova i ka realizuar përmes buxhetit, si autostradën “Ibrahim Rugova” dhe “Arben Xhaferi” e nuk ka marrë borxh. Ndërsa prej projekteve të mëdha që financohet nga donatorët është projekti i hekurudhës, ku kostoja totale është 200 milion euro, prej të cilave 40% është grand, kurse kredia është 100 milion euro. Kjo është kredia më e madhe për momentin. Projekti tjetër prej 150 milion euro me BERZH për zgjerimin e rrugës për Pejë, por ka 4 vite që vjen deri në pikën e publikimi të tenderit, por pastaj kthehet prapa dhe tash janë përsëri në pikën zero, ku diskutimi është nëse duhet shkuar me trasenë e re apo me zgjerimin e rrugës aktuale. Krejt këto ndikojnë për mos shfrytëzim të hapësirës fiskale aktuale. Projekti tjetër për zgjerimin e rrugës për Mitrovicë i financuar prej Fondit për Zhvillim të Arabisë Saudite, i cili ka filluar në vitin 2013, në teren shihet që shumë pak është punuar. Pra, projektet të cilat janë financuar nga donatorët nuk janë duke ecur.

Pra, hapësira fiskale nuk është shfrytëzuar për arsye të mungesës së kapaciteteve për ekzekutim të shpenzimeve kapitale, vënies së kufirit prej 40% në Ligjin për Borxhin Publik, rregullën fiskale për deficitin 2%, si dhe klauzolën e investimeve. Por, kryefjala e pyetjes është mungesa e kapaciteteve për t’i ekzekutuar projektet ka ndikuar që Kosova të mos e përdor këtë hapësirë fiskale që e ka. Edhe pse gjatë 2-3 viteve të fundit ka pasur një përmirësim të ekzekutimit të projekteve, por zhvillimet e fundit me krizën e çmimeve e kanë vështirësuar edhe më shumë. Sepse për shumë projekte ku studimet e fizibilitetit kanë marrë për bazë çmime të tjera, ndërsa tani për realizim të projektit edhe ofertuesit nuk janë të interesuar ta qojnë përpara projektin me ato kontrata.

Nga pasqyrat financiare që i publikon thesari shihet që Kosova ka shumë probleme të natyrës së shpronësimit, procedurat nuk janë lidhur në kohë, projektet kapitale në shumicën e rasteve shkojnë edhe tek bordi për çështje të ankesave, mungesa e kuorumit për vendimmarrje në bord, zgjatja e procesit të prokurimit etj. Të gjitha këto kanë ndikuar së pari që financimi i projekteve kapitale të bëhet nga buxheti, e pastaj kapacitetet jo të kënaqshme për t’i udhëhequr projektet kanë ndikuar tek projektet që financohen nga donatorët.

Sa i përket borxhit që Kosova mund ta trashëgojë nga Serbia nuk është pjesë përbërëse e shifrave të borxhit publik të Kosovës. Për momentin Kosova nuk ka ndonjë informatë që është e rrezikuar prej ndonjë borxhi që mund të vjen. Ekziston pjesa që lidhet me Kosovën e Re. Kosova e ka qar përpara procesin në arbitrazh, por sipas të gjitha analizave gjasat janë të vogla dhe potencialisht vlera është 20 milion euro dhe jo më shumë. Kosova nuk ka PPP, sepse aty është rreziku më i madh i borxhit që mund të vjen. P.sh. në Shqipëri ka shumë projekte të PPP-së dhe aty kalkullohet edhe risku potencial që lidhet me PPP-të.

Sa i përket sistemit pensional për kontributet e viteve 90-ta, fondi kur është shpartalluar nuk është që ka pasur edhe shumë mjete në të. Sepse gjeneratë pas gjenerate dhe kanë qenë kontributet e një periudhe të shkurtër kohore. Është vështirë e pritshme që do të ndodhë ndonjë marrëveshje për kthimin e atyre kursimeve.

Kurse për sistemin e sigurimeve shëndetësore ka pasur një ligj të miratuar në vitin 2014 për sigurime shëndetësore dhe nga kalkulimet që janë bërë mbi bazën e përqindjeve që janë supozuar të aplikohen kanë ardhur deri në një kalkulim ku të hyrat do të jenë rreth 100 milion euro me një kontribut të përbashkët prej 7% të të ardhurave bruto (3.5% nga punëdhënësi dhe 3.5% nga punëtorët). 100 milion euro janë të pamjaftueshme për të financuar sistemin shëndetësor. Prandaj, do të ketë një periudhë mjaft të gjatë ku shteti do të duhet në mënyrë të vazhdueshme edhe t'i mbledh premiumet, por njëkohësisht edhe buxheti që aktualisht alokohet për shëndetësi të vazhdohet të mbetet i tillë. Kjo do të rrit koston e fuqisë punëtore dhe obligimet tjera në ekonomi. Ekziston një grup punues që janë duke diskutuar për këtë ligj, me gjasë do të diskutohet nëse do të aprovohet gjatë vitit 2023, implementimi tek në vitin 2025, përgatitjet për sistem të informimit shëndetësor e shumë aspekte të tjera do të ndikojnë që ky proces të ecë shumë ngadalë.

Ndërsa ish Ministrija e Financave znj. Hykmete Bajrami thotë sa i përket hapësirës fiskale është shumë e natyrshme që Kosova të ketë më shumë hapësirë fiskale në krahasim me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë sepse ato që sa vite janë shtet. Kurse Kosova është shtet i ri me institucione të reja. Marrja e borxheve ka filluar shumë më vonë, borxhi i jashtëm në vitin 2009, kurse ai i brendshëm në vitin 2012. Me ligjin për Borxhin Publik, është e lejuar që niveli i borxhit

publik të jetë deri në 40% të BPV-së. Por, trendi i rritjes së borxhit të jashtëm është shqetësuese, për një kohë të shkurtër borxhi është rritur shumë. Arsyeja e mos shfrytëzimit të hapësirës fiskale të Kosovës është pse nuk po ka kapacitet për të shpenzuar. Kosova është duke paguar 450 mijë euro tarifa të zotimit për kreditë që janë marrë, janë ratifikuar dhe asnjëherë nuk ka filluar disbursimi i tyre sepse nuk po ka kapacitete për t'i implementuar ato. Sistemi bankar është mirë i zhvilluar, nuk ka mungesë të kapitalit. Një prej blerësve kryesor të letrave me vlerë që i emeton qeveria janë Bankat komerciale dhe Fondi Pensional i Kosovës.

Kosova ka mungesë të kapaciteteve institucionale për implementimin e projekteve kapitale. Nëse analizohen historikisht buxhetet shohim që implementimi i investimeve kapitale është shumë i ulët. Në 6 mujorin e parë të këtij viti janë implementuar vetëm 11% të investimeve kapitale, nga 704 milion euro, janë implementuar vetëm 79 milion euro. Pra, zbatueshmëria e investimeve kapitale është tepër e ultë. Ministria e Financave Punës dhe Transfereve ka paraparë emetim shumë më shumë të letrave me vlerë, por për shkak që nuk arrin t'i shpenzojë këto mjete ka vendosur që ta ndërrojë kalendarin e emetimit të letrave me vlerë. Organizatat buxhetore nuk po përgatiten mirë për implementim të projekteve kapitale, ka probleme shumë të mëdha me shpronësimin, shpeshherë ka probleme që linden gjatë rrugës në mes të organizatave buxhetore me kompanitë financuese dhe implementuese dhe kjo i ndgadalëson ecurinë e projekteve. Aktualisht janë disa projekte kapitale të bllokuara, nuk është duke u punuar në rrugën për Pejë, rrugën për Podujevë, rrugën për Mitrovicë dhe rrugën për Gjilan. P.sh. rruga për Pejë ka mjetet e gatshme, janë kreditë e ratifikuara, por ka disa vite që për shkak të problemeve me shpronësim nuk është punuar fare. Pra, nuk ka mungesë të financave, por ka pengesa që duhet adresuar për t'i zhbllokuar projektet dhe për të filluar investimet. Norma e disbursimit të borxhit të jashtëm është jashtëzakonisht e vogël. Në periudhën kur ka qenë Ministre e Financave, nga komplet mjetet e marra nga Banka Botërore vetëm rreth 20% janë implementuar. Kjo është një arsye pse Kosova nuk mund ta shfrytëzojë më shumë hapësirën fiskale aktuale që e ka në dispozicion.

Sa i përket të ardhurave nga taksat, Kosova mund të rrisë normën e tatimeve, apo të dalë me tatime të reja, siç është tatimi në pronë për toka e të tjera por kjo duhet të analizohet. Për

momentin Qeveria ka rreth 300 milionë euro të cilat i ka marrë nga qytetarët dhe bizneset në formë të taksave dhe tatimeve dhe po i mban në bankë, në kohën kur inflacioni është rreth 20%. Në një situatë të tillë po humbim dyfish: e para që këto mjete janë jashtë ekonomisë dhe e dyta këto mjete po i zhvlerëson inflacioni. Tatimi në dividendë është hequr kur është bërë reforma në pakon fiskale sepse është konsideruar që mund të jetë një stimulim për tërheqjen e investimeve të huaja, por një gjë e tillë mund të rishikohet.

## VI KONKLuzionet dhe Rekomandimet

Pas analizave statistikore dhe përdorimit të modeleve ekonometrike për vërtetimin dhe testimin e hipotezave të ngritura, në fund të disertacionit janë konkluzionet, limitimet e studimit dhe rekomandimet.

### 6.1 Konkluzionet

Një nga çështjet kryesore me të cilat përballen vendet sot, është sigurimi i alokimit efikas të burimeve. Në rastet kur vendi nuk mund të plotësojë plotësisht nevojat me burimet e tij ekzistuese, mund të kërkojnë burime shtesë. Prandaj, vendet brenda kornizës së kufijve ekzistues të buxhetit, bëjnë përpjekje që të krijojnë mundësi të reja financimi për financimin e nevojave publike, apo transferimin e tyre në fushat e përcaktuara më parë. Kjo çështje ka një rëndësi të madhe sidomos për vendet në zhvillim që kanë mungesë të burimeve për t'u përdorur në fushat e ndryshme të funksionimit të vendit. Prandaj, përmes konceptit të hapësirës fiskale vendet tentojnë të gjejnë një zgjidhje për këtë problem.

Edhe pse koncepti i hapësirës fiskale, është një koncept mjaft i ri, ekzistojnë shumë punime dhe raporte të publikuara në lidhje me hapësirën fiskale, por vetëm një numër shumë i kufizuar prej tyre kanë përdorur modele empirike për të analizuar hapësirën fiskale dhe asnjë prej tyre nuk ka të bëjë me vendet e Ballkanit Perëndimor. Prandaj, qëllimi i këtij punim është analiza e marrëdhënies ndërmjet treguesve të funksionit të reagimit fiskal dhe bilancit primar, në periudhën 2000-2020, si dhe matja e hapësirës fiskale të vendeve të Ballkanit Perëndimor sipas qasjes së Ostry et al. (2010) dhe Aizenman dhe Jinjark (2010). Pas analizimit të metodave dhe modeleve të ndryshme që janë përdorur nga autorët për vendet e ndryshme, është tentuar që të adaptohet metodologjia që i përshtatet më së shumti karakteristikave specifike të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Për të analizuar hapësirën fiskale janë grumbulluar të dhëna të cilat janë siguruar nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK), Banka Botërore (WB), Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN),

Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), Organizata ndërkombëtare e punës (ILO), Agjencitë Statistikore, Ministritë e financave dhe Bankat Qendrore të vendeve përkatëse.

Pas llogaritjes së regresionit të katrorëve të vegjës (OLS), regresionit me efekte fikse dhe efekte të rastit dhe Hausman-Taylor me variabla instrumental është përdorur testi Hausman për të përcaktuar se cili model është më i përshtatshmi për të aplikuar për vendet e Ballkanit Perëndimor. Rezultatet e testit të Hausman-it tregojnë që modeli Hausman - Taylor me variabla instrumental është më konsistent dhe më eficient se sa efektet fiske dhe të rastit. Prandaj, si model empirik është përzgjedhur modeli Hausman – Taylor IV për të matur dhe vlerësuar ndërlidhjen në mes të funksionit të reagimit fiskal dhe bilancit primar (%PBB-së) në shtetet e Ballkanit Perëndimor ndërmjet viteve 2000-2020. Ndërsa rezultatet nga regresioni OLS, me efekte fiske dhe të rastit janë paraqitur për qëllime krahasimore.

Në studim janë përdorur treguesit e funksionit të reagimit fiskal. Bilanci primar në % të PBB-së është variabla e varur, ndërsa raporti i vonuar i borxhit ndaj PBB-së është variabla kryesore shpjeguese. Kurse variablat e tjera të përdorura si përcaktues të bilancit primar përfshijnë raportin e borxhit në katror ndaj PBB-së së vonuar, të ardhurat qeveritare (% të PBB-së), shpenzimet qeveritare (% të PBB-së), hendekun e shpenzimeve të qeverisë, inflacionin (% e ndryshimit), indeksin e stabilitetit politik, shkallën e ekonomisë informale dhe hendekun e prodhimit.

Borxhi publik ka një ndërlidhje pozitive me bilancin primar. Gjithashtu, rezultati tregon se borxhi publik deri në kufirin optimal e rrit hapësirën fiskale. Prandaj, mund të konkludojmë se borxhi publik luan një rol mbështetës në rritjen e hapësirës fiskale të 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor. Borxhi publik në katror ka një lidhje negative me bilancin primar, që do të thotë se marrëdhënia e tyre është jolineare dhe në formë U-je. Të ardhurat publike kanë ndërlidhje pozitive me funksionin e reaksionit fiskal dhe elasticiteti i të ardhurave publike është një tregues shumë i rëndësishëm për krijimin e hapësirës fiskale. Vendet që kanë elasticitet më të lartë të të ardhurave, mund të rrisin nivelin e të ardhurave gjë që do të ndikonte në mënyrë direkte në rritjen e hapësirës fiskale të vendeve. Shpenzimet publike kanë ndërlidhje të zhdrejta

me funksionin e reaksionit fiskal dhe vendet që kanë elasticitet më të lartë të shpenzimeve, përmes rialokimit të shpenzimeve joefikase, apo uljes së shpenzimeve do të mund të krijnë hapësirë fiskale.

Koeficienti i hendekut të shpenzimeve të qeverisë është, pra rritja e përkohshme në shpenzimet e qeverisë rezulton në një përkeqësim në bilancin primar. Koeficienti i inflacionit është negativ, që do të thotë ekziston një ndërlidhje negative, pra me uljen e nivelit të inflacionit rritet bilanci primar. Rezultatet e regresionin tregojnë që koeficienti i shkallës së informalitetit është negativ, ku çdo ulje e shkallës së informalitetit do të ketë ndikim pozitiv në rritjen e bilancit primar, nëse faktorët e tjerë mbesin të pandryshueshëm.

Nga llogaritja e hapësirës fiskale si diferencën në mes të nivelit aktual të borxhit të vendeve dhe kufirit të borxhit sipas modelit të Ostry et al. (2010), rezulton që Maqedonia e Veriut, Shqipëria dhe Mali i Zi nuk kanë hapësirë fiskale. Serbia ka hapësirë fiskale shumë të limituar, ndërsa Bosnja dhe Hercegovina dhe Kosova kanë pak hapësirë fiskale.

Duke marrë parasysh që hapësira fiskale nuk krijohet vetëm përmes borxhit publik, por të ardhura publike dhe shpenzimet publike janë edhe më të rëndësishme, pra mundësia për ndryshime në këto dy krahë të bilancit krijon hapësirë fiskale strukturore dhe të ardhshme. Për këtë arsye hapësira fiskale është përlllogaritur edhe sipas qasjes së Aizenman dhe Jinajarak (2010), përmes dy mënyrave: e para raporti ndërmjet borxhit publik dhe të ardhurave nga taksa (%PBB-së) dhe e dyta, raporti ndërmjet deficitit fiskal me të ardhurat nga taksa. Nga rezultatet e hapësirës fiskale de facto sipas metodës së parë, të përlllogaritur si raporti në mes të borxhit publik të vitit të fundit (në rastin tonë viti 2020) dhe mesatares së të ardhurave nga taksat (ndërmjet viteve 2015-2020 për të zbutur luhatjet e ciklit të biznesit) ka variacion të gjerë të viteve tatimore të nevojshme për shlyerjen e borxhit publik, nga më pak se 1 vit në Kosovë (që tregon një hapësirë të lartë fiskale), deri në rreth 4.3 vite në Shqipëri (që tregon një hapësirë të ulët fiskale). Kosovës i duhen mesatarisht 0.90 vite, apo rreth 330 ditë për grumbullimin e taksave për të shlyer borxhin publik. Bosnja dhe Hercegovinës i duhen 1.83 vite, pasuar nga Serbia 2.46 vite. Ndërsa në pozita më të jofavorshme qëndrojnë Maqedonia e Veriut me 3.55 vite, Mali i Zi me 4.02 vite dhe Shqipëria me 4.28 vite. Ndërsa, rezultatet e hapësirës fiskale de

facto e llogaritur sipas metodës së dytë, si raport ndërmjet mesatares së deficitit fiskal (të viteve 2015-2020) dhe mesatares së të ardhurave nga taksat (të viteve 2015-2020) janë në përputhje me konceptin se, edhe pa rritur bazën tatimore, vendet e Ballkanit Perëndimor kishin hapësirë të konsiderueshme fiskale në vitin 2020.

Rezultatet e regresionit të Hausman Taylor IV tregojnë që hapësira fiskale ka ndërlidhje pozitive me rritjen ekonomike, me një koeficient prej 0.111 (dev. st 0.0303) dhe me signifikançë 99%. Duke marrë parasysh që rritja ekonomike është një nga treguesit kryesor të stabilitetit ekonomik të vendit, mund mund të konkludojmë që vërtetohet hipoteza e parë e ngritur që hapësira fiskale ka ndikim në stabilitetin makroekonomik të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Për vërtetimin e hipotezës së dytë është analizuar ndikimi i treguesit të kontrollit të korrupsionit dhe të stabilitetit politik dhe mungesës së dhunës ose terrorizmit në hapësirën fiskale, si variabël të varur. Nga rezultatet e regresionit të Prais-Winsten shohim që ekziston ndërlidhje pozitive ndërmjet treguesit të kontrollit të korrupsionit me hapësirën fiskale, me koeficient prej 46.43 me signifikançë 99%. Pra, vendet që kanë nivel më të lartë të kontrollit të korrupsionit, janë vende me më pak korrupsion, rrjedhimisht kanë edhe hapësirë fiskale më të madhe. Po ashtu koeficienti i indeksit të stabilitetit politik dhe mungesës së dhunës ose terrorizmit është pozitiv 10.48, me signifikançë 90%, që do të thotë vendet me stabilitet politik më të lartë, kanë edhe hapësirë fiskale më të madhe. Nga rezultatet e fituara mund të themi që vërtetohet hipoteza e dytë e ngritur që korpusi i faktorëve politik sfidon krijimin e hapësirës fiskale.

Për të vërtetuar hipotezën e tretë është krijuar një model i ri, ku variabla e varur është rritja reale e PBB-së, ndërsa si variabël e pavarur është hapësira fiskale. Po ashtu është ndërtuar një dummy variabël, për përcaktimin e cikleve rënës të shkaktuar nga krizat. Modeli empirik është zhvilluar për të vlerësuar marrëdhënien ndërmjet hapësirës fiskale, krizave ekonomike dhe rritjes reale ekonomike në shtetet e Ballkanit Perëndimor. Nga testet e bëra rezulton që modeli Hausman-Taylor IV është më konsistent dhe më eficient për t'u përdorur. Nga tabela rezultatet e regresionit shohim që dummy variabla e krizës ka ndikim negativ në rritjen ekonomike. Koeficienti i dummy variablës së krizës është -2.95 (me një devijim standard prej 0.651), që do

të thotë kur kemi kriza ekonomike këto e shpiejnë ekonominë në recesion. Kurse hapësira fiskale ka ndikim pozitiv me rritjen ekonomike. Prandaj, mund të themi që hapësira fiskale ekzistente do të mund të përdoret për politika ekspansioniste. Nga ky konstantim, mund të themi që vërtetohet hipoteza e tretë që hapësira fiskale në ciklet rënësë ekonomike krijon hapësirë ndikuese për politika fiskale ekspansive.

Nga intervistimi i përfaqësuesve të misionit të Bankës Botërore në Kosovë, Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe ish ministres së Financave në Kosovë kuptojmë që arsyeja kryesore e mos shfrytëzimit të hapësirës fiskale të Kosovë në mënyrë të theksuar është mungesa e kapaciteteve për ekzekutim të shpenzimeve kapitale. Zbatueshmëria e investimeve kapitale historikisht është tepër e ultë. Arsyeja tjetër është vënia e kufirit të Borxhit Publik prej 40% të PBB-së në Ligjin për Borxhin Publik. Kosova si shtet i ri me institucione të reja, marrjen e borxheve ka filluar shumë më vonë, borxhin e jashtëm në vitin 2009, kurse atë të brendshëm në vitin 2012. Brenda një periudhe të shkurtër Kosova ka kaluar nga një gjendje ku stoku i brendshëm ka qenë 0% ndaj PBB-së, në një gjendje ku është duke e tejkaluar vlerën prej 1 miliard €, prandaj trendi i rritjes së borxhit të është shqetësuese. Arsye tjetër është rregulla fiskale që deficitin të mos kalojë normën prej 2%. Kjo rregull është ndërtuar si derivat i analizës së qëndrueshmërisë së borxhit. Por, edhe para se të vendosej rregulla fiskale deficitin në Kosovë ka qenë i ulët. Ky deficit mund të tejkalohet nëse ka të hyra shtesë nga privatizimi. Këto të hyra shtesë nga privatizimi mund të shfrytëzohen vetëm nëse ka bilanc bankar, apo rezerva buxhetore që e tej kalojnë 4.5% të PBB-së. Ndërsa sipas Klauzolës së Investimeve, për financimin e projekteve të cilat financohen nga donatorët dhe institucionet financiare ndërkombëtare me renome, deficitin mund të tejkalohet mbi nivelin prej 2% të PBB-së.

Një arsye shtesë pse borxhi i Kosovës është kaq i ulët është që projektet e mëdha kapitale Kosova i ka realizuar përmes buxhetit, si autostradën “Ibrahim Rugova” dhe “Arben Xhaferi”. Borxhi ndaj Klubit të Parisit dhe Klubit të Londrës, janë dy pjesë të borxhit të cilat Kosova si shtet ende nuk i ka pranuar që janë të saja dhe ende nuk ka një proces të arbitrazhit. Ndërsa, qeveria e Kosovës i ka tërhekur nga Agjensioni Kosovar i Privatizimit rreth 300 milion €, të cilat në fakt janë detyrime kontigjente dhe varen nga procesi i trajtimit të kërkesave të kreditorëve

për ndërmarrjet shoqërore që janë në proces të likuidimit. Ky është detyrim kontigjent më i rëndësishëm se sa borxhi ndaj Klubit të Parisit dhe Klubit të Londrës.

Kosova ka shumë probleme të natyrës së shpronësimit, procedurat nuk janë lidhur në kohë, projektet kapitale në shumicën e rasteve shkojnë edhe tek bordi për çështje të ankesave, mungesa e kuorumit për vendimmarrje në bord, zgjatja e procesit të prokurimit etj.

Kosova përveç hapësirës fiskale që e ka, ajo mund ta rrisë edhe më shumë hapësirën fiskale nga ana e të ardhurave. Kjo për shkak që Kosova vazhdon të ketë një nivel shumë të lartë të informalitetit, por në anën tjetër vazhdon të ketë edhe norma tatimore shumë të ulëta, mund të dalë me tatime të reja, siç është tatimi në pronë për toka, ose mund ta rishikoj tatimin në dividendë.

## 6.2 Limitimet e studimit

Limitimet kryesore të këtij punimi janë që nuk ekziston ndonjë studim empirik për vendet e Ballkanit Perëndimor, ku gjetjet do të krahasoheshin me rezultatet e dala nga ato hulumtime.

Kufizimi i disponueshmërisë së të dhënave, mungesave e serive kohore të treguesve ka ndikuar në rezultatet tona jo-signifikante të funksionit të reaksionit fiskal, me çrast kufiri i borxhit nuk ka mundur të llogaritet përmes raportit në mes të treguesve të reaksionit të funksionit fiskal përveç borxhit të vonuar dhe diferencës ndërmjet normës reale të interesit dhe rritjes reale të PBB-së.

